

Deshtimi ne Mbrojtje

Dhuna kunder pakicave ne Kosove, Mars 2004

PERMBLEDHJA	1
REKOMANDIMET.....	4
HYRJA.....	6
PRAPAVIJA: STATUSI I PAZGJEDHUR I KOSOVËS DHE ROLI I BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE NË KOSOVË.....	9
Themelimi Dhe Roli I KFOR-it.....	11
Themelimi Dhe Roli I UNMIKUT	13
Shërbimi Policor I Kosovës	13
SHKËNDIJAT TË CILAT SHKAKTUAN ZJARRIN	15
Vrasja E Jovica Ivic Në Cagllavicë	15
Roli I “Shoqatave Të Luftës”.....	17
Fundosja E Tre Fëmijëve Në Lumin Ibër	18
DËSHTIMI NË MBROJTJE: JO AFTËSIA E KFOR-it DHE UNMIK-ut TË MBROJË SËRBËT DHE MINORITETET TËJERA.....	19
DHUNA: SULMET E SHQIPTARËVE MBI SËRBËT DHE ROMËT	26
A Ishte Dhuna Spontane Apo E Organizuar?	26
Përleshjet Në Mitrovicë Dhe Në Cagllavicë	27
Sulmet Kundër Sërbëve Dhe Romëve Dhe Dështimi Në Mbrojtje	30
Prishtinë	30
Lipjan.....	32
Frashër.....	34
Sllatinë	36
Vushtri.....	37
Fushë Kosovë.....	41
Obiliq.....	46
Bellopoje	49
Gjakovë	51
Prizren	52
PERGJEGJJA E UDHEHEQSISE KOSOVARE NDAJ DHUNES	56
SITUATA E PAS DHUNES, PER SERBET, ROMET DHE PAKICAT TËJERA JO SHQIPTARE.....	60
FALEMDERIMET	63

PERMBLEDHJA

Gjatë pesë viteve të fundit aq shumë ndërkombëtarë studiovan problemet tona sa që nuk mundem as ti numeroj dhe prodhuan rekomandime dhe raporte të panumërta. Në fund si rezultat i gjithë këtyre unë humba cdo gjë që ndërtova për dyzet vitet e fundit, gjersa bashkësia ndërkombëtare shikonte prej largësisë së disa qindra metrave. Tani më thonë të kthehem dhe ta rindertoj jetën time-si mund t'iu besoj?

Banor i zhvendosur serb i Frashërit

Ne gjithmone e kemi ditur se Kosova nuk do te pushtohet. KFOR-i është në Kosove që të mbrojë kundër dhunës civile, shqetësimeve dhe dhunës etnike. Atyre nuk u nevojiten tanket por mjete kundër trazirave, mburoja dhe ushtarë të trajnuar të meren me trazira publike. Nëse KFOR-i nuk ka qenë i përgatitur për një trazirë të tillë publike, atëhere pse jo? Qka kanë menduar për se janë në Kosovë?

Zyrtarë i larte i UNMIK-ut

Me 17 dhe 18 Mars 2004 ndodhen trazira te dhunshme ne tere Kosoven, te nxitura nga raporte senzacionale qe ne fund dolen te paverteta se serbet ishin pergjegjes per fundosjen e tre fëmijeve shqiptarë. Trupat e KFOR-it te udhehequra nga NATO, policia ndërkombetare e UNMIK-ut dhe Sherbimi Policor i Kosoves gati tersisht humben kontrollin gjate 48 oreve, kur shperthyen se paku 33 protesta te medha pergjate Kosovës duke përfshire përafersisht 51,000 pjesmares.

Ne perpjekjet e bashkesise nderkombetare qe te krijojne nje Kosove multietnike ne te cilen qeveria dhe shoqeria civile respektojne te drejtat e njeriut, dhuna e fundit ne Kosove ishte hapi me i madhe prapa qysh prej 1999. Prej kryeqytetit Prishtinës deri te qytetet si Prizreni dhe Gjakova, dhe fshatrat e vogla si Sllatina dhe Bellopje turmat shqiptare vepruan me nje efikasitet te ashper per te hequr qafe pranine e mbetur serbe ne shume zona te Kosoves dhe se ato goditen edhe komunitetet tjera minoritare përfshire ketu romet dhe ashkalite. Ne shume fshatra te prekura nga sulmet, qofte nga dhuna spontane, qofte ajo e organizuar ,cdo shtepi serbe, rome, apo ashkali u shkaterrua .Në fshatin Frasher ishin djegur 137 shtëpi serbe, kurse shëpите e fqinjëve shqiptare ishin mbetur te paprekura. Ne Vushtrine e afert ishin shkaterruar te gjitha 69-te shtepite e ashkalinjeve, ndersa në Fushe Kosove nje serb ishte rrahur deri ne vdekje dhe ishin djegur me shume se 100 shtepi te serbeve dhe romeve, sikurse edhe ndërtesa e postes, shkolla serbe dhe spitali serb. Madje edhe pranite me te vogla serbe u bene shenjestra: Turmat shqiptare me ore te tera sulmuan kishen ortodokse ne Gjakove, dhe se fundi

duke i perndjekur pesë serbe te moshuara të mbeteura prej periudhes së pas luftes kur qyteti numronte me shumë se 3.000 serb.

Dhuna e Marsit dehoi popullaten e tërë serbe prej dhjetra lokacioneve ,përfshire aty edhe kryeqytetin Prishtinen, po njejte te prekura ishin komunitetet e romeve dhe ashkalive.Gjatë protestave dy ditore u dogjen, së paku 550 shtëpi dhe 27 kisha dhe manastire ortiodokse, dhe për afersisht 4,100 serb, rome, ashkali dhe minoritete te tjera jo shqiptare u zhvendosen prej shtëpive te tyre. Muaj më vonë rreth 2000 persona ende mbesin të zhvendosur, duke jetuar ne kushte jo-sanitare dhe banesa te paperfunduara dhe pa ngrohje, te grumbulluar ne shkolla, ne tenda te ndryshme ne kampet ushtarake te KFOR-it e deri ne kontejnere te metalte te kamioneve.E ardhmja e minoriteteve kurre nuk eshte dukur më e zbehur.

Edhe pse trupat e KFOR-it dhe policise ndërkombëtare të UNMIK-ut jane te ngarkuara specifikisht me mandat për sigurimin e minoriteteve ne Kosovë, ata deshtuan te mbrojne minoritetet gjate trazirave, shpesh duke i lene serbet dhe minoritete tjera te rrethuara dhe në mëshiren e turmave shqiptare me orë të tera para se te pergjigjen. Ne fshatin Frashër KFOR-i francez deshtoi qe tu dale ne ndihme serbeve te rrethuar, edhe pse baza e tyre gjendet vetem disa qind metra larg fshatit- në të vërtete turma shqiptare kaloi mu para bazes në rrugë për në fshat, para se t'ia veje zjarrin seciles shtëpi serbe. KFOR-i francez ngjajshem deshtoi te pergjigjet ndaj trazirave kunder ashkalive ne Vushtri edhe pse ky fshat gjendet afer dy bazave te KFOR-it francez. Trupat gjermane te KFOR-it ne Prizren deshtuan te mbrojne popullaten serbe si dhe manastiret dhe kishat historike serbe përkunder thirrjeve te shumta për ndihme te policeve gjerman te UNMIK-ut, te cilet me vonë akuzuan udhëheqsit e KFOR-it gjerman për jo burreri. Në Fushë Kosovë KFOR-i dhe UNMIK-u nuk ishin askund per tu pare, perderisa turmat shqiptare ne menyre metodike u vune zjarrin shtëpive serbe. Fshati Bellopoje i cili gjendet ne rrethin e Pejës ishte rindertuar per serbet e kthyer, ishte djegur deri ne temeledhe pse gjendet pothuaj përbri me bazen KFOR-it italian. Ushtaret e KFOR-it italian refuzuan tu afrohen sërbeve te rrethuar, duke i shtyre ata te vrapojne per disa qind metra neper turmen e armiqsuar shqiptare, para se te evakuohen nga ana e KFOR-it.Gjate ketij procesi disa serb ishin lenduar.Po ashtu ne kryeqytet, ne Prishtine, serbet u barikaduan brenda banesave te tyre, perderisa protestuesit shqiptare gjuanin mbi ta, vidhnin dhe u venin zjarrin banesave te poshtme për gjashtë orë të tëra para se KFOR-I dhe UNMIK-u tu vijne në ndihme serbeve.

Dështimi i policise ndërkombetare të UNMIK-ut dhe KFOR-it që me efikasitet ti pergjigjen dhunës la sigurine në duart e Sherbimit Policor te Kosoves (SHPK). Pjestarët e Sherbimit Policor te Kosoves, shumica e te cileve te trajnuar rishtasi, ishin te pajisur shumë dobet të merren me dhunën. Disa prej pjestarëve te Shërbimit Policor te Kosoves

vepruan ne menyre profesionale dhe me shumë trimëri duke rezikuar jeterat e tyre qe tu dalin ne ndihmë serbëve te rrethuar si dhe minoriteteve te tjera në shumë qytete dhe fshatra. Mirpo shume pjestare te tjere te SHPK-se qendruan pasivisht perderisa turmat shqiptare u vune zjarrin dhe sulmuan serbet dhe minoritetet tjera, edhe pse ne disa raste ishin vetem disa metra larg. Disa pjestare te Sherbimit Policor te Kosoves u treguan qartasi te njeanshem duke arestuar serbet dhe pakicat tjera qe ishin duke mbrojtur shtepite e tyre, duke lënë anash sjelljen kriminale të shqiptarve e cila zinte vend para syve te tyre. Ne disa raste pjestaret e SHPK-se jane akuzuar te kenë marrë pjesë aktive në vënjen e zjarrit te shtepive te pakicave.

Bashkësia ndërkombetare duket se gjendet në një mohim absolut kur bie fjala për deshtimet e tyre ne Kosovë. Përderisa veprimtarët ndërkombetare ishin të gjithëanshem dhe saktësisht kritike ndaj dështimeve te udhëheqsise kosovare gjatë dhe pas krizes, veprimtaria e zyrtë e bashkësise ndërkombtare i ka ikur nje shqyrtimi te ngjajshem, te afërt dhe kritik. Udheheqsia e KFOR-it dhe UNMIK-ut duken te knaqur të vazhdojnë “punën si zakonisht” në vend se te aplikojne reformat te cilat do te parandalonin përseritjen e një dhune masive dhe nje deshtimi te përtrier të institucioneve të sigurimit në të ardhmen.

Urgjentisht është i nevojshem një rishikim i gjerë dhe transparent i institucioneve te sigurimit te Kosoves i cili do te rezulton me nje rimekembje te strukturave jo efikase te sigurimit. Institucionet e sigurimit te Kosoves duhet te punsojne personel adekuat te trajnuar mire dhe te paisur ne menyre adekuate te pergjigjen situatave te protestave. Eshte i nevojshem zhvillimi i nje sistemi te koordinuar te sigurimit ne mes te KFOR-it, UNMIK-ut dhe SHPK-se, duke i dhene fund tensioneve dhe rivaliteteve nderinstitucionale. KFOR-i posaqerisht duhet te zhvilloj nje strukture unike te komandes dhe nje sistem te pergjithshem te pergjegjjes ndaj dhunes ne Kosove, duke lene anash strukturat e decentralizuara dhe doktrinat e pabarabarta nacionale te cilat i kontribuan rrëmujes se 17 dhe 18 marsit. Përfundimisht situata e sigurise se pakicave mbetet në duart e institucioneve vendore si SHPK, sikurse edhe ishte ne shume lokacione gjate muajit mars. Për të ardhmen e pakicave në Kosovë është esenciale që SHPK-ja të zhvillohet në një forcë policore me të vërtete profesionale, jo të njeanshme, te trajnuar mire dhe qe ka mbrojtjen e pakicave nje prej mandateve kryesore.

Bashkesia nderkombetare ka humbur peshë të madhe në Kosovë si rezultat i dhunes se marsit: ekstremistët shqiptarë tani e dine që me sukses mund te nxisin strukturat nderkombetare te sigurimit, pasi qe kanë shkatruar nocionin e patundshmerise per UNMIK-un dhe KFOR-in; kurse pakicat gati tërsisht kanë humbur besimin e mbetur ne bashkesine ndërkombetare. Koha po kalon per bashkesine nderkombetare dhe pakicat

ne Kosove, tani eshte koha per veprime te vendosura dhe transparente qe te rregullohen te metat e bashkesise nderkombetare dhe strukturave te sigurimit ne Kosovë.

REKOMANDIMET

Per Qeveritë e Kontakt Grupës:

Vendet e Kontakt Grupës (Franca, Gjermania, Italia, Rusia, SHBA, dhe Britania e Madhe), dhe Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara duhet te shtojnë angazhimin e tyre ndaj Kosovës qe te përmirsojnë kushtet e sigurimit për pakicat. Urgjentisht është i nevojshëm një rishikim dhe reformë thelbësore e KFOR-it, të udhëhequr nga NATO dhe Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara ne Kosovë, UNMIK-ut, qe kërkon një vëmendje te plotë dhe mbështetje në nivelet më të larta në mënyrë qe të jetë efektive. Institucionet e ndryshme nderkombetare ne Kosove kane rol qe perputhet e ndonjehere edhe rol rival gje qe e bllokoi zhvillimin e Kosoves dhe eshte me rendesi qe Grupi i Kontaktit te veproj bashkarisht per ti realizuar reformat e domosdoshme në Kosovë. Per kete arsye HRW u bene rekomandim tere Grupit te Kontaktit, e jo institucioneve individuale te cilat kane te bejne me elemente te ndryshme te qeverisjes dhe sigurise ne Kosovë.

- Të bëhet një shqyrtim i tërësishëm i pavarur dhe i gjithanshëm i përgjegjes se KFOR-it, policise nderkombetare te UNMIK-ut dhe SHPK ndaj dhunës së marsit, me theks te vecante lidhur me dështimin e organizatave të sigurise te Kosovë për të mbrojtur minoritetet nga dhuna e motivuar etnike dhe mungesa e koordinimit mes organizatave te ndryshme të sigurise ne Kosove.
- Te shqyrtohet struktura e komandimit te KFOR-it, me qellim te krijimit te nje strukture te perbashket te komandimit e cila do te jete e gatshme te reagoj shpejt ndaj dhunes se gjithepërhapur ne Kosove, duke siguruar reagim te njejte ndaj incidenteve te sigurise dhe e ciluar nga restrikcionet e rregullave te kontigjenteve nacionale gje qe bllokoi KFOR-in te pergjegjet ndaj dhunes se marsit.
- Te zgjerohen KFOR-i dhe policia nderkombetare e UNMIK-ut ne menyre qe te sigurohet numer adekuat i zyrtareve te sigurimit ne Kosove.
- Te sigurohet qe trupat e KFOR-it dhe policise civile te UNMIK-ut qe sillen ne Kosove te kene eksperience me situata te demonstratave, duke perfshire

perdorimin e shkallezuar te forces ne keto situata, dhe qe te kene mjete te duhura per tu pergjegjur demonstratave dhe shqetesimeve tjera masive.

- Se bashku me PISG te merren masa te menjehershme per permiresimin e kushteve te jetes te atyre qe ende jane te zhvendosur pas dhunes se marsit 2004. Adresimi i brengave te sigurise te minoriteteve te zhvendosura nga dhuna e marsit 2004 ne konformitet me Principet e UN mbi personate zhvendosur ne menyre interne; duke siguruar konsultime adekuate me te zhvendosurit dhe duke u ofruar atyre mundesi, përfshirë aty edhe rikonstruimin e shtëpive të tyre apo relokimin po qe se e kërkon situata e sigurisë.
- Të merret hapi i parë në inicimin dhe institucionalizimin e një dialogu në mes të PISG, liderëve serb të Kosovës, dhe qeverisë së Serbisë që të përmirsohet situata e sigurisë për serbët në Kosovë, të përfundoj diskriminimi në shërbimet publike dhe të zgjedhet qeshtja e institucioneve paralele.
- Të kërkohet përgjegjsi për krimet etnikisht të motivuara në Kosovë, duke bërë primare dhe duke forcuar hulumtimet e gjithëanshme dhe të mekanizmave juridik në Kosovë.
- Siq edhe është kërkuar nga UNMIK-u të rritet numri i hulumtuesve dhe gjykatësve të UNMIK-ut në mënyrë që ti japin UNMIK-ut një kapacitet adekuat që të hulumtoj dhe të vë para gjyqit aktet kriminale të cilat janë bërë gjatë dhunës së marsit, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Të vazhdohet të bëhen deklaratatë të qarta dhe të ashpra publike se një Kosovë multietnike në të cilën të drejtat e të gjithë banorëve respektohen është njëri ndër objektivat e bashkësisë ndërkombëtare.
- Të sigurohet mbrojtja ndërkombëtare për minoritetet të cilat u detyruan të largohen nga Kosova nga frika e përndjekjes. Të sigurohet se ata që ikin në shtetet fqinje apo në shtetet tjera të Evropës Perendimore të kenë qasje të plotë dhe të drejtë në procedurat e azilkërkimit dhe që të trajtohen në mënyre humane dhe respekt të plotë. Azilkërkuesit nga Kosova të cilëve u është refuzuar aplikimi para ngjarjeve të marsit, apo ata që vullnetarisht janë lajmëruar të kthehen, duhet tu rishqyrtohen aplikacionet duke pasur parasysh ngjarjet e marsit dhe ndryshimin e situatës së sigurisë në Kosovë.

- Të bëhet primare forcimi i kredibilitetit të SHPK duke përmirsuar programet e trajnimit dhe duke siguruar mjete të duhura për pjestarët e SHPK-së (përfshirë aty edhe mjete për kontrollimin e dhunës. Rrogat e pjestarëve të SHPK-së duhet të rriten në nivele profesionale që të sigurohet rekrutimi i një personeli kualitativ.

Institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës:

- Të shtyhet kosova drejt një të ardhme multietnike, dhe të qartësohet se sulmet kundër minoriteteve do të dënohen ashpër.
- Të merret përgjegjsia për sigurinë e minoriteteve në Kosovë, dhe që siguria e tyre në Kosovë të bëhet një prioritet strategjik për PISG. Të zbatohen reformat e duhura mes PISG dhe SHPK që të garantohet siguria për minoritetet..
-
- Të bëhet me dije se institucionet e Kosovës, liderët politik, mediat dhe PISG-kishin faj të pjesërishëm për dhunën e marsit 2004, fillimisht duke bërë deklarata inflamatore.
- Të kërkohet një dialog me udhëheqsinë e qeverisë së Serbisë dhe Malit të Zi që të përmirsohen kushtet e minoriteteve në Kosovë, të përfundoj diskriminimi në ofrimin e shërbimeve publike dhe të zgjedhet qështja e strukturave paralele.

Qeverive të Serbisë dhe Malit të Zi

- Të kërkohet dialog me institucionet e përkohshme në Kosovë dhe me institucionet ndërkombëtare në Kosovë për të përmirsuar sigurinë për minoritetet në Kosovë, t'i japë fund diskriminimit në ofrimin e shërbimeve publike dhe të zgjedhë qështjen e institucioneve paralele.

HYRJA

Me datën 17 mars shpërthyen trazira te dhunshme në Kosove te nxitura nga grupet etnike shqiptare, një ditë më vonë agjencitë shqiptare te lajmeve dhanë raporte

senzazionale që në fund dolën të pavërteta se tre fëmijë ishin fundosur në lum pasi të jenë ndjekur nga serbët.¹ Dhuna me përmasa të mëdha u përhap me shpejtesi të dritës në gjithë Kosovë, dhe sipas autoriteteve kosovare gjate dy ditëve të ardhshme 33 trazira të mëdha shpërthyen duke përfshirë përafësisht 51,000 njerëz.² Grupet e mëdha etnike shqiptare kishin në shënjestër serbët³ dhe komunitetet tjera jo-shqiptare, duke u vënë zjarrin së paku 550 shtëpive dhe 27 kishave dhe manastireve ortodokse dhe duke lënë përafësisht 4100 serb, romë, ashkali dhe minoritete tjera jo shqiptare⁴ të zhvendosur.⁵ Nëntëmbëdhjetë njerëz humbën jetën, prej tyre tetë serbë dhe njëmbëdhjetë shqiptarë, me mijera të tjere u plagosën dhe përfshirë më shumë se 120 ushtarë të KFOR-it dhe pjestarë të policisë së UNMIK-ut dhe 58 pjestarë të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK).

Dhuna e marsit 2004 nuk ishte hera e parë për jo shqiptarët të jenë të sulmuar në Kosovë. Gjatë konfliktit të Kosovës në 1999 mes NATO-s dhe Jugosllavisë, shqiptarët e Kosovës ishin subjekt i një fushate sistematike të vrasjeve masive, dhunimeve, dëbimeve të dhunshme dhe krimeve tjera të luftës të kryera nga serbët dhe forcat jugosllave.⁶ Kur, me hyrjen e NATO-s, shqiptarët u kthyen në Kosovë, serbët e Kosovës, romët dhe minoritetet tjera iu nënshtruan dhunës së menjëhershme, gjë që shkaktoi shpërngulje masive të jo shqiptarëve nga Kosova.⁷ Dhuna e nivelit të lartë drejtuar ndaj komuniteteve jo shqiptare, që në të shumtën e rasteve ishte e organizuar dhe politikisht e motivuar, zgjati me muaj të tërë edhe me prezencën e administratës së kombeve të bashkuara dhe trupave ndërkombëtare të cilët nuk ishin efektiv në ndaljen e dhunës.

Përderisa në periudhën e menjëhershme të pas luftës intensiteti i dhunës u qetësua, serbët dhe minoritetet tjera në Kosovë vazhduan të sulmohen. Për shembull me 31 gusht 2003, një grupi të serbëve që jetonin në fshatin Cernicë afër Gjilanit u është gjuajtur një granatë e cila vrau mësuesin 35 vjeçar Miomir Savic, dhe plagosi katër serbë të tjerë. Më

¹ Shiko mëposhtë, Kapitulli V, Seksioni C, "Fundosja e tre fëmijëve në lumin Ibër," për diskutim më të detajshëm.

² "U.N. detalizon shkallën e gjerë të dhunës në Kosovë", Reuters, Mars 22, 2004.

³ Në këtë raport termi serb është përdorur që të referoj personave me origjinë etnike serbe që jetojnë në Kosovë. Termi shqiptarë etnik u referon shqiptarëve që jetojnë në Kosovë.

⁴ Disa minoritete në Kosovë si Turqit nuk kanë qenë shënjestër e dhunës.

⁵ Organizata për Siguri dhe Bashkpunim në Evropë (OSBE) Misioni në Kosovë, Departamenti i të drejtave të njeriut, "Sfidat e të drejtave të njeriut lidhur me dhunën e marsit," f.4.

⁶ Për një histori të detajshme lidhur me krimet e luftës të cilat bënë serbët dhe forcat jugosllave gjatë konfliktit në Kosovë, shikoni Human Rights Watch, Nën urdhëra: Krimet e luftës në Kosovë (New York: Human Rights Watch, 2001)

⁷ Human Rights Watch, "Keqtrajtimet kundër serbëve dhe romëve në Kosovën e re," Gusht 1999. Të gjitha largimet e serbëve dhe jo shqiptarëve të tjerë nuk ishin rezultat i drejtpërdrejt i dhunës kundër minoriteteve. Disa nga largimet e serbëve dhe jo shqiptarëve nga Kosova ndodhën në zona me shumicë serbe ndodhën menjëherë pas konfliktit të vitit 1999, ose për shkak të frikës nga ndonjë keqtrajtim i mundshëm në të ardhmën, ose ishte ky një vendim i vetëdijshëm se ata nuk dëshironin të jetonin në një shtet të dominuar nga shqiptarët, ose, një numër i vogël i atyre nga friga e ndonjë ndjekje në të ardhmën për krimet gjatë konfliktit 1999.

13 gusht 2003, dy të rinjë serbë të moshave njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë vjeçare u vranë nga arma automatike përderisa notonin në lumin afër enklavës serbe të Gorazhdecit.⁸ Më 3 qershor 2003 tetëdhjetë vjeçari Slobodan Stolic, bashkëshortja e tij shtatedhjetë e tetë vjeçare Radmila dhe i biri i tyre pesëdhjetë e tre vjeçar Ljubinko u vranë me sopatë në shtëpinë e tyre në Obiliq, te cilës pastaj iu vu zjarri.⁹ Në prill të vitit 2003 Amnesty International publikoi një raport të detjizuar mbi sulmet ndaj minoriteteve në Kosovë me përfundim se

gati katër vite pas përfundimit të luftës në Kosovë, minoritetet janë ende të rrezikuara nga sulmet dhe vrasjet, kryesisht nga ana e shumicës së popullsisë në rajon. Në baza ditore atyre u është mohuar dëmshpërblim efektiv për aktet e dhunës dhe kërcnimet e integritetit fizik dhe mental.¹⁰

Rrethimi i pasigurtë, në të cilin u gjendën serbët në Kosovë rezultoi në zhvendosjen e popullatës serbe në shumë qendra urbane. Për shembull, popullata serbe në qytetin e Gjakovës prej 3000 banorëve në vitin 1999, kishte rënë në vetëm pesë gra të moshuara serbe para trazirave të marsit.¹¹ Gratë e mbetura serbe jetonin nën përkujdesje konstante të KFOR-it brenda dhe rreth kishës e cila ishte vëmendje e protestave të marsit 2004 në qytetin e Gjakovës. Ngjajshëm ndodhi edhe me popullatën serbe të Prizrenit, njëherë njëri prej qyteteve me kulturë më të llojllojshme dhe me popullatë etnikisht të ndryshme, në të cilin para vitit 1999 jetonin 9000 serb, ra në vetëm 23 serb në vitin 2003.¹² Të njëzet e tre serbët që jetonin në qendër të Prizrenit u detyruan të ikin pasi që u ishte vënë zjarri shtëpive të tyre. Serbët e moshuar në vendet rurale nuk kishin mundësi të largohen në mungesë të rrjetit familjar jashtë Kosovës.

Komunitetet e romëve, ashkalive dhe egjiptasve, kolektivisht të njohur si RAE, poashtu u ballafaquan me dhunë, kërcime, dhe përndjekje të dhunshme pas konfliktit të vitit 1999. Disa shqiptarë dyshonin se disa pjestarë të RAE kishin bashkëpunuar me serbët dhe forcat jugosllave gjatë konfliktit të vitit 1999. Sentimenti shqiptarë ndaj RAE nuk dallohej nga ai që mbizotëron në Europë, ku komunitetet e RAE janë të njohura me

⁸ Lajmet BBC, "U.N. vepron lidhur vrasjet në Kosovë," 14 Gusht 2003 (online),

<http://news.bbc.uk/1/hi/world/europe/3150775.stm> (retrived July 6, 2004). Beta "Gorazdevac Victims laid to Rest" Gusht 13, 2003.

⁹ "Tre serbë të vranë në Kosovë: U.N. Agence France Presse, Qershor 4, 2003.

¹⁰ Amnesty International, "Sërbia dhe Mali i Zi(Kosovo/Kosova): Komunitetet minoritare: Drejtat Fundamentale të Ndaluara," AI Index EUR70/011/2003, Prill 1, 2003 (online)

<http://web.amnesty.org/library/index/ENGEUR700112003>.

¹¹ OSBE, Gjakovë: Profil Komunal nëntor 2003.

¹² OSBE, Prizren: Profil komunal, nëntor 2003. OSBE llogarit se në dhjetor 2002 popullata serbe e Prizrenit ishte 194, mirpo ky numër përfshien edhe popullatën në disa enklava jashtë qytetit. Popullata e serbëve në vet qytetin e Prizrenit para dhunës ishte vetëm 36.

termin derogator si “Magjupë”. Ne periudhën e menjëhershme pas konfliktit të vitit 1999 shtëpive të RAE i ishte vënë zjarri, paralel me shtëpitë e sërbeve, poashtu komunitetet e RAE u ballafaquan me sulme vdekjepruese, kidnapime dhe forma tjera të dhunës.

Qendra koordinuese për Kosovë dhe Metohi e sponsoruar nga Beogradi e cila ka qenë e involvuar në formimin e strukturave paralele për popullatën sërbe të Kosovës, shënon se në vitin 2003 në Kosovë kishin mbetur diku rreth 130,000 sërb, numer ky i cili përputhet me shënimet e pavarura të bëra nga Iniciativa e Stabiliteteit Europian me bazë në Bruksel.¹³ Duke marrë parasysh se të dhënat e popullsisë për Kosovën janë, në të shumtën e rasteve të pa baza, këto shënime sygjerojnë se dy të tretat e popullatës serbe ende gjenden në Kosovë.

Me rëndësi është të përmendet se sërbyt e mbetur janë të zhvendosur brenda zonave të dominuara nga sërbyt në Kosovë.

Qëllimi i këtij raporti është që të bëjë një rekonstruim të dhunës së Marsit 2004 e cila shkatërroi një iluzion të një Kosove stabile dhe multietnike. Gjatë misionit dy javor në prill të vitit 2004 organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut Human Rights Watch gjeti dhe intervistoi dhjetra dëshmitarë dhe viktime nga shumica e zonave të cilat ishin prekur më së shumti nga dhuna, përfshirë aty Prishtinën, Mitrovicën, Obiliqin, Fushë Kosovën, Vushtrrinë, Frashërin, Gjakovën, Prizrenin, Belo Poljen, Decanin dhe Lipjanin. Raporti përshkruan keqpërdorimet e kryera nga shqiptarët e Kosovës dhe rëndësinë e tyre në komunitetet jo shqiptare përgjatë Kosovës. Raporti poashtu analizon edhe rolin e veprimtarëve ndërkombëtarë dhe vendorë gjatë krizës, duke përfshirë edhe udhëheqësinë Kosovare, shtypin vendor, strukturat vendore të sigurimit, dhe posaqërisht administratën e përkohshme të kombeve të bashkuara në Kosovë UNMIK-un dhe KFOR-in.

PRAPAVIJA: STATUSI I PAZGJEDHUR I KOSOVËS DHE ROLI I BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE NË KOSOVË

Me marrëveshjen e cila solli përfundimin e luftës së vitit 1999, Kosova erdhi nën administratë të përkohshme të Kombeve të Bashkuara me një sistem qeverisjeje dhe

¹³ Qendra koordinuese e Kosovës, Principi organizovanja samouprave nacionalnih zajednica na Kosovu i Metohiji.

(Principet e organizimit të vetqeverisjes të komuniteteve nacionale në Kosovë) (Beograd: 2003 Janar) (përafersisht 129,474 sërb mbetën në Kosovë në vitin 2002); Iniciativa e Stabilitetit Evropian, Principet e Lozanës: Multietniciteti dhe e ardhmja e sërbeve të Kosovës, Qershor 2004.

sigurie që përvec UNMIK-ut përfshinte forcat paqëruajtëse të KFOR-it të udhëhequra nga NATO, Organizatën për Sigurim dhe Bashkpunim në Europë (OSBE), dhe Bashkësinë Europiane. Edhe pse statusi përfundimtar i Kosovës – do të jetë kjo pavarësi apo ndonjë nivel i automomisë dhe relacionet me Unionin e Serbisë dhe Malit të Zi - nuk do të zgjedhen së paku deri në vitin 2005. UNMIK –u është poashtu i përfshirë në krijimin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, përfshirë aty krijimin e një Shërbimi Policor të Kosovës i cili do të jetë kredibil, i paanshëm dhe profesional.¹⁴

Deri më tani ende nuk është zgjidhur statusi i ardhshëm i Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK), strukturë kjo e formuar në vitin 1999 për të absorbuar antarët e demobilizuar të ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UCK).¹⁵ Trupat e Mbrojtjes së Kosovës me aspirata që në të ardhmen të jenë ushtria e Kosovës për momentin janë të emruara nga bashkësia ndërkombëtare si “organizate emergjente civile që ka për detyrë reagim të menjëhershme dhe asistencë humanitare kur të rrezikohet siguria publike.”¹⁶ Disa pjesëtarë të TMK-së kanë qenë të implikuar në keqperdorimet e të drejtave të njeriut kundër minoriteteve në Kosovë dhe involvim me organizatat kriminele. TMK-ja luajti një rol minimal gjatë dhunës së marsit 2004 në Kosovë, në shumtën e kohës duke qëndruar brenda bazës. Në disa zona të Kosovës, posaçërisht në atë të lindjes të udhëhequr nga KFOR-i Amerikan, TMK-së i është lejuar të luaj rol në qetësimin e turmës dhe të bëjnë patrollimin e përbashkët. Në zonën qendrore të Kosovës të udhëhequr nga KFOR-i Skandinav ofertat e TMK-së që tu ndihmojnë atyre në mbrojtjen e Cagllavicës ishin refuzuar qartazi, sepse KFOR-i skandinav nuk dëshoi të dorzoi asnjë element të përgjegjësive Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Organizatat e sigurisë në Kosovë si KFOR-i, i udhëhequr nga NATO, policia ndërkombëtare e UNMIK-ut, Shërbimi Policor i Kosovës, i rekrutuar nga vendorët, SHPK dhe TMK, në të shumtën e rasteve dështojnë që të koordinojnë aktivitetet e tyre në mënyrë adekuate. Një trend i përgjithshëm për transferimin e përgjegjësive prej KFOR-it së pari drejt policisë së UNMIK-ut dhe në fund drejt SHPK-se ka lënë përgjegjësi të paqartë në fushën e sigurisë në Kosovë. Për shembull, një burim i lartë diplomatik argumentonte se përgjegjësia konfuzë e KFOR-it dhe UNMIK-ut ndaj dhunës

¹⁴ Shiko UNMIK, " Policia dhe drejtësia(shtylla I)- Policia –Mandati,(online) <http://www.unmikonline.org/justice/police.htm>.

¹⁵ Ushtria Çlirimtare e Kosovës(UCK) ishte grup i armatosur shqiptar i cili luftonte kundër forcave serbe dhe jugosllave gjatë konfliktit të vitit 1998-99 në Kosovë.

Me përfundimin e konfliktit të vitit 1999, UCK dhe KFOR-i nënshkruan marrëveshjen për demobilizimin e UCK. Nën këtë marrëveshje antarët e UCK-së u absorbuan në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës. Disa komandantë të UCK-së të cilët ishin të involvuar në krime të luftës gjatë konfliktit 1998-99, janë paditur nga tribunale të vendore dhe ndërkombëtare. Disa pjesëtarë të UCK-së poashtu janë akuzuar të kenë lidhje me krim të organizuar dhe me elemente nacionaliste shqiptare.

¹⁶ Standardet për Kosovën, Numër VIII.

fillestare në Mitrovicë me 17 mars ishte pjesërisht rezultat i procesit të transferimit të përgjegjësisë nga KFOR-i te policia e UNMIK-ut e cila tani më po zgjaste me muaj:

Gjatë muajve të fundit, KFOR-i francez ishte detyruar të mbante një profil të ulët në Mitrovicë, duke qenë në një proces të ngadalshëm të tërheqjes nga Mitrovica dhe dorëzimit të përgjegjësisë drejt policisë së UNMIK-ut. Në këtë mënyrë humbën kontaktin [me burimet e intelegjencës].¹⁷

Pas dhunës së marsit, duket se KFOR-i dhe UNMIK-u pranuan nevojën për një koordinim më të madh të funksioneve të tyre. Në prill 2004, komandanti i KFOR-it për zonën qendrore dhe komandanti i policisë së UNMIK-ut lëshuan një deklaratë të përbashkët duke u zotëruar se “do të bëjmë trajnime dhe operacione të përbashkëta që të krijojmë një komandë dhe një sistem kontrolli më efikas, që së bashku të luftojmë cdo situatë me të cilën ballafaqohemi”.¹⁸

Themelimi Dhe Roli I KFOR-it

Lufta e Kosovës në vitin 1999 përfundoi me largimin e trupave serbe dhe jugosllave nga rajoni dhe themelimin e KFOR-it të udhëhequr nga NATO që të marrë përsipër sigurinë në rajon. Hyrja e KFOR-it në Kosovë dhe largimi gati simultan i forcave serbe dhe jugosllave ishte qeverisur nga marrëveshja teknike e 9 qershorit 1999 mes KFOR-it dhe qeverive të atëherë Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë.¹⁹ Rezoluta 1244 e këshillit të sigurimit e cila u adoptua me 10 qershor 1999, i dha mandat KFOR-it që të themeloj dhe mirëmbaj një rreth të sigurtë në Kosovë duke përfshirë përgjegjësinë për siguri dhe rend publik.²⁰

KFOR-i vazhdon të luaj një rol të spikatur në Kosovë, edhe pse numri i trupave është zvogluar dukshëm prej kohës kur është themeluar misioni, prej 50000 trupave në qershor të vitit 1999, në 18500 trupa në fund të vitit 2003. KFOR-i është i organizuar në seli, me qendër në Prishtinë, për momentin nën komandën e gjeneral-lajtnant Holger Kammerhoff të armatës gjermane (COM-KFOR). Gjenerali Kammerhoff raporton komandantit të NATO-s të forcave aleate për Europën Juglindore me bazë në Napoli,

¹⁷ Intervistë e Human Rights Watch me një burim diplomatik, Prishtinë, Prill 18, 2004.

¹⁸ OSBE Misioni në Kosovë, Departamenti i të drejtave të njeriut, “Sfidat e mbrojtjes së drejtave të njeriut lidhur me dhunën e marsit”. f.6.

¹⁹ Marrëveshja teknike ushtarake mes forcave ndërkombëtare të sigurisë(KFOR) dhe të Qeverive të Republikave Federale të Jugosllavisë dhe të Republikës së Serbisë, Qershor 9, 1999 (online) <http://www.nato.int/kfor/kfor/documents/mta.htm>

²⁰ Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, e adoptuar me Qershor 10, 1999.

Itali. Admirali Gregory Johnson per momentin është komandant i forcave të NATO-s për Europën juglindore.

Trupat e KFOR-it janë të ndara në mënyrë regionale në katër Brigada Multinacionale. Brigada Multinacionale Veri, nën komandën Franceze është përgjegjëse për zonat rreth qytetit të ndarë të Mitrovicës, së bashku me Zvecanin dhe Vushtrrinë.²¹ Brigada Multinacionale Lindje, nën komandën e Shteteve të Bashkuara, është përgjegjëse për zonat rreth Kamenicës, Gjilanit, Pasjanit, Ferizajit, Shtërpcës, dhe Kacanikut.²² Brigada Multinacionale qendër, nën komandën Suedeze, është përgjegjëse për zonat rreth kryeqytetit Prishtinës, Podujevës, Obilicës, Fushë Kosovës, Gracanicës dhe Lipjanit.²³ Brigada multinacionale jugperëndim, nën komandën italiane, është përgjegjëse për zonat rreth Pejës, Gjakovës, Prizren, Decan, Rahovec, Malishevë, Suharekë, Klinë, dhe Dragash.²⁴ Si shtesë KFOR-i ka një Njësi Speciale Multinacionale me bazë në Prishtinë, forcë kjo e policisë ushtarake e cila përqëndrohet në luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit.²⁵

Zvoglimi i numrit të trupave të KFOR-it në 18500, dukshëm ndikoi në aftësitë e KFOR-it që ti përgjigjet me efikasitet dhunës së marsit 2004. Përafërsisht një e treta e trupave të KFOR-it, ose përafërsisht 6000 trupa ishin pozicionuar në mënyrë aktive ushtarake, përderisa dy të tretat dhanë përkrahje të ndryshme logjistike. Aftësia e KFOR-it që ti përgjigjet me efikasitet dhunës ishte penguar në mënyrë të madhe nga rregullat e aksionit - në të shumtën e rasteve të njohura si “restrikcione kombëtare” - të cilat kombet e ndryshme i vënë mbi trupat me pozicionimin e tyre. Gati cdo komb i cili pozicionon trupa në Kosovë ka “rregulla kombëtare” specifike mbi pozicionimin e tyre - si për shembull duke kufizuar përdorimin e forcës vdekjepruese, pastaj kufizimin e pozicionimit në sektore të caktuara, ose kërkesa që trupat e tyre të kërkojnë leje nga autoritetet nacionale për aktivitete të caktuara, në vend se kjo të bëhet nga struktura e komandës së KFOR-it. Poashtu komandantët e Brigadave Multinacionale kanë një nivel të lartë të autonomisë mbi zonat e tyre të kontrollit, duke kufizuar aftësinë e përgjithshme të komandantit të KFOR-it (COM-KFOR) që të siguroj një përgjegjësi të

²¹ Shiko http://www.nato.int/kfor/mnb_northeast.htm (retrieved July 15, 2004) për informata më të hollshme shihni zonën e përgjegjësisë. Brigada multinacionale e veriut përfshien trupat kontribuese nga Belgjika, Danimarka, Estonia, Greqia, Luksemburgu, dhe Maroko.

²² Shiko (online) http://www.nato.int/kfor/mnb_east.htm, për informata më të hollshme shihni zonën e përgjegjësisë. Brigada multinacionale lindje përfshien trupat kontribuese nga, Armenia, Greqia, Lituania, Polonia dhe Ukraina.

²³ Shiko (online) http://www.nato.int/kfor/mnb_center.htm, për informata më të hollshme shihni zonën e përgjegjësisë. Brigada multinacionale qendër përfshien trupat kontribuese nga Republika Çeke, Irlanda, Latvia, Sllovakia, Finlanda, dhe Britania e Madhe.

²⁴ Shiko (online) http://www.nato.int/kfor/mnb_southwest.htm, për informata më të hollshme shihni zonën e përgjegjësisë. Brigada multinacionale jugperëndim përfshien trupat kontribuese nga Austria, Argjentina, Azerbejgjani, Bullgaria, Greqia, Gjermania, Hungaria, Rumania, Sllovenia, Spanja, Zvicra dhe Turqia.

²⁵ Shiko (online) <http://www.nato.int/kfor/msu.htm>, për informata më të hollshme.

ndërlidhur gjatë gjithë Kosovës në kohë të trazirave dhe poashtu të levizë trupat brenda komandave.

Themelimi Dhe Roli I UNMIKUT

Me rezolutën e njejtë që u themelua KFOR-i, këshilli i sigurimit të kombeve të bashkuara krijoi administratën e përkohshme në Kosovë (UNMIK). Ashtu sic sygjeron edhe emri, UNMIK-u ishte themeluar të shërbejë si administratë e përkohshme civile për Kosovën, dhe të promovojë themelimin e autonomisë substanciale dhe vetëqeverisjen në Kosovë duke promovuar themelimin e institucioneve përgjegjëse civile në Kosovë.²⁶ Nën udhëheqjen e përfaqësuesit special për Kombet e Bashkuara, UNMIK-u punon në nivele operationale, në katër “shtylla”: Shtylla 1 , përgjegjëse për policinë dhe administratën e drejtësisë, Shtylla 2, përgjegjëse për administratën civile, te dyja të implementuara nga Kombet e Bashkuara; Shtylla 3, demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve, është implementuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE); dhe Shtylla 4, rekonstruimi dhe zhvillimi ekonomik, i implementuar nga Bashkësia Europiane (B.E.)

Si pjesë të përgjegjësive të saja policore UNMIK-u ka krijuar policinë ndërkombëtare civile të UNMIK-ut, e cila është përgjegjëse për implementimin e ligjit të përkohshëm deri në krijimin e një Shërbimi Policor të Kosovës (SHPK) i cili do të jete “i besueshëm, profesional dhe jo i njëanshëm”.²⁷ Qysh nga dhjetori 2003, UNMIK-u kishte 3752 pjestarë të policisë ndërkombëtare në Kosovë, përfshirë aty edhe 2422 policë civil (CIVPOL), 975 pjestarë të policisë speciale dhe 355 policë kufitarë.²⁸ Policia speciale dallon prej policisë civile, sepse “ata përfaqësojnë një njësi të madhe paramilitare dhe forcë të vetmjaftueshme të pjestarëve të aftë për pozicionim të shpejt në situata të rrezikut të lartë”.²⁹ Pjestarët e policisë së UNMIK-ut vijnë nga 49 kombe kontribuese, nga Argjentina e deri te Zimbabve, dhe dallojnë mjaftë kur bie fjala për eksperiencën e tyre policore dhe njohjes së të drejtave të njeriut- pasi që disa prej tyre vijnë nga kombet të cilat kanë shënime të veta të keqpërdorimit policor.

Shërbimi Policor I Kosovës

²⁶ Rezoluta e OKB-së 1244, e aprovuar Qershor 10, 1999.

²⁷ UNMIK, “ Policia dhe Drejtësia(Shtylla I)- Policia, Mandati,”(online) <http://www.unmikonline.org/justice/police.htm>

²⁸ Deri në mars 2004, numri i policëve ndërkombëtar të UNMIK-ut ishte zvogluar në 3,248. Këshilli i sigurimit të OKB-së, “Raporti i sekretarit të përgjithshëm Kombeve të Bashkuara Administrata e Përkohshme Misioni në Kosovë,” Prill 30, 2004, ANNEX 1. U.N. Doc. S/2004/348.

²⁹ UNMIK, “Policia dhe Drejtësia (Shtylla I)- Policia, Mandati.” Në dhjetor 2003, UNMIK-u kishte njësi speciale nga India, Jordani, Rumania, Pakistani, Argjentina, Polonia dhe Ukraina.

Unmik-u si detyrë të saj ka poashtu edhe themelimin e Institucioneve të Përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës, përfshirë aty edhe formimin e një Shërbimi Policor të Kosovës i cili do të jetë i “besueshëm, profesional dhe jo i njëanshëm”. UNMIK-u dhe OSBE-ja punojnë së bashku që të trajnojnë pjestarë të rinjë për Shërbimin Policor të Kosovës, proces ky që ishte inicuar me trajnimin e grupit të parë të 176 policëve aspirues në shtator të vitit 1999 në shkollën e posa themeluar të SHPK-së në Vushtrri. Deri në mars të vitit 2004 janë trajnuar 5700 pjestarë të SHPK-së të cilët janë pozicionuar përgjatë Kosovës. Qëllimi përfundimtar i UNMIK-ut është që të trajnoj dhe pozicionoj rreth 6500 pjestarë të SHPK-së në Kosovë.³⁰

Në shumicën e stacioneve policore, pjestarët e SHPK-së punojnë nën mbikqyrjen ose në bashkëpunim me pjestarët e policisë ndërkombëtare të UNMIK-ut. Në krijimin e një shërbimi funksional policor të Kosovës sfidë kyçe ishte sigurimi i një strukturë të balancuar etnike. Siq është rasti me shumë institucione të tjera në Kosovë, përbërja e SHPK-së zakonisht reflekton përbërjen etnike të rajonit: në zonat me shumicë shqiptare, ka pak ose nuk ka sërbe apo pjestarë tjerë jo shqiptarë në strukturat e SHPK-së. Në zonat me shumicë sërbe si ajo e veriut të Mitrovicës, SHPK-ja zakonisht është tërsisht sërbe. Morali në mes të pjestarëve të SHPK-së mbetet sfidë primare, për shkak të mos besimit nga ana e organizatave të tjera të sigurisë, posaqërisht KFOR-it dhe për shkak të pagave të ulta që marrin për punën e tyre përplot sfida. Mosbesimi i dyanshëm i thellë ekziston mes Shërbimit Policor të Kosovës të dominuar nga shqiptarët dhe trupave franceze të KFOR-it në komandën e Brigadës Multinacionale – Veri: gjatë trazirave të marsit 2004, KFOR-i francez tentoi të shpërbëjë SHPK-në në jug të Mitrovicës, duke u refuzuar pjestarëve të SHPK-së të kryejnë detyrat e veta duke i bllokuar në punkte dhe, sipas disa raporteve, edhe duke konsideruar që t’ia vënë zjarrin stacionit policor të SHPK-së në jug të Mitrovicës.³¹

Pjestarët e SHPK-së janë të pajisur dobët për ti kryer detyrat e tyre. Pjestarët e SHPK-së pothuajse nuk kanë mjete për kontrollin e dhunës, si për shembull gas lotësjellës, topa uji, mburoja për trazira ose plumba gome. Shumicës së pjestarëve të SHPK-së u është dhënë vetëm një uniformë. Pagat e tyre janë minimale. Dy pjestarë të lartë të SHPK-së të intervistuar nga Human Rights Watch në Prizren dhe në Fushë Kosovë marrin pagë mes 240 dhe 250 euro në muaj, në një ekonomi ku cmimet mund të krahasohen me ato të Europës perendimore. Kur HRW pyeti një komandant të policisë së UNMIK-ut në Prizren se cka do të duhej të bënte bashkësia ndërkombëtare që të siguroj një përgjegje më efektive ndaj dhunës në të ardhmën në Kosovë, përgjegjja e tij e menjëhershme ishte:

³⁰ UNMIK, "Policia dhe Drejtësia (Shtylla 1)-Policia, Mandati."

³¹ ICG, Kollapsi në Kosovë, Prill, 2004, f.21.

“Të investojnë më shumë të holla në buxhetin e SHPK-së dhe tu ipet paisje elementare që cdo pjestarë i policisë duhet të ketë - neve nuk na nevojitet asgjë më tepër”.³²

SHKËNDIJAT TË CILAT SHKAKTUAN ZJARRIN

Përderisa dhuna e marsit në Kosovë ishte habi gati për të gjithë, qoftë vendor apo ndërkombëtar, ajo nuk erdhi papritmas prej askund. Pakënaqësia e thellë në shoqërinë kosovare lidhur me mungesën e progresit në zgjidhjen e statusit final të krahinës, stagnimi i vazhdueshëm ekonomik, bregat e thella për tentimet e Beogradit për një kontroll politik të konsoliduar në disa pjesë të Kosovës e la krahinën të gatshme për trazira. Kushtet ekonomike dhe socio-politike në Kosovë të cilat kontribuan dhunës së marsit janë cekur detajisht në raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizës (ICG).³³ Fati i 3430 njerëzve të cilët janë të zhdukur qysh nga fundi i luftës së vitit 1999 mbetet plagë e hapur në Kosovë. Cështja e të zhdukurve është simbol i gjerë i padrejtësisë, posaqërisht mes shqiptarëve, të cilët fajsojnë Beogradin për pengim të zgjidhjes dhe UNMIK-un për mungesë të veprimit.³⁴

Mungesa e progresit drejt përgjegjësisë për sulmet e pas luftës mbi minoritetet, e evidentuar nga numri i vogël i përndjekjeve të suksesshme të shqiptarëve etnik për dhunë kundër minoriteteve - ndihmoi që të krijohet një klimë e pa dënueshmërisë për dhunë politike në Kosovë.³⁵ Në të njejtën kohë arrestimet e komandantëve të ish UCK-së nga ana e UNMIK-ut shpesh herë kanë provokuar protesta të mëdha. Tensionet u rritën edhe më shumë kur më 12 mars në shtëpinë e presidentit të Kosovës Ibrahim Rugova shpërtheu një granatë, e cila shkaktoi vetëm dëme materiale.³⁶ Përkundër kësaj prapavije shqetësuese, në muajin mars ndodhën disa ngjarje paralele, të cilat ngritën tensionet në Kosovë që përfundimisht eksploduan në dhunë të hapur.

Vrasja E Jovica Ivic Në Cagllavicë

Më 15 mars rreth orës 8 në mëngjes, sulmues të panjohur nga një veturë shtien në tetëmbëdhjetë vjeçarin sërb Jovica Ivic në fshatin sërb të Cagllavicës në periferi të Prishtinës. Ivic ishte plagosur rëndë, me plagë në bark dhe në krah. Ivic thoshte se e dinte që sulmuesit ishin shqiptarë, sepse ata kishin bërtitur në gjuhën sërbe por me

³² Intervistë e HRW me një zyrtarë të UNMIK-ut, Prizren, Prill 13, 2004.

³³ ICG, Kolapsi në Kosovë, Prill, 2004.

³⁴ Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe forensikë, Statistikat OMPF, Qershor 9,2004(online) http://www.unmikonline.org/justice/ompf/040609_OMPf_ss.pdf

Sipas UNMIK-ut 2,564 të zhdukurve janë shqiptarë, 570 janë sërb dhe 206 nga grupet tjera.

³⁵ Një analizë e funksionimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë është mbi mundësinë e këtij dokumenti.

³⁶ Këshilli i Sigurimit të OKB-së, "Raporti i sekretarit të përgjithshëm mbi administratën e përkohshme të kombeve të bashkuara misioni në Kosovë," 30 Prill, 2004, para 7.U.N.Doc. S/2004/348.

akcent shqiptar para se të shtinin me armë.³⁷ Si përgjegjje ndaj shterjes me armë zjarri fshatarët sërb bllokuan rrugën kryesore Prishtinë –Shkup, rrugë kjo e cila kalon përmes fshatit Cagllavicë, ata poashtu bllokuan edhe rrugën Prishtinë-Gjilan e cila kalon përmes enklavës sërbe të Gracanicës. Është raportuar se disa shqiptarë duke kaluar nëpër fshatin Cagllavicë janë sulmuar dhe rrahur nga sërëbët, gjë që ndodhi edhe me kontigjentin e KFOR-it irlandez i cili u mundua që të largoj bllokadën rrugore në fshatin Cagllavicë.³⁸

Blokimin e rrugës kryesore Prishtinë – Shkup, e cila është një vijë jetësore ekonomike për shqiptarët, shqetësoi shumë shqiptarët, që u tregua qartë edhe në deklaratat e liderëve politik shqiptarë të cilët kritikuan paaftësinë (apo mosdëshirën) e bashkësisë ndërkombetare që të meret me bllokadën. Me erupimin e dhunës në Kosovë, shumë liderë shqiptarë u përqëndruan në bllokadë rrugore - duke e definuar si pengesë në “liri të lëvizjes” të shqiptarëve etnik - dhe si arsye kyçe të dhunës. Për shembull, Arsim Bajrami anëtar i PDK, udhëheqës i komitetit politik në parlament në një debat lidhur me dhunën e 17 marsit tha: “Ne jemi të pakënaqur me mënyrën se si vepron UNMIK-u, posaqërisht me paaftësinë që të vendoset liria e plotë e lëvizjes në Kosovë”.³⁹ Bllokada rrugore në Cagllavicë dëshmoi të jetë njëra prej pikave të para të përqëndrimit të protestuesve shqiptarë më 17 dhe 18 mars dhe vendi i disa prej ballafaqimeve më të ashpëra mes KFOR-it dhe shqiptarëve etnik (shiko më poshtë)

Pse kjo bllokadë provokoi sentimente aq të forta? Qështja e bllokadës rrugore në Cagllavicë dhe në Gracanicë nuk mund të ndahet nga brengosja e ngritur mes komunitetit të shqiptarëve etnik lidhur me institucionet “paralele” në enklavat sërbe, të sponsoruara nga Beogradi. Gjatë viteve të fundit autoritetet sërbe në mënyrë mjaft efektive kanë mirëmbajtur kontrollin mbi shumicën e enklavave sërbe në Kosovë, duke themeluar gjyqje, shkolla, sisteme të edukimit, struktura të sigurimit dhe shërbime mjeksore “paralele”, të cilat veprojnë jashtë kontrollit të UNMIK-ut.⁴⁰ Edhe pse krijimi i institucioneve paralele është sfidë direkte mandatit të UNMIK-ut në Kosovë, përgjegjja e UNMIK-ut ndaj këtij dobësimi themelor të mandatit të institucioneve në Mitrovicë, Gracanicë, dhe enklava të tjera sërbe ka qenë i dobët. Dështimi i UNMIK-ut që të konfrontoj krijimin e strukturave paralele në mënyrë efektive brengos udhëheqësinë shqiptare, e cila ka frigë se Beogradi tenton të krijoj gjendje faktike e cila do të bënte të pashmangshëm krijimin e kantonizimit të Kosovës. Mirëpo, pikëvështrimi shqiptarë injoron realitetin e jetës për shumë sërëb në Kosovë, për të cilët shfrytëzimi i shërbimeve

³⁷ “Sërbët e zemruar protestojnë kundët vresjes së djaloshit,” Agence France Presse, Mars 16, 2004.

³⁸ Conor Lanny, “Sërbët e Kosovës gjuajnë me gurë trupat irlandeze të U.N.,” Irish Times, Mars 17, 2004.

³⁹ Përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e mediave Miklos Haraszti, “Roli i mediave në Kosovë gjatë ngjarjeve të marsit 2004” Prill 2004, f.8.

⁴⁰ Shiko misionin e OSBE-së në Kosovë- Departamenti i të drejtave të njeriut, Strukturat paralele në Kosovë, tetor 2003.

elementare të ofruara nga shqiptarët është gati i pamundshëm për shkak të veprimeve diskriminuese.⁴¹

Roli I “Shoqatave Të Luftës”

Me 16 mars të viti 2004, të ashtuquajturat “shoqatat e luftës” të cilat janë tri organizata të nderlidhura që prezentojnë veteranët e luftës së UCK-së, Invalidët e UCK-së dhe familjet e personave të zhdukur organizuan protesta të gjithëmbarshme gati në cdo qytet në Kosovë, duke protestuar kundër arrestimeve të ish liderëve të UCK-së. Prortstat morën vull të posaqëm sepse në shkurt të vitit 2004 UNMIK-u kishte arrestuar katër ish pjestarë të UCK-se , përfshirë aty edhe komandantin e TMK-së për Prizren⁴² general Selim Krasniqin me padi kundër vrasjës së shqiptarëve gjatë konfliktit të Kosovës të vitit 1998-9.⁴³

Gjatë shumë demonstratave folësit erdhën shumë afër nxitjës së turmës që të ngriten kundër UNMIK-ut, kundër arrestimeve të ish liderëve të UCK-së. Kryetari i shoqates të invalideve të veteranëve të luftës Faik Fazliu, në Mitrovicë me 16 mars tha se “vazhdimi i nje veprimtarie diskriminmuese të UNMIK-ut ndaj anëtarëve të ish UCK-se do ta destabilizojë këtë rajon dhe si rezultat i revoltës dhe indinjatës së qytetarëve situata mund të dalë jashtë kontrollit”.⁴⁴ Faton Klinaku kryetar i që të tri shoqatave të dala nga lufta, po të njëjtën ditë iu drejtua turmës në Prishtinë duke thënë “neokolonialistët e quajtur UNMIK janë duke përkrahur krimin e organizuar dhe janë duke vazhduar aplikimin e politikës së njëjtë me atë të Sërbisë”.⁴⁵ Kryetari i shoqatës së veteranëve të luftës në Pejë, Nexhmi Lajci erdhi shumë afër thirjës për një luftë të re duke thënë publikut se, “Kosova tani është e okupuar (nga UNMIK-u) sikurse njëherit ishte okupuar (nga Sërbia) dhe ekziston frika së është duke shkuar drejt një lufte të re”.⁴⁶ Atmosfera e keqe e protestave pro-UCK në të cilat kishin marrë pjesë diku rreth 18,000 protestues në mbarë Kosovën, ishte përmbledhur mirë në titullin e gazetës nacionaliste Epoka e Re e cila si titull në ballinën e saj kishte një sllogan të dëgjuar nga protestat i cili thoshte “UNMIK ke kujdes, UCK-ja do t’ju vë zjarrin”.⁴⁷ Gjatë protestave në Prizren, protestuesit gjuajtën

⁴¹ Shiko OSBE dhe UNHCR,

⁴² Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) janë formuar pas luftës së vitit 1999 në mënyrë që të absorbojë antarët e ish UCK-së.

⁴³ Shaban Buza, “Arestimi i katër ish guerilëve nga ana e policisë së U.N.,” Reuters, Shkurt 16, 2004.

⁴⁴ UNMIK Monitoring i Mediave: Mediat Lokale, Mars 17, 2004(online)

<http://unmikonline.org/press/2004/mon/mar/imm170304.pdf>.

⁴⁵ Kosova Live, “UNMIK-u aplikon ligjet sërbe të dënojë luftëtarët, thonë protestuesit,” Mars 16, 2004

⁴⁶ UNMIK Monitoring i Mediave: Mediat Lokale, Mars 17, 2004.

⁴⁷ Përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e mediave Miklos Haraszti, “Roli i mediave në Kosovë gjatë ngjarjeve të marsit në Kosovë,” Prill 2004.

me gurë selinë e UNMIK-ut me c'rast lënduan një pjestarë të policisë civile të UNMIK-ut.⁴⁸

Përderisa protestat e 16 marsit nuk kishin lidhje direkte me dhunën e 17 dhe 18 marsit, ato formuan një bazë për protestat të cilat pasuan ditën e ardhshme, pasi që raportet senzacionale për fundosjen e tre fëmijëve shqiptarë mbrijtën publikun në po të njejtat gazeta të cilat raportuan mbi protestat pro –UCK. Me strukturat e mëdha organizative përgjatë Kosovës dhe duke marre parasysh faktin se kishin organizuar protesta në mbarë Kosovën, këto shoqata ishin të pozicionuara në mënyrë unike që ta shfrytëzojnë rastin dhe të drejtojnë dhunën që pasoi.

Fundosja E Tre Fëmijëve Në Lumin Ibër

Vrasja e Jovica Ivic në Cagllavicë me 15 mars dhe bllokada rrugore serbe e cila pasoi, e kombinuar me protesat të cilat përkrahnin UCK-në dukshëm rritën tensionet në Kosovë. Përderisa protestat në përkrahje të UCK-së po qetsoheshin, mediat etnike shqiptare filluan të japin raportime inflamatore se tre fëmijë janë ndjekur nga serbët në lumin Ibër me datën 16 mars dhe se ishin fundosur. Përfaqësi për liri të shtypit i OSBE-së më vonë deklaroi se „shtypi etnik shqiptar luajti një rol të papërgjegjshëm dhe inflamator në raportimin e informatave të cilat ende nuk ishin të konfirmuara: fëmiju i mbijetuar shqiptarë nuk tha asnjëherë në mënyrë publike se ata ishin ndjekur në lumë nga serbët, djaloshi tha se serbët i kishin sharë ata prej një shtëpi në largësi. Interpretimi se fëmijët ishin ndjekur në lumë nga serbët erdhi nga burime të tjera, si Halit Berani aktivist shqiptarë për mbrojtjen e drejtave të njeriut me bazë në Mitrovicë. Ndjeshmeritë e tilla nuk patën rëndësi për mediat shtetërore apo ato private, të cilat raportuan dhe shtypën raporte paekuoke se fëmijet shqiptarë kishin qenë të ndjekur në lumë nga serbët.⁴⁹

Zërat moderatorë si zëdhënësja e UNMIK-ut Tracy Beker, e cila paralajmëroi se motivimi etnik i incidentit nuk është i konfirmuar nuk pati peshë në media, përderisa” ekspertët “ të cilët denoncuan “banditët” serbe u ishte dhënë liri e papenguar dhe e pasfiduar. Për shembull, Halit Beranit kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Mitrovicë-një grup etnik shqiptarë për mbrojtjen e drejtave të njeriut me prapavije nacionale- i ishte dhënë 4 minuta në lajmet e RTK-së, në krahasim me 12

⁴⁸ Këshilli i sigurimit OKB-së, “Raporti i sekretarit të përgjithshëm mbi administratën e përkohshme të kombeve të bashkuara në Kosovë,” Prill 30, 2004, para 6.U.N. Doc. S/2004/348.

⁴⁹ RTV 21 filloi transmetimin e raportit të mbrëmjes me 16 mars me: “Dy serbë ndjekën katër fëmijë shqiptarë sot rreth orës 16:00 në fshatin Cabër, përderisa fëmijët u munduan të iknin prej tyre, ata kërcyen në lumin Ibër”. Transmetuesi publik RTK, filloi lajmet me fjalinë: “ Tre fëmijë shqiptarë, Florent Veseli 8 vjecar, Avni Veseli 11 vjecar dhe Egzon Deliu 12 vjecar, u zhdukën sot në ujrat e lumit Ibër, përderisa Fitim Veseli 14 vjecar u gjet. Ata janë viktima të një sulmi nga një grup serbësh në fshatin Cabër....” Shiko OSBE, “Roli i mediave,” f.7-8.

sekonda të cilat ishin dhënë zëdhënsës moderatore të UNMIK-ut. Berani i cili nuk ishte dëshmitar i ngjarjes i tha publikut:

Sot rreth orës 16:00 në fshatin Cabër, komuna e Zubin Potokut përderisa fëmijët po luanin në fshatin e lartë përmendur, u sulmuan nga një grup i banditëve serb të cilët e kishin një qen dhe u shanin nënat shqiptare, kështu që fëmijët u detyruan të iknin. Dy prej tyre arritën që të fshiheshin në rrënjët e një shelnje afër lumit Lumëbardh (Ibër) përderisa katër fëmijët tjerë ranë në lumë, i cili përpos që është shumë i thellë është shumë i ftohtë dhe shumë i shpejtë. Me siguri fëmijët nuk mund të notonin mirë. Përderisa njëri prej fëmijëve arriti që të mbijetojë duke dalur në anën tjetër të lumit, informata të tjera për fatin tre fëmijëve të tjerë ende nuk ka...

Ne jemi mësuar me këta banditët serbë...mendojme që kjo është hakmarrje për atë cka ndodhi në Cagllavicë [vrasjen e serbit], rast ky që dëshmoi se qka janë në gjendje të bëjnë serbët kur situata në Kosovë fillon të qetësohet.⁵⁰

Raportet senzacionale për fundosjen e fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër nga banditët serbë nisën një mori të zjarrtë të protestave dhe dhunës në Kosovë. Përderisa fundosja e tre fëmijëve ishte një tragjedi, në anën tjetër filloi një hulumtim i UNMIK-ut dhe gjyqtarëve të respektuar shqiptarë të cilët vënë dyshimet e tyre serioze mbi pjesëmarrjen e serbeve në fundosjet, duke marrë parasysh jopërputhshmëritë e ngjarjeve të treguara prej femiut që mbijetoi dhe dy fëmijëve të fshehur dhe poashtu një serbi të moshuar që atekohe po punonte në rrethinë. Grupi hulumtues i U.N. -it pas një hulumtimi të thellë të zonës ku ndodhi fundosja e fëmijëve, nuk arriti të gjejë asnjë serbë cili i pershtatetej përshkrimit të dhëne nga femiu i mbijetuar.⁵¹

DËSHTIMI NË MBROJTJE: JO AFTËSIA E KFOR-it DHE UNMIK-ut TË MBROJË SËRBËT DHE MINORITETET TJERA

⁵⁰ Ibid, p.10.

⁵¹ Konferenca e UNMIK-ut për shtyp, Prill 24, 2004 (online), <http://www.unmikonline.org/press/24/trans/tr280404.pdf> (retrieved July 6, 2004). Hulumtuesit e U.N. të cilët kontrolluan disa shtëpi në fshatin Donje Zupce, fshat ky prej të cilit vinin serbët e rinj, dhe zbuluan se banorët e fshatit ishin njerëz të vjetër:

"Banorët e fshatit janë kryesisht njerëz të vjetër, dhe, duke llogaritur edhe fëmijët e tyre, asnjë i ri serb nuk i përgjigjej përshkrimit."

Sulmet e gjithëpërhapura të shqiptarëve etnik mbi Sërbët, Romët, Ashkalitë dhe minoritetet tjera jo-shqiptare të cilat janë të dokumentuara në këtë raport, janë shkak i një brenge të madhe. Poashtu brengje tjetër janë edhe organizatat ndërkombëtare të sigurimit në Kosovë të cilat në ballafaqim me dhunën e marsit 2004 dhe me paaftësinë e KFOR-it, policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së dështuan të ofrojnë mbrojtje efektive minoriteteve të Kosovës gjatë dhunës dy ditore.

Në komunitet pas komuniteti, sërbët dhe minoritetet tjera ku një numër i madhe i tyre janë të moshuar dhe të dobët ishin lënë në mëshirën e protestuesve shqiptarë më orë të tëra, duke pritur KFOR-in dhe UNMIK-un që tu dalë në ndihmë. Një përmbledhje e dështimeve në mbrojtje tregon se në çfarë mënyre bashkësia ndërkombëtare i zgënjeu minoritetet e Kosovës në kohën kur u nevoiteshin më së shumti:

- Trupat e KFOR-it francez refuzuan që tu dalin në ndihmë banorëve sërb të Frashërit, edhe pse baza e tyre gjendet vetëm disa qind metra larg fshatit ku ishin djegur 137 shtëpi të sërbëve.
- Në Vushtrinë e afërt, vend ky i cili gjendet mes dy bazave të KFOR-it francez, turmat shqiptare shkatëruan të gjitha 69-të shtëpitë e Ashkalive, pa kurëfarë përgjegjje në ndërkohë prej KFOR-it francez apo policisë ndërkombëtare të UNMIK-ut.
- Në qytetin e Prizrenit, KFOR-i gjerman refuzoi të respektojë kërkesën për ndihmë nga policia ndërkombëtare e UNMIK-ut, ku turmat shqiptare shkatëruan të gjitha gjurmët e sërbëve në qytet të vjetra me shekuj, përfshirë aty disa ndërtesa fetare të cilat datonin prej shekullit të 14-të, poashtu duke djegur një njeri sërb brenda shtëpisë së tij dhe duke lënë të gjithë sërbët e mbetur në Prizren pa shtëpi.
- Në qytetin e Fushë Kosovës, vetëm disa pjestarë të policisë së UNMIK-ut i dolën në ndihmë sërbëve të rrethuar, kurse pjestarët e KFOR-it nuk ndihmuan fare, duke lënë një numër të vogël të pjestarëve vendor të SHPK-së të mbrojnë më shumë se 100 familje sërbe të shpërndara rreth qytetit. Një sërb ishte rrahur deri në vdekje, ndërsa ishin djegur me shumë se 100 shtëpi, ndërtesa e postës, shkolla sërbe dhe spitali sërb.
- Në kryeqytet, në Prishtinë banorët sërb të banesave të YU programit-kompleks banesor ky i ndërtuar që të ofroj strehim refugjatëve sërb nga Kroacia dhe

Bosnia-ishte rrethuar me orë të tëra nga turmat etnike shqiptare të cilat u vënin zjarrin banesave dhe shtienin mbi sërëbët, para se te evakuoeshin nga KFOR-i dhe policia ndërkombëtare e UNMIK-ut.

Edhe në vendet ku KFOR-i dhe UNMIK-u ishin prezent në të shumtën e rasteve ata ishin jo efektivë dhe në numër të vogël:

- Në Gjakovë, disa dhjetra trupa të KFOR-it tentuan të mbrojnë kishën e fundit ortodokse të mbetur në qytet derisa u kapluan nga turma dhe u desht të evakujnë pese banoret e mbetura sërbe të Gjakovës, të gjitha gra të moshuara.
- Në Belopojë, trupat italiane të KFOR-it dhe policia e UNMIK-ut nuk ishin në gjendje të shtyejnë prapa turmën e madhe të shqiptarëve e cila marshonte prej qytetit të Pejës, të cilët më pastaj i vënë zjarrin tridhjetë e dy shtepive të sërbeve, të cilat ishin ndërtaur për serbet e zhvendosur më parë.
- Në rrethinën e Prizrenit, trupat gjermane të KFOR-it u larguan nga manastiri i Arkangjelëve I cili daton prej shekullit 14 posa që ai u sulmua nga turma, duke evakuar priftërinjët dhe duke lënë që manastiri të digjet deri në temele.

Dështimi i policisë ndërkombëtare të UNMIK-ut dhe KFOR-it për t'iu përgjegjur dhunës në mënyrë efikase la pjesën më të madhe të punës në duart e SHPK-së. SHPK-ja e rekrutuar nga vendorët, shumë prej tyre të stërvitur shkurt, ishin dobët të pajisur për t'u marre me dhunën. Disa policë të SHPK-së vepruan në mënyrë profesionale dhe me guxim, duke rrezikuar jetrat e tyre për të shpëtuar sërëbët dhe minoritarë të tjerë të ngujuar në shumë qytete dhe fshatra. Mirpo disa policëtë tjerë të SHPK-së qëndruan në mënyrë pasive, duke refuzuar të ndërmarin hapa të mbrojnë sërëbët dhe minoritarët tjerë ose duke refuzuar të marrin pjesë në evakuime tyre. Në disa raste, disa policë të SHPK-së treguan njëanshmëri të qartë, duke arrestuar vetëm sërëbët dhe minoritarë të tjerë që po mbronin shtëpitë e tyre, duke injoruar sjelljen kriminale të shqiptarëve që po ndodhnin para syve të tyre. Në disa raste policët e SHPK-së janë akuzuar se kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në djegjen e shtëpive të minoritarve në Vushtri, Obilic dhe Fushë Kosovë.

Dështimi apo gati rrenimi i institucioneve të sigurimit të Kosovës gjatë dhunës së marsit 2004 është i padiskutueshëm. Gjë që është më vështirë të analizohet është pse institucionet e sigurimit të kosovës dështuan aq keq gjatë dhunës së marsit 2004. Është shumë më rëndësi që të bëhen hulumtime, në mënyrë që të bëhen disa reforma

institucionale në formimin e institucioneve të sigurimit dhe që të mënjanohet mundësia e një përmbysjeje të tillë në të ardhmën. Mirpo siq po duket KFOR-i dhe UNMIK-u po i rezistojnë një rishikimi të dështimeve të tyre. Shumica e zyrtarëve të KFOR-it apo UNMIK-ut me të cilët bisedoi HRW dhanë një pasqyre të pasaktë për ngjarjet e marsit dhe lidhur me përgjegjjen e tyre ndaj dhunës së marsit 2004,⁵² ose fajsuat njëri tjetrin për dështimet.

Zyrtarët ndërkombëtarë kanë qenë mjaft të hapur në kritikën e tyre ndaj lidershit kosovarë lidhur me dështimin e tyre gjatë krizës, mirpo ata nuk treguan një qëndrim të ngjajshëm kritik në evaluimin dështimeve të organizatave dhe institucioneve të tyre. Për shembull, Jean-Marie Guehenno, nën sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për organizatat paqëruajtëse, informoi Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, me ç'rast kritikoi liderшипin kosovar për rolin e tyre ambivalent gjatë krizës së marsit, në anën tjetër nuk dha asnjë kritikë për performancën e KFOR-it dhe UNMIK-ut duke thënë se "çka është e nevojshme janë veprimet konkrete të lidershit kosovarë dhe popullatës që të gjejnë shkaqet e dhunës etnikisht të motivuar dhe të implementohen masat që të mos përsëritet dhuna". Adam Thomson, përfaqësues i Britanisë së Madhe në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, u përgjegj duke uruar KFOR-it dhe UNMIK-ut për "rikthimin e qetsisë" në Kosovë.⁵³ Retorikat e tilla jokritike dhe vetëfalemderuese e injorojnë realitetin e dështimeve të KFOR-it dhe UNMIK-ut, dhe urgjencën me të cilën këto dështime duhet të adresohen në mënyrë që të parandalohet dhuna e marsit 2004. Raporti mbi Kosovën i sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Gjeneralit Kofi Annan me 30 prill me të cilin i raporton Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dështon të jap analizë kritike për performancën e UNMIK-ut dhe KFOR-it gjatë dhunës së marsit, mirpo arrin të analizoj përgjegjësinë e SHPK-së dhe politikanëve kosovarë.⁵⁴

NATO ka bërë një rishikim të veprimeve të KFOR-it gjatë dhunës së marsit 2004 i cili quhet "Mësimet e mësuara" mirpo dyshohet se këto të dhëna do të bëhen publike.⁵⁵ Sipas një zyrtari të lartë të UNMIK-ut, zyrtarët e policisë së UNMIK-ut poashtu kanë bërë një rishikim të përgjegjës së tyre ndaj dhunës, mirpo rezultatet e këtij rishikimi nuk

⁵² Për shembull, Zyrtarët e KFOR-it vazhdimisht i thanë HRW se KFOR-i duhej të zgjedhte në mes mbrojtjes së jetëve apo mbrojtjes së pronës së minoriteteve gjatë dhunës së marsit. Një karakterizim i tillë është plotsisht i gabueshëm, dhe injoron realitetin se KFOR luajti një rol të vogël në mbrojtjen e jetëve të minoriteteve në shumë komuna të prekura nga dhuna, siq shihet edhe në raport,

⁵³ Deklarata për shtyp e Këshillit të sigurimit të OKB-së, "Dhuna e marsit në Kosovë një hap i madhë prapa për stabilizim, Nën Sekretari për Paqëruajtje thotë Këshillit të Sigurimit," Prill 13, 2004, U.N.Doc. S.C/.8056

⁵⁴ Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, "Raporti i sekretarit të përgjithshëm mbi administratën e përkohshme të Kombeve të Bashkuara, misioni në Kosovë," 30 prill, 2004, U.N. Doc. S/2004/384.

⁵⁵ Shiko Shërbimi ndërkombëtar i informatave të sigurisë, Evropë, "Shënimet e NATO-së," Vol 6, No.2, Prill 2004 (online)

<http://www.isis-europe.org/ftp/Download/Nato%Notes%20v6n2.PDF>

janë bërë publike, dhe se nuk pritet që UNMIK-u të kete ndryshime të mëdha si rezultat i këtij rishikimi. Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Kofi Annan me 11 qershor, 2004 emroi ambasadorin norvegjez Kai Eide që të hulumtoj dhunën e marsit,⁵⁶ mirpo siq duket mandati i Eide's është që të hulumtoj "implikimet politike të dhunës mes shqiptarëve dhe sërbeve dhe rekomandoj mënyra se si banorëte provincës mund të jetojnë sërish së bashku në paqe", e jo përqëndrimi në dështimet e UNMIK-ut dhe KFOR-it që të ofrojnë siguri gjate dhunës së marsit. Zyrtarët gjerman poashtu kanë bërë një rishikim të tyre të brendshëm lidhur me veprimet e trupave të tyre gjatë dhunës së marsit, duke ardhur në përfundim se KFOR-i ishte i paafte të përmbush mandatin e tyre të sigurisë dhe që në mënyrë efektive të mbrojnë minoritetet në Kosovë, dhe poashtu shpreh brengat e tyre serioze lidhur me dështimin e trupave gjermane të KFOR-it që të përgjigjen në mënyrë efektive dhunës anti-sërbe në Prizren.⁵⁷

Përderisa ky raport i është adresuar dështimeve të institucioneve të sigurimit në Kosovë, për të kuptuar më mirë arsyen se pse ndodhën këto dështime nevojitet një kontakt më i lartë me komandantët dhe dokumentet që i posedojnë UNMIK-u, KFOR-I dhe SHPK-ja të cilat HRW nuk ishte në gjendje që ti marrë. Komandantët dhe ushtarët e të gjitha niveleve të përgjegjesisë duhet të intervistohen, dhe poashtu duhet të bëhet një rishikim i dokumentacioneve si për shembull informatat e intelgjencës, urdhërat e dhëna, kërkesat e pozicionimeve dhe një vlersim i pozicionimeve të mëvonshme. Sidoqoftë, edhe ky kontakt i kufizuar që i ishte dhënë HRW na sjell deri te disa përfundime lidhur me dështimin e institucioneve të sigurimit të Kosovës:

- 1) Dhuna në Kosovë ishte befasi për institucionet e sigurimit: Nuk ka asnjë dyshim se dhuna në Kosovë ishte një befasi për KFOR-in, UNMIK-un dhe SHPK-në, dhe se institucionet e sigurimit në Kosovë ishin të papregaditura që të merren me një dhunë të tillë masive. Përderisa askush nuk e ka paraparë dhunën në Kosovë, KFOR-I dhe UNMIK-u është dashur të parashohin më mirë se si mund të zhvillohet dhuna. Për shembull shumica e gazetarëve ndërkombëtarë kishin paraparë se dicka munt të ndodhte në Mitrovicë me datën 17 mars, mirpo KFOR-i francez nuk ishte pozicionuar në urë mes dy komuniteteve. Mungesa e

⁵⁶ Lajmet e UNMIK, "Kosovë: Përfaqesuesi norvegjez të udhëheq hulumtimet e U.N. në dhunën e marsit," Qershor 11, 2004 (online)

<http://www.unmikonline.org/>

⁵⁷ Renate Flottau et al., "Deutsche Soldate: Die Hasen Vom Amsselfeld," Der Spiegel (Germany) May 3, 2004.

pregaditjes nga UNMIK-u dhe KFOR-I tregon mungesën e kapacitetit të analizës dhe kapacitetit të intelgjencës.

- 2) UNMIK-u dhe KFOR-i nuk kishin kapacitet të mjaftueshëm që të i përgjegjen dhunës në mënyrë efektive: Pothuajse cdo zyrtarë i UNMIK-ut dhe KFOR-it me të cilët bisedoi HRW thanë se numri i trupave të tyre nuk ishte adekuat që të merrën me dhunën e cila po ndodhte në tërë Kosovën, dhe kërkuan rritje të numrit të trupave dhe zyrtarëve.
- 3) Trupat e KFOR-it dhe UNMIK-ut nuk ishin të trajnuar dhe pajisur në mënyre adekuate që të merren me protesta. Një problem i madhë në Kosovë është se trupat e KFOR-it zakonisht kanë fare pak eksperience që të merren me kontrollin e situatave të dhunës, dhe si rezultat i kësaj nuk dinë se si të përgjegjen në rastet e protestave. Mungesa e kapacitetit të KFOR-it që të reagoj në situata të dhunës ishte kritikuar ashpër nga një zyrtarë i lartë i UNMIK-ut në intervium e dhënë për HRW:

Ne gjithmone e kemi ditur se Kosova nuk do te pushtohet. KFOR-i eshte ne Kosove qe te mbroje kunder dhunes civile, shqetesimeve dhe dhunes etnike. Atyre nuk u nevoiten tanqe por mjete kunder trazirave, mburoja dhe ushtarë te trajnuar te meren me trazira publike. Nese KFOR-i nuk ka qene i pregatitur per nje trazire te tille publike, atehere pse jo? Qka kane menduar se kane ardhur per ne Kosove?⁵⁸

Siç u pa nga efikasiteti i trupave Britanike të specializuara për kontrollimin e situatave të dhunës të cilat u pozicionuan në Fushë Kosovë me datën 18 mars, një numër i vogël i trupave të trjnuara në mënyrë të duhur mund të kenë ndikim më të madhë se sa një numër i madhë i ushtarëve të zakonshëm pa paisje të duhura për kontrollimin e dhunës dhe pa trajnim adekuat. KFOR-i, UNMIK-u dhe SHPK-ja poashtu duhet të kenë mjetet e duhura për kontrollimin e dhunës, si mburojat, teshat mbrojtëse, gas lotsjellës, plumba gome, topa uji- të cilat u mundësojnë përgjegje efektive dhe jo vdekjepruese ndaj dhunës.

- 4) Mungesa e një përgjegje të koordinuar nga KFOR-I, UNMIK-u dhe SHPK-ja ngadalsoi përpjekjet e tyre. Është shumë mirë e ditur se ekzistojne tensione të ndryshme mes organizatave te sigurisë në Kosovë, dhe se koordinimi mes

⁵⁸ Intervistë e HRW me një zyrtar të UNMIK-ut, Qershor 13, 2004

KFOR-it, UNMIK-ut dhe SHPK-së është minimal. Poashtu edhe brenda KFOR-it koordinimi mes brigadave multinacionale është minimal, dhe struktura e komandës mes brigadave multinacionale dhe COM_KFOR-it nuk është unike. Një zyrtarë I lartë I UNMIK-ut përshkruajti saktë mungesën e një komande unike të KFOR-it:

KFOR-it i mungojnë strukturat komanduese dhe kontrolluese. Lt-Gen. Kammerhoff teoretikisht është komandant mirpo kjo është vetëm ceremoniale. Vendimet ditore merren nga kontingjentet kombëtare të cilat marrin intrukcionet prej kryeqyteteve të tyre, kurse intrukcionet e Kammerhoff-it janë sekondare.⁵⁹

Duhet të adresohet dhe rregullohet mosbesimi dhe mungesa e kooperimit në mes të institucioneve të sigurimit në Kosovë. NATO ka njohur problemet strukturale të komandës dhe kontrollit me të cilat është ballafaquar KFOR-i, dhe në mbledhjen e ministrave të mbrojtjes në dhjetor të vitit 2003 premtoi se “do të bëhet restrukturimi i KFOR-it mirpo për momentin numri i trupave nuk do të bie nën 17,500”.⁶⁰ Mirpo, shumë pak progres ishte bërë në procesin e restrukturimit deri në mars të vitit 2004 kur shpërtheu dhuna në Kosovë.

- 5) Institucionet ndërkombëtare të Kosovës përfshirë aty UNMIK-un dhe KFOR-in poashtu ishin të prekura nga dhuna dhe u nevoitej mbrojtje, që do të thoshte tërheqjen e resurseve prej mbrojtjes së pakicave. Përderisa ky raport fokusohet në dështimin e UNMIK-ut dhe KFOR-it në mbrojtjen e minoriteteve gjatë dhunës së marsit, atyre u është dashur të drejtojnë resurset drejt mbrojtjes së vetëvehtës. Vetë zyrtarët e UNMIK-ut ishin në shënjestër përgjatë Kosovës. Më shumë se 100 automjete të UNMIK-ut ishin djegur ose dëmtuar seriozisht gjatë dhunës. Në mes të personave të plagosur ishte edhe një numër I zyrtarëve të UNMIK-ut: 65 pjestarë të policisë ndërkombëtare të UNMIK-ut, 58 pjestarë të SHPK-së dhe 61 pjestarë të KFOR-it u lënduan gjatë trazirave.
- 6) Një prej prioriteteve kryesore duhet të jetë trajnimi i Shërbimit Policor të Kosovës, dhe paisja me mjete të duhura. Pjestarët e SHPK –së do të luajnë një

⁵⁹ Ibid. Zëdhënësi i KFOR-it Lt-col. James Moran ngajshëm përshkruajti lidhjen në mes Lt-Gen Kammerhoff dhe komandantëve të brigadave multinacionale;” COM-KFOR nuk mund tu japë urdhëra komandantëve të brigadave, mirpo ata marrin udhëzime nga COM-KFOR.”Intervistë e HRW me zëdhënësin e KFOR-it Lt-Col. Moran, Prill 19, 2004.

⁶⁰ NATO defense Ministerial,” Final Communique,” December 1, 2003.

rol shumë të rëndësishëm drejt zgjedhjes së statusit final të Kosovës. Shumë prej pjestarëve të SHPK-së vepruan në mënyre profesionale dhe me guxim gjatë dhunës së marsit, në kushte shumë të vështira. Përderisa disa pjestarë të tjerë të cilët morën pjese ose qëndruan pasivë gjatë dhunës duhet të sillen para drejtësisë, poashtu është shumë me rëndësi të njihen ata të cilët shërbyen me trimëri dhe nder. Poashtu duhet të bëhet edhe gradimi I paisjës dhe trajnimit për pjestarët e SHPK-së, pagat e të cilëve do të duhej të jenë në nivel me sektorin privat.

DHUNA: SULMET E SHQIPTARËVE MBI SËRBËT DHE ROMËT

A Ishte Dhuna Spontane Apo E Organizuar?

Dhuna e marsit në Kosovë e cila përfshiu përafërsisht 50,000 protestues, u përshkrua nga ana e zyrtarëve ndërkombëtarë si dhunë e organizuar nga ekstremistët etnik. Zëdhënësi i UNMIK-ut Derek Chappell tha se këto akte të dhunës duket se kanë “një shkallë të organizimit prapa tyre”. Gjatë vizitës së Harri Holkerit me 23 mars qytetit të Obilicës, deklaroi se ekstremistët shqiptarë “kishin plan paraprak” për dhunën e marsit.⁶¹ Kurse sekretari i përgjithshëm i NATO-së Jaap de Hoop gjatë vizitës së tij në Kosovë me datën 22 mars e përshkruajti dhunën si të “papranueshme” dhe të “orkestruar” e cila ishte e organizuar nga fraksionet ekstremiste në komunitetin shqiptarë.⁶² Me vizitën e përfaqësuesit të lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri Javier Solanës në Kosovë vetëm disa ditë pas dhunës së marsit me c’rast ai përshkruajti dhunën si të organizuar dhe tha: “ndoshta ka pasur momente të spontanitetit, por shumica e njerëzve ishin organizuar që të shfrytëzojnë ato momente të spontanitetit.”⁶³ Komandanti i forcave të NATO-së për Europën Jugore, Admirali Gregory Johnson, komanda e të cilit përfshien trupat e KFOR-it në Kosovë të udhëhequra nga NATO-ja, tha se prapa dhunës në Kosovë ekziston “një sasi e vogël e organizimit” dhe përshkruajti dhunën duke shkruar në “drejtim të një spastrimi etnik”.⁶⁴ Sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Sigurimit, Gjenerali Kofi Annan në raportin e tij për Kombet e Bashkuara deklaroi se: “sulmet e

⁶¹ Nebi Qena, “U.N. akuzon shkaktarët e dhunës në Kosovë për krime kundër njerzimit.” Agence France Presse, Mars 24, 2004.

⁶² “Shefi i NATO-së thotë dhuna në Kosovë ishte e orkestruar,” Agence France Presse Mars 22, 2004

⁶³ Paul Ames, “BE Solana thotë dhuna në Kosovë mund ta shtyjë vendimin për të ardhmën e Kosovës,” Associated Press, 25 mars 2004. Solana poashtu bëri vërejtje se dhuna nuk duhet të shpërblehet: “Nëse disa njerëz mendojnë se me dhunë mund të shpejtojnë vendimet e bashkësisë ndërkombëtare, e kanë gabim....Ju nuk mund të paramendonit të lëvizni drejt një vendimi me statusin nëse standardet nuk janë përmbushur....shkatërimi i kishave, shkollave, përndjekja e njerëzve nga shtëpitë e tyre nuk janë standarde të cilat i mbron BE-ja”.

⁶⁴ “Dhuna në Kosovë mund të ketë qenë e organizuar-zyrtarë i lartë i NATO –s,” Agence France Presse, Mars 18, 2004.

udhëhequra nga ekstremistët shqiptarë në Kosovë kundër komunitetit serb, romë dhe ashkali ishin të organizuara, të gjithëpërhapura dhe kishin qëllim të caktuar”.⁶⁵

Në të vërtetë, dhuna e marsit në Kosovë kishte elemente spontane dhe ato të organizimit. Një prej arsyeve kryesore pse këto protesta u rritën dhe u shëndruan në të dhunshme aq shpejte është se rinia kosovare shqiptare është shumë e frustruar, dhe siq tha edhe një diplomat i huaj “janë në disponim të demonstrojnë”.⁶⁶ Në të shumtën e rasteve komponenta kryesore e turmës ishte rinia shqiptare, e cila e kishte arritur adolehencën pas konfliktit të vitit 1999, dhe të cilët ndjehen të marginalizuar dhe thellë të frustruar nga mungesa e mundësive të dhëna nga ekonomia e stagnuar e Kosovës. Vetë fakti se shumë shqiptarë të zakonshëm u bashkangjitën dhunës spontane kundër fqinjëve të tyre serb dhe romë, i paraqet një sfidë më të madhe mundësisë së një Kosove multietnike, se sa dhuna etnike e organizuar nga një pakicë e ekstremistëve shqiptarë. Është shqetsuese se konflikti I vitit 1999 ka lënë prapa shumë njerëz të njohur mirë me dhunën etnike, që të dyja viktimat dhe pjesëmarrës. Me fjalë të tjera shumë individë në Kosovë e dinë mirë se si i vihet zjarri shtëpisë së fqijut, me ose pa organizim prapa këtij lloji të dhunës.

Përderisa shumica e protestuesve shqiptarë ju bashkangjitën protestave në mënyrë spontane, padyshim se disa elemente ekstremiste shqiptare punuan drejt organizimit dhe përshpejtimit të dhunës. Sikurse gjatë vitit 1998-99 kur UCK vepronte kundër forcave jugosllave, shumica e elementeve ekstremiste ishin organizuar në nivel lokal e jo në atë regjional, dhe afiliatat e tyre dallonin prej qyteti në qytet. Disa ishin antarë radikal të partive politike shqiptare, të tjerët ishin ish pjesëtarë të UCK-së, dhe disa të tjerë ishin antarë të grupeve ekstremiste si “Armata Kombëtare Shqiptare” inicialet e të cilës mund të shihen shpesh të shënuara në vendet ku ndodhin protestat.

Elementet e dhunës qoftë ato spontane, qoftë të organizuara vepruan me një qëllim të përbashkët: për të hequr qafe praninë e mbetur serbe dhe poashtu goditën edhe minoritetet tjera në Kosovë. Me të filluar dhuna u shpërnda përtej Kosovës në mënyrë shumë precize: dy ditë pas fillimit të protestave, cdo shtëpi serbe, rome apo ashkali u shkatërua në shumicën e komuniteteve të prekura nga dhuna, kurse shtëpitë e fqinjëve shqiptarë kishin mbetur të paprekura.

Përleshjet Në Mitrovicë Dhe Në Cagllavicë

⁶⁵ Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara Misioni në Kosovë,” 30 prill, 2004, para 2 U.N. Doc S/2004/348.

⁶⁶ Intervistë e HRW me një diplomat, Prishtinë, Mars 18, 2004.

Sikurse edhe shumë herë më parë dhuna në Kosovë filloi në Mitrovicë, në urën e cila ndan pjesën veriore të qytetit të banuar me sërbe etnik me pjesën jugore të banuar nga shqiptarët. Edhe pse dhuna ishte rezultat i paraparë, duke marre parasysh rrjedhën e mëparshme të ngjarjeve, ajo zuri të papregaditur UNMIK-un dhe KFOR-in në mëngjesin e 17 marsit.

Një fotoreporter ndërkombëtar shpjegoi rrjedhën e ngjarjeve për HRW, ai kishte arritur në Mitrovicë rreth orës 10:45min, ku një proteste e nxënësve ishte në zhvillim e sipër të cilët po shkonin rrugës e cila qon drejt urës.⁶⁷ Urë kjo e cila është simbol i ndarjes së qytetit dhe e cila ka qenë një vend i rrezikshëm gjatë dhunës së mëparshme. Marshimi ishte organizuar nga arsimitarët shqiptarë të cilët po protestonin lidhur me fundosjen e tre fëmijëve një ditë më parë.⁶⁸ Pjestarët e SHPK-së dhe disa policë të UNMIK-ut ishin të pozicionuar që të bllokojnë rrugën që qon tek ura. Papritmas, një grup i madhë i meshkujve erdhi prapa nxënësve duke brohoritur “te ura! te ura!” dhe vrapuan drejt urës duke kaluar nëpërmes barikadës së SHPK-së dhe UNMIK-ut. Pjestarët e SHPK-së dhe UNMIK-ut tentuan të rigrupohen te ura duke përdorur shufra gome për të shtyer prapa turmën, të cilëve u bashkangjiten një grup i policëve Jordanez të specializuar për kontrollimin e dhunës. Fotoreporteri ndërkombëtar shpjegoi se cka ndodhi pastaj:

Unë fillova te vrapoj me turmën e njerëzve, dhe me tu afruar urës pashë një barikadë të papërfunduar dhe një numër të vogël të policëve të SHPK-së dhe UNMIK-ut. Me afrimin e turmës afër urës këta policë u munduan ti ndalojnë por numri i protestuesve ishte shumë më i madhë, pastaj vërejtja se pas këtyre policëve nuk kishte asgjë tjetër ta ndalte turmën. Në situata të tilla në Mitrovicë do të ishte e zakonshme që trupat KFOR-it ta bllokonin urën por atë ditë nuk pashë asnjë ushtarë të vetëm në urë. Protestuesit shqiptarë ishin po aq të befusuar sa isha edhe unë, shumica prej tyre dukeshin të pasigurtë se si të vepronin tani, por udhëheqësit e protestës thirën që të shkonin përpara, kështu që ata kaluan në anën sërbe.⁶⁹

Me të kaluar urën, shqiptarët filluan të sulmojnë restorantin Dolce Vita i cili gjendet përbri urës në anën e veriut, dhe disa automjete. Restorani ishte një vend i njohur për nacionalistët sërbe të quajtur “rojat e urës” të cilët vepronin në periudhën e pasluftës. Banorët sërbe të Mitrovicës dolën që ti luftojnë shqiptarët kurse pesëmbëdhjetë minuta

⁶⁷ Komunikim përmes email me fotografimin ndërkombëtar Andrew Testa, maj 2004.

⁶⁸ ICG, Rrëmuja në Kosovë, f.44.

⁶⁹ Komunikim përmes email me fotografimin ndërkombëtar Andrew Testa, maj 2004.

më vonë pjestarët e UNMIK-ut u rigrupuan që ti shtyejnë shqiptarët në anën tjetër të urës. KFOR-i arriti pasi që shqiptarët ishin shtyrë në anën tjetër të urës.

Në të njejtën kohë, një grup i shqiptarëve i cili kishte shkuar në urën tjetër kishte filluar të gjuante me gurë shtëpitë e serbëve. Ata ishin të paafte që në tërsi ta kalojnë urën sepse aty gjendet një pozicionim i përhershëm i trupave të KFOR-it të cilët si përforsim kishin policinë e UNMIK-ut. Së paku një granatë ishte hedhur nga ana serbe, duke plagosur së paku shtatë shqiptarë dhe disa trupa të KFOR-it francez. Gati në të njejtën kohë dy shqiptarë vrapuan drejt urës me pushkë AK-47 dhe filluan të gjuanin nga ana serbe.⁷⁰ Pasi një shkëmbim zjarri si pasojë e të cilit katër shqiptarë mbetën të vdekur dhe shumë të tjerë të plagosur.⁷¹ Burimet e policisë së UNMIK-ut më vonë deklaruan se ushtarët francez refuzuan të përdorin granata të cilat bëjnë zhurëm në mënyrë që ta parandalojnë turmën, dhe nuk posedonin municion që ti përgjigjeshin dy shqiptarëve të cilët gjuanin në drejtim të urës.⁷²

Me reagimin e shqiptarëve nga regjioni qendror i Kosovës ndaj lajmeve mbi luftimet dhe vdekjet në Mitrovicë, pikë tjetër e tensionuar ishte bllokada e rrugës nga ana e serbëve në fshatin Cagllavicë. Studentëve nga universiteti Prishtinës u ishin dhënë fletushka me anë të cilave i trimëronin ata që ti bashkangjiten protestës në Cagllavicë. KFOR-i dhe UNMIK-u u munduan që të parandalonin me mijëra shqiptarë që të hyjnë në fshatin e Cagllavices dhe në enklavën serbe përreth, kështu që aty ndodhën disa prej përleshjeve më të ashpra mes turmës shqiptare dhe trupave të KFOR-it dhe UNMIK-ut. Beteja vazhdoi në rrugën kryesore, prej orëve të hershme të pasditës e deri në mbrëmje, me c'rast edhe trupat ndërkombëtare u sulmuan nga turma shqiptare. Si përforsim i truve suedeze të KFOR-it në mbrëmje erdhën marincat amerikanë, kështu që trupat ndërkombëtare morën pengun turmën shqiptare për të hyrë në Cagllavicë.

Luftimet e ashpëra në Cagllavicë vazhduan edhe ditën e nesërme. Përgjatë tërë ditës militantët shqiptarë vazhduan të përlesheshin me trupat e përforsuara të KFOR-it të cilët tashmë e kishin bllokuar rrugën. Gjatë kësaj kohë ishte shtier pothuajse në mënyrë të rregullt mbi ushtarët e KFOR-it, me c'rast ata edhe vranë katër shqiptarë.⁷³ Kryeministri Bajram Rexhepi dhe disa pjestarë të kabinetit të tij në mbrëmje shkuan të takohen me turmën, duke u bërë lutje që të ndalen, vetëm disa minuta më vonë turma u shpërnda.⁷⁴

⁷⁰ Ibid

⁷¹ Ibid

⁷² ICG, Rrëmuja në Kosovë, f.45.

⁷³ ICG, Rrëmuja në Kosovë. f49.

⁷⁴ Intervista e HRW me Kryeministrin Bajram Rexhepi, Prill 19,2004

Sulmet Kundër Sërbëve Dhe Romëve Dhe Dështimi Në Mbrojtje

Përleshjet në Mitrovicë dhe Cagllavicë morrën një vëmendje të madhe të mediave, duke krijuar ndjenjën se shumica e përleshjeve në Kosovë ishin në mes të shqiptarëve dhe trupave ndërkombëtare të UNMIK-ut dhe KFOR-it, dhe se KFOR-i ishte përgjegjur në mënyrë të drejtë ndaj dhunës. Sidoqoftë, në të njëjtën kohë një valë masive e dhunës e kishte përfshirë tërë Kosovën, duke pasur në shënjestër sërëbët dhe komunitetet tjera jo shqiptare. Përkundër asaj që ndodhi në Cagllavicë ku trupat ndërkombëtare u pozicionuan në mbrojtje, minoritetet shqiptare përgjatë Kosovës ishin lënë në mëshirën e sulmeve të shqiptarëve etnik, pa ndonjë mbrojtje të rëndësishme nga trupat e KFOR-it apo UNMIK-ut.

Prishtinë

Pas luftës së vitit 1999 pothuajse nuk kishin mbetur sërëbë të cilët vazhduan të jetonin në kryeqytet, në Prishtinë, përpos disa personave të vjetër të izoluar të cilët vazhduan të jetonin në shtëpitë e tyre, dhe disa dhjetra familje sërëbe të cilat jetonin në apartamentet e ashtuquajtura Programi YU në një lagje të Prishtinës, në Ulpianë. Personat të cilët jetonin në apartamentet e YU Programit ishin, refugjatët sërëb nga Bosnia dhe Kroacia për të cilët edhe ishin ndërtuar këto banesa kah mesi i viteve 1990-ta, poashtu edhe sërëbët e zhvendosur pas konfliktit të vitit 1999 dhe disa sërëb të cilët punonin për organizata të ndryshme ndërkombëtare në Kosovë.

Protestat e shqiptarëve etnik nga Prishtina me datën 17 mars , dukej se ishin shumë mirë të organizuara, edhe pse në fillim nuk ishin të përqëndruara në Prishtinë , por u përqëndruan që ti bindin shqiptarët tu bashkangjiten protestave në Cagllavicë. Në konviktet e studentëve, studentët gjetën fletushka të cilat i nxisnin ata që tu bashkangjiteshin protestës në Cagllavicë dhe të cilat ishin nënshkruar në emër të këshillit organizues. Zyrtarët e universitetit të Prishtinës, përfshirë aty edhe Kryetarin e Unionit të Pavarur të Studentëve Gani Morina dhe Rektori I Universitetit të Prishtinës Zejnel Kelmendi iu drejtuan turmës së studentëve duke “alternuar mes nxitjes dhe zbutjes së emocioneve të turmës.”⁷⁵ Gjatë ditës vrulli I protestave vazhdoi të rritet.

Në mbrëmje kur turma filloi të kthehet në Prishtinë nga beteja me KFOR-in dhe UNMIK-un në Cagllavicë, vëmendjen e tyre e fokusuan në apartamentet e YU Programit, të cilat strehonin shumicën e sërëbëve të mbetur në Prishtinë. Diku rreth orës 19:00 Milanka Stefanovic po vënte në gjumë vajzë e saj tetë vjecare, kur dëgjoji se turma e disa qindra shqiptarëve ishin mbledhur jashtë, duke brohoritur “UCK, UCK” duke u

⁷⁵ Ibid

thënë banorëve sërbe “shkoni në Sërbë”, dhe duke u kërcnuar se do ti vrisnin ata.⁷⁶ Apartamentet u sulmuan në mënyrë të vazhdueshme nga turma, deri në momentin kur është evakuuar personi i fundit rreth orës 1 pas mesnatës. Protestuesit shtienin mbi ta, vidhnin, u vënin zjarrin apartamenteve dhe poashtu rrahën dhe therën disa prej banorëve sërbe.

Të ngjuar në disa apartamente të cilat kishin dyer të përfotcuara, ata mund ti merrnin erë tymit I cili po vinte nga apartamentet të cilat po digjeshin mëposhtë. Dragan Smiljanic I cili ishte njëri prej banorëve të YU Programit ishte kapur nga një grup i shqiptarëve përderisa po ikte prej apartamentit të tij dhe ishte therur në fytyrë.⁷⁷ Banorët sërbe dëgjonin se si turmat shqiptare thenin banesat, vidhnin dhe më pastaj u vënin zjarrin atyre. Dyzet e shtatë vjecarja Zivka Savic përkujton se cka ndodhi atë natë:

Shqiptarët po vinin prej të gjitha drejtimeve. Ne dëgjuam të shtëna revolesh dhe pushkësh. Në ndërkohë vazhduam të kërkonim ndihmë mirpo askush nuk vinte. Nipi im ishte shtrirë, kur një plumb hyri në dhomë duke qëlluar tavanin e mëpastaj duke rënë mbi shtratin e nipit tim. Turma po shkatronte gjithëcka, e ne nuk dinim se cka do të ndodhte me ne.⁷⁸

KFOR-i dhe UNMIK-u nuk u përgjegjën thirrjeve të sërbeve për ndihmë deri në orën 22:00, kurse shumica e banorëve nuk u evakuan deri në orën 1:00 pas mesnate, gjashtë orë pas fillimit të sulmeve.

Të gjithë sërbyt e intervistuar nga HRW thanë se, ata kishin thirur KFOR-in dhe UNMIK-un në kohën kur kishin filluar sulmet, dhe kishin vazhduar ti thërisnin ata gjatë tërë natës duke u lutur që tu vijnë në ndihmë. Diku rreth orës 10 në mbrëmje, tri orë pasi që kishin filluar sulmet, dy automjete të KFOR-it irlandez arritën që të kalonin përmes turmës së armiqsuar dhe të arrin tek apartamentet e rrethuara të YU Programit. KFOR-i irlandez duke shtirë në ajër arriti që përkohsisht ta shpërndajë turmën duke shtirë në ajër.⁷⁹ Trupat e KFOR-it arritën që të evakojnë fëmijët dhe personat e ndjeshëm, mirpo nuk arritë ti evakojnë të gjithë banorët.⁸⁰ Një grupë e kombinuar e policëve të UNMIK-ut dhe KFOR-it ishin shtyrë prapa disa herë me rradhe nga ana e

⁷⁶ Intervista e HRW me Milanka Stefanovic, Prill 9, 2004.

⁷⁷ Intervista e HRW me Radojka Raskovic, Prill 17, 2004.

⁷⁸ Intervista e HRW me Zivka Savic, Prill 17, 2004.

⁷⁹ Ibid. Disa dëshmitarë të tjerë thonë se evakuimi i parë filloi rreth orës 12:30, kurse i dyti 2:30.

⁸⁰ Intervista e HRW me Radojka Raskovic, Prill 17, 2004 Gracanicë.

turmës shqiptare,⁸¹ të cilët më në fund arritë ti afrohen diku rreth orës 1 pas mesnate, 6 orë pas fillimit të sulmeve. Turmat shqiptare sulmuan automjetet të cilat po evakuonin sërëbët, duke i gjuajtur me gurë dhe duke u munduar tu bllokojnë rrugën me kontejnerë të bërllotut.⁸²

Dhuna kundër banorëve sërëb dhe ndërtesave sërëbe vazhdoi edhe me 18 mars. Në mbremjen e 18 marsit, një grup i shqiptarëve, shumica prej të cilëve ishin të rinj, sulmuan kishën ortodokse të Shën Nikollës e cila gjendet në pjesën e vjetër të qytetit. Shërbimi Policor i Kosovës dhe pjestarët italianë të policisë së UNMIK-ut organizuan një mbrojtje joefektive dhe të pakoordinuar të kishës, me ç'rast pjestarët italianë të policisë së UNMIK-ut aksidentalisht gjuajtën pjestarët e SHPK-së me gas lotsjellës dhe poashtu shtien tri herë me rradhë në një pjestarë të policisë së SHPK-së.⁸³ Rreth orës 8 në mbremje ,pjestarët italianë të UNMIK-ut arritën të shpërndajnë turmën e diku rreth 200 shqiptarëve të cilët e kishin rrethuar kishën ortodokse, dhe menjëherë filluan evakuimin e priftit dhe pesë sërëbëve të cilët jetonin në shtëpitë përreth.⁸⁴ Gati menjëherë pas largimit të KFOR-it italian protestuesit shqiptarë u kthyen dhe i vënë zjarrin kishës. Gjatë ditëve të ardhshme shtëpitë e sërëbëve vazhdimisht ishin plackitur. Kur dy javë më vonë Stefan Tisma u kthye që të kontrolloj shtëpinë e saj, ajo pa se shtëpia ishte plackitur, të gjitha kabllot e rrymës ishin këputur dhe se plackitësit kishin lëshuar ujin dhe kishin vërshuar shtëpinë.⁸⁵

Lipjan

Me 17 mars, rreth orës 16:00 apo 17:00 filluan protestat në Lipjan, kur një turmë e madhe e shqiptarëve u mblodh në qendër të qytetit, afër shkollës së mesme. Së pari turma tentoi të hyjë në fshatin sërëb të Suvi Dollit, por u penguan nga KFOR-i, të cilët pastaj e kthyen vëmendjen e tyre në lagjet sërëbe të Lipjanit.

Shumica e sërëbve në rrethinën e Lipjanit jetojnë në nëntë fshatra ekskluzivisht sërëbe, mirpo vetë qyteti ka dy lagje sërëbe, njëra është lagja e Kisës e cila gjendet rreth kishës ortodokse sërëbe e cila është ekskluzivisht e banuar nga sërëbët, kurse lagja tjetër quhet Bestin dhe është e banuar me popullatë të përzier sërëbo-shqiptare. Sikur se Prishtina dhe Obilici, edhe Lipjani kishte apartamentet e YU Programit, ndërtesë kjo e cila gjendej në lagjen Bestin, dhe e cila ishte ndërtuar gjatë viteve të 90-ta për refugjatët sërëbë nga

⁸¹ ICG, Rrëmuja në Kosovë. f.46.

⁸² Intervista e HRW me Zivka Savic, Prill 17, 2004 ,Gracanicë

⁸³ ICG, Rrëmuja në Kosovë, f,49

⁸⁴ Intervistë e HRW me Stefan Tisma, Prill 10, 2004 Gracanicë.

⁸⁵ Ibid

Bosnia dhe Kroacia, e cila tani ishte banuar nga sërbët e zhvendosur prej anëve tjera të Kosovës.

Edhe pse trupat finlandeze të KFOR-it dhe pjestarët e SHPK-së ishin prezentë në lagjën Kisa, me 17 mars turma shqiptare filloi të sulmoj kishën ortodokse dhe shtëpitë e sërbeve duke i gjuajtur me gurë. Pjestarët e SHPK-së qëndruan pasivë derisa eksploduan dy granata, njëra në oborin e kishës dhe tjetra në oborin e shtëpisë fqinje. Gati menjëherë pjestarët e SHPK-së arrestuan priftin ortodoks dhe fqinun e tij, duke i akuzuar ata për gjuajtjen e granatave, edhe pse që të dy ishin të përgjakur nga eksplozimi i granatës dhe i kishin treguar policisë se granatat ishin gjuajtur nga turma shqiptare.⁸⁶ Sidoqoftë KFOR-i finlandez arriti të kthej kontrollin mbi lagjën Kisa dhe të parandaloj djegien e tërsishme të shtëpive.

Dhuna më e keqe ndodhi në lagjën sërbo-shqiptare të qytetit në Bestin. Shtatëdhjetë vjeçari sërb Joka Vesic, i cili jetonte në katin e katërt të apartamenteve të YU Programit, prej ku mund të shihte qartë se si po vepron turma:

Tre pjestarë të SHPK-së të cilët mbanin duart e tyre prapa shpinës, po ecnin pas turmës. Pjestarët e SHPK-së nuk morën pjesë aktive, por as nuk u munduan ta parandalojnë turmën. Aty nuk kishte kurrfarë prezence të KFOR-it apo UNMIK-ut. Turma kaloi përmes rrugës kryesore të qytetit dhe vazhdoi drejt apartamenteve tona dhe shtëpive tjera sërbe. Ata menjëherë filluan të vënë zjarrin shtëpive sërbe, përderisa shtëpitë shqiptare ishin shënuar me ngjyrë të kuqe “UCK”. Unë shumë qartë pashë ata duke e ndezur një shishe (bombë gasoline), pastaj ata thyen xhamin dhe e gjuajtën brenda.⁸⁷

Protestuesit vranë sërbin 54 vjeçar Nenad Vesic, i cili me familjen e tij po mendohej të ikte prej shtëpisë. Sipas kushëririt të Joka Vesic i cili po shikonte prej katit të katërt, Nenad Vesic ishte vrarë duke dalë prej shtëpisë së tij, në prani të motrës dhe nënës së tij.⁸⁸ Në kohën kur ndodhi ngjarja, sipas Joka Vesicit pjestarët e SHPK-së ishin afër mirpo nuk arrestuan asnjë person të dyshuar.

Pas sulmeve ndaj shtëpive sërbe në Bestin, turma shqiptare filloi të sulmojë apartamentet e YU Programit. Të paaftë që të hyjnë brenda për shkak të dyerve të hekurta, turma

⁸⁶ Intervista e HRW me vëllan Randal Denic, Prill 17, 2004 Lipjan.

⁸⁷ Intervista e HRW me Joka Vesic, Prill 10, 2004, Gracanice

⁸⁸ Ibid.

shqiptare shkoi ne ndërtesën e cila gjendet përbri dhe e cila është e banuar nga shqiptarët, dhe arritën të hyjnë brenda ndërtesës së YU Programit përmes kulmit. Në atë moment trupat e KFOR-it arritën të evakujnë sërbbët e ngujuar brenda ndërtesës, dhe ti dërgojnë ata në lagjen e siguruar të Kisës.⁸⁹ Trupat finlandeze të KFOR-it poashtu arritën ti evakujnë banorët sërbbë prej lagjës Bestin, duke i dërguar ata në oborrin e kishës Kisa.⁹⁰

Ditën e nesërme shqiptarët vazhduan tu vënë zjarrin edhe shtëpive të mbetura në lagjen Bestin, sipas disa raporteve, të papenguar nga KFOR-i, UNMIK-u dhe SHPK-ja. Si rezultat i gjithë kësaj 28 shtëpi dogjën në Lipjan.⁹¹

Frashër

Fshati Frashër, ishte njëri prej vendeve të prekura më së shumti nga dhuna e marsit. Frashëri është fshat etik sërbb i cili gjendet në jug të Mitrovicës. Sipas të dhënave të zyrtarëve të ushtrisë franceze, në Frashër ishin shkatruar 137 shtëpi të sërbbëve nga ana e protestuesve shqiptarë. Shkatërimi i fshatit Frashër është mjaft shokues, duke marrë parasysh faktin se baza kryesore logjistike e KFOR-it francez, Kampi Belvedere gjendet vetëm 500 metra larg fshatit. KFOR-i francez dështoi të mbrojë fshatin Frashër, edhe pse turma shqiptare kaloi mu para bazës në rrugë për në fshat, para se t'ia vëjë zjarrin secilës shtëpi sërbbë.

Dhuna në Frashër filloi me 18 mars rreth orës 15:00, kur disa qindra shqiptarë pasi që të kenë vënë zjarrin kishës ortodokse në jug të Mitrovicës, vazhduan rrugën drejt fshatit. Bujku 48 vjecar Milos Antic, kishte parë turmën shqiptare duke iu afruar fshatit: “Ne pamë një turmë të madhe njerzish të cilit po [vinin rrugës] kryesore, e cila kalon para bazës kryesore të KFOR-it francez. Unë nuk jam i sigurtë se qka po bënin ushtarët, mirpo turma shqiptare kaloi mu para bazës.”⁹²

Në kohën kur turma shqiptare arriti në fshatin Frashër, aty ishin prezente vetëm dy automjete të KFOR-it me përfaqësues të 15 ushtarë marokienë. Trupat e KFOR-it kishin marrë urdhër të ndalojnë turmën shqiptare, kështu që ata u pozicionuan në hyrje të fshatit. Para se të arrijë turma shqiptare në fshat, si përforsim trupave marokiene të KFOR-it erdhën edhe disa automjete të policisë së UNMIK-ut në mënyrë që të

⁸⁹ Ibid.

⁹⁰ Intervista e HRW me Aleksandar Vasic Prill 17, 2004.

⁹¹ Intervista e HRW me vëlla Randal Denic, Prill 17, 2004, Lipjan.

⁹² Intervista e HRW me Milosh Antic, Prill 8, 2004, Mitrovicë.

parandalojnë turmën.⁹³ Përkundër përforcimeve të KFOR-it dhe UNMIK-ut në rrugën kryesore, turma e protestuesve i anashkaloi ata dhe filloi të vëjë zjarrin shtëpive serbe: “Turma shqiptare nuk mundi ta shfrytëzoi rrugën kryesore, kështu që ata kaluan në rrugët anore dhe filluan të vënë zjarrin me kokteje molotov [bomba gasoline]. Unë i pashë ata se si i ndiznin koktejtë dhe i gjuanin në shtëpitë serbe.”⁹⁴

Në këtë shkallë të sulmit mbi fshatin Frashër, numri i protestuesve ishte ende relativisht i vogël, diku rreth 400 apo 500 protestues. Në ndihmë trupave të rrethuar të KFOR-it dhe UNMIK-ut, arritën trupat polake të KFOR-it, të cilat përkohsisht arritën të shpërndajnë turmën e protestuesve dhe të shuajnë zjarrin e disa shtëpive.⁹⁵ Kurse trupat franceze të KFOR-it të cilat gjendeshin në bazën e afërt nuk asistuan në mbrojtje të fshatit.

Pasi që u shpërnda turma shqiptare, banorëve serbë të fshatit Frashër u ishte thënë se duhet të evakoheshin menjëherë nga ana e UNMIK-ut polak dhe amerikan. Komandanti i njësisë speciale të UNMIK-ut polak u tha fshatarëve serbë, se ata kishin vetëm gjysëm ore që të evakonin banorët, sepse duhet të shkonin në vende tjera që ti përgjigjeshin dhunës.⁹⁶ Sipas Dragan Bjelicës, i cili ishte pjesëmarrës në këtë mbledhje, fshatarët serbë kërkuan që të takoheshin me komandantët e e bazës së afërt franceze që ti lusnin ata për mbrojtje. Ata në bazë u takuan me një kolonel belg të KFOR-it, i cili vetëm ngriti supet me të treguar se shtëpitë e tyre po digjeshin dhe se u neveitej mbrojtjeje. Koloneli belg më pastaj sygjeroi se mund të dërgonte 50 trupa në fshat, mirpo insistoi se trupat e tij duhet të rrijnë së bashku në qendër të fshatit, e jo të shpërndahen të mbrojnë shtëpitë serbe.⁹⁷

Përderisa fshatarët serbë u kthyen në fshat, të pa aftë të sigurojnë ndihmën e KFOR-it që u neveitej për të mbrojtur shtëpitë e tyre, gratë dhe fëmijët tashmë ishin evakuar. Në mbrëmje trupat marokene të KFOR-it insistuan që edhe meshkujt të largoheshin prej fshatit, dhe i evakuan ata në bazën e afërt të KFOR-it francez. Gati të gjithë serbët e fshatit u larguan prej shtëpive të tyre duke mos pasur kohë të marrin asnjë nga posedimet e tyre.

Kur serbët e fundit u larguan prej fshatit me datën 18 mars, shumica e shtëpive të tyre ishin ende të paprekura. Gjatë natës dhe ditës së ardhshme, turma shqiptare u lejua pa asnjë pengesë nga baza e afërt e KFOR-it të plaqkiste shtëpitë dhe më pastaj tu vënte

⁹³ Ibid.

⁹⁴ Ibid

⁹⁵ Ibid

⁹⁶ Intervista e HRW me Dragan Bjelica, Prill 9, 2004 Mitrovicë

⁹⁷ Ibid

zjarrin. Si përfundim i kësaj, cdo shtëpi serbe në fshatin Frashër ishte plackitur dhe djegur, dhe të gjitha kafshët e tyre ishin vrrarë. Ky është përshkrimi i një fshatari serb, se si bashkësia ndërkombetare dështoi ti mbrojë ata në kohën kur nevoiteshin më së shumti:

Gjatë pesë viteve të fundit aq shumë ndërkombëtarë studiuan problemet tona sa që nuk mundem as ti numeroj dhe prodhuan rekomandime dhe raporte të panumërta. Në fund si rezultat i gjithë këtyre unë humba cdo gjë që ndërtova për dyzet vitet e fundit, gjersa bashkësia ndërkombëtare shikonte prej largësisë së disa qindra metrave. Tani më thonë të kthehem dhe ta rindertoj jetën time-si mund t'iu besoj?⁹⁸

Sllatinë

Në shumë zona të Kosovës, turma shqiptare sulmoi banorët serbë me orë të tëra, para se tu vinin në ndihmë trupat ndërkombëtare të KFOR-it ose UNMIK-ut. Shembull i tillë është Sllatina, i cili është fshat i vogël që gjendet në juglindje të Mitrovicës me vetëm trembëdhjetë serbë.

Banori 69-të vjeçar i Sllatinës, përshkruan se si në mëngjesin e 18 marsit, një grup i vogël i shqiptarëve, shumicën prej të cilëve i njihje si banorë të fshatit, filluan të mblidhen rreth shtëpive serbe. Së shpejti, një grup prej shtatë të rinjëve shqiptarë-disa prej tyre fëmijë të ish pjestarëve të UCK-së- filluan të gjuajnë me gurë shtëpitë serbe, të cilat ishin kryesisht të banuara me njerëz të vjetër. Një djalë i një ish komandanti të UCK-së erdhi tek shtëpia e Vladimir Savicit dhe i tha:” Shko në Sërb! Kosova është e imja! Ne nuk mund të jetojmë së bashku!” Savic u mundua që të gjejë mirkuptim, duke i spjeguar atij se edhe ai kishte lindur këtu në fshat, mirpo ai ishte urdhëruar që të hynte brenda shtëpisë. Shtëpitë u sulmuan ashpër rreth orës 14:30 dhe disa nga serbët e moshuar ishin rrahur nga turma. Tetëdhjetë vjeçari Govoljub Savic humbi një sy si pasojë e gjuajtjes me gurë, kurse një i moshuar tjetër ishte goditur me kaci në kokë, me c’rast kishte pësuar lëndime të rënda.⁹⁹

KFOR-i dështoi tu vijë në ndihmë serbëve të rrethuar në Sllatinë. Një konvoj prej katër automjeteve të KFOR-it francez kaloi përmes fshatit, në kohën kur sulmet kishin filluar, me c’rast serbët u munduan ta ndalin. Automjeti i fundit e ngadalsoi shpejtësinë, duke iu thënë fshatarëve se nuk mund të ndalen sepse janë në rrugë për të shkuar tek një “trazirë

⁹⁸ Intervista e HRW me Milosh Antic, Prill 8 2004 Mitrovicë

⁹⁹ Intervista e HRW me Vladimir Savic, Prill 9, 2004, Zvecan.

më e madhe.”¹⁰⁰ Diku rreth orës 17:00 sërëbët arritën të kontaktojnë me policinë e UNMIK-ut me ç’rast ata dërguan tri automjete.

Arritja e policisë së UNMIK-ut në fshat kishte efekt dramatik në sjelljen e turmës shqiptare: “Shqiptarët menjëherë ndalën djegjen e shtëpive”.¹⁰¹ Pas evakuimit të sërëbëve të plagosur policia e UNMIK-ut tha se do të kalojnë natën në fshat, të cilëve më vonë u bashkangjiti edhe KFOR-i. Përderisa KFOR-i dhe UNMIK-u ishin në fshat nuk pati sulme të mëtutjeshme në Sllatinë.

Të nesërmën në mëngjes rreth orës 10:00, u ishte thënë se duhet të evakohen prej shtëpive të tyre. Nëntë sërëbët e mbetur u transportuan me një automjet të vetëm të UNMIK-ut, me ç’rast nuk u lejuan të marrin asnjë gjësend për shkak të mungesës së hapsirës në automjet. Zyrtarët e UNMIK-ut u thanë sërëbëve se ky evakuim është i përkohshëm dhe se trupat e KFOR-it do të përkujdesen për shtëpitë e tyre. Ky premtime u dëshmuat të jetë i zbrazët. Deri në kohën kur fshatarët u larguan prej shtëpive të tyre, vetëm tri shtëpive u ishte vënë zjarri, mirpo gjatë ditëve të ardhshme të gjitha shtëpitë sërëbe në fshat ishin plackitur dhe djegur deri në temel.

Vushtri

Viktima të dhunës së marsit nuk ishin vetëm sërëbët etnik. Në shumë zona të Kosovës, edhe minoritetet tjera joshqiptare si Romët, dhe Ashkalitë u ballafaquan me dhunën. Ndër sulmet më të ashpra ishte shkatërimi i të 69-të shtëpive të ashkalive së bashku me kishën ortodokse sërëbe në Vushtri. Qyteti i Vushtrisë gjendet në jug të Mitrovicës. Edhe pse Vushtria gjendet mes dy bazave të KFOR-it francez, asaj të –“Belvedere-s” dhe “Novo Selo”, as KFOR-i e as UNMIK-u nuk morën pjesë aktive në mbrojtjen e komunitetit të ashkalive në Vushtri. E vetmja forcë e sigurisë e cila luajti rol të rëndësishëm gjatë protestave në Vushtri ishte Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK). Përderisa disa prej pjestarëve të SHPK-së ndihmuan në evakuimin e ashkalive, tB tjerët duket se kanë marrë pjesë aktive gjatë dhunës, duke keqpërdorur dhe arrestuar ashkalitë të cilët u munduan të mbrojnë shtëpitë e tyre. Sipas disa ashkalive, disa pjestarë të SHPK-së morrën pjesë në vënjen e zjarrit shtëpive të ashkalive.

Para luftës së vitit 1999, në Vushtri jetuan diku rreth 350 familje të ashkalive, shumica prej të cilëve mereshin me zanatin e shiblerjes së mishit. Pas luftës shumica e ashkalive u sulmuan nga shqiptarët. Së paku pesë prej tyre janë kidnapuar dhe “zhdukur” dhe më

¹⁰⁰ Ibid

¹⁰¹ Ibid

shumë se 100 shtëpi u janë shkatëruar. Gati i tërë komuniteti ashkali u zhvendos, vetëm 10 apo 15 familje vendosën të mbesin në qytet. Sidocofte, gjatë vitit 2001 familjet e ashkalive filluan të kthehen në Vushtri, deri në mars të vitit 2004 diku rreth 70 familje ishin kthyer dhe jetonin prapë në Vushtri. Për shkak të rolit të tyre të rëndësishëm në shitblerjen e mishit, dhe poashtu antarëve të familjes të cilët punonin në Europën perendimore, shumica prej tyre kishin pasuri të madhe dhe ndërtuan shtëpi të mëdha, gjë që i vuri në shënjestër të kriminelëve.

Me datën 18 mars, diku rreth orës 16:00 filloi dhuna në Vushtri, kur një grup i përbërë prej ish luftëtarëve të UCK-së shkatëroi kishën ortodokse të Shën Eliasit, para se të takoheshin me grupin e dytë, sipas disa raporteve i udhëhequr nga liderët kriminelë shqiptarë, dhe të sulmomin komunitetin ashkali.¹⁰² Turma numronte diku rreth 400-500 persona, shumica e të cilëve ishin meshkuj dhe e cila rritej vazhdimisht. Gjatë sulmit mbi kishën ortodokse ishte evakuuar kontigjenti i KFOR-it marokien, duke lënë Vushtrinë pa prezencë të KFOR-it.

Turma shqiptare me të arritur në lagjen e ashkalive filloi tu vë zjarrin shtëpive:

Ata kishin cdo lloj arme- shufra druri, sopata, mjete të kopshtit, dhe shishe me benzin.Unë pashë kur u sulmua shtëpia e parë. Ata nxorën të gjithë njerëzit jashtë shtëpisë dhe pastaj ia vënë zjarrin. Menjëherë vazhduan tek shtëpia e dytë. Kjo shtëpi kishte mur të lartë dhe dyer të forta. Ata arritën të kapërcejnë murin dhe ti hapin dyert, kështu që turma hyri mbrenda. Antarët e kësaj shtëpie kishin hipur në katin e dytë dhe kishin mbyllur dyert. Turma menjëherë ia vu zjarrin automobilin, e pastaj edhe shtëpisë, përderisa familja ende gjendej brenda.¹⁰³

Shumë ashkali e përkujtuan tmerin që e ndien ata kur u ishte vënë zjarri shtëpive të tyre përderisa familjet e tyre edhe gjendeshin brenda dhe askush nuk erdhi tu dalë në ndihmë. Mishitësi tridhjetë e shtatë vjecar Nejib Cizmollli, ishte mbyllur në katin e dytë të shtëpisë së tij, përderisa ajo po digjej, së bashku me njëmbëdhjetë antarë të tjerë, duke përfshirë edhe fëmijë të moshave tre, tetë, katëmbëdhjetë, pesëmbëdhjetë, dhe gjashtëmbëdhjetë.¹⁰⁴

¹⁰² ICG, Rrëmuja në Kosovë, f.51

¹⁰³ Intervista e HRW me Xhemal Kelmendin Prill 14,2004, Novo Sellë

¹⁰⁴ Intervista e HRW me Nejib Cizmollli, Prill 14, 2004, Novo Sellë.

Të gjithë ashkalitë bënë thirje të njëpasnjëshme KFOR-it, UNMIK-ut dhe policisë vendore të SHPK-së duke kërkuar ndihmë prej tyre. Dyzet e shtatë vjecari Njazi Pllavci, baba i katër fëmijëve, u kthye nga Sërbia në Vushtri në nëntor të vitit 2003, tani kur përkujton mungesën e prezencës së KFOR-it dhe UNMIK-ut fillon të qan:

“Ne kemi bërë së paku njëzet thirje stacionit policor të [SHPK-së], duke lutur ata që sa më shpejtë të na ofrojnë ndihmë. Ne kërkonim UNMIK-un dhe KFOR-in, por pjestarët e SHPK-së na thonin se ata kanë shkuar...Po të kish pasur prezencë të trupave të KFOR-it apo tanqe, ajo që ka ndodhur nuk do të kishte ndodhur.”¹⁰⁵ Përfaqesuesi i ashkalive, Abdush Cizmollu ishte poashtu mjaft i prerë në mendimin e tij për KFOR-in dhe UNMIK-un: “Askush nuk ka më shumë faj se KFOR-i dhe UNMIK-u. Po të kishin dashur, do të na kishin shpëtuar me një tenk të vetëm- e nuk do të ndodhnin këto probleme.”¹⁰⁶

Në bisedat private me Human Rights Watch, trupat e KFOR-it francez shpjeguan se vendimi që të mos pozicionohen në Vushtri ishte marrë në bazë të faktit se komuniteti ashkali ishte “ushtarakisht i pa mbrojtshëm” dhe se shumica e KFOR-it francez tashmë ishte pozicionuar në mbrojtje të veriut të Mitrovicës. Pikpamja se Vushtria ishte “ushtarakisht e pambrojtshme” indikon një problem të zakonshëm me KFOR-in, i cili u ndriqua gjatë hulumtimit të Human Rights Watch në Kosovë. Kontigjentet e KFOR-it zakonisht e shohin angazhimin e tyre në mënyre tradicionale ushtarake, e jo në mënyrë më të përshtatshme policore. Në rastin e Vushtrisë është pak e besueshme se KFOR-i do të duhej të angazhohej ushtarakisht ndaj turmës shqiptare duke hapur zjarr apo në ndonjë mënyrë tjetër; taktikat për kontrollin e dhunës, të përdorura shpesh nga ana e policisë civile, në këtë rast do të kishin pasur rëndësi të madhe. Nga perspektiva e kontrollimit të turmës, komuniteti ashkali në Vushtri do të mund të mbrohej lehtë, sepse shtëpitë e ashkalive ishin afër njëra tjetrës me vetëm disa pika të daljes.

Dështimi i KFOR-it dhe UNMIK-ut ti dalë në ndihmë komunitetit ashkali në Vushtri, la situatën e sigurisë tërësisht në duart e SHPK-së. Ashkalitë të cilët u intervistuan nga Human Rights Watch, vazhdimisht pohuan se, Shërbimi Policor i Kosovës refuzonte ti përgjigjej dhunës, derisa disa ashkali filluan të shtënin në ajër, në mënyrë që të mbronin shtëpitë e tyre. Ashkalitë u dyshuan se të kenë shtirë në turmën e protestuesve. Xhemal Kelmendi, jetonte në shtëpinë fqinje dhe ishte njëri prej personave të keqtrajtuar dhe arrestuar:

¹⁰⁵ Intervista e HRW me Njazi Pllavci, Prill 16 2004 Novo Sellë.

¹⁰⁶ Intervista e HRW me Abdush Cizmollu me Prill 16 2004, Novo Sellë.

Unë isha vetëm në kopsht, përderisa familja ime ishte brenda në shtëpi. Pastaj dëgjova një zhurmë të madhe se si po mundoheshin ta hapnin derën. Unë isha shumë i lumtur kur pashë se ishte SHPK-ja mirpo shumë shpejt u zhgënjeva. Mendova se me ardhjen e policisë cdo gjë do të mer fund. Mirpo policia më urdhëroi që ti ngrisja duart lart dhe të shtrihesha përtokë. Ata mi lidhën duart dhe përderisa gjendesha I shtrirë përtokë, më qëlluan disa herë me shkelma. Pastaj më tërhoqën dhe kërkuan që ti dorzoja armët. Unë u thashë se nuk kisha armë. Njëri prej policëve filloi të shajë nënën time, duke thënë: “Qifsha nanën e magjupit”, dhe prapë më qëlloi...Ata vazhduan të më qëllonin dhe të kërkonin armë. Unë vazhdimisht u thoja se nuk kam. Pastaj më dërguan tek një veturë e policisë, dhe vazhduan të më qëllonin me grushta dhe qizme...Me të më larguar policia nga shtëpia ime, turma filloi të aplaudojë.¹⁰⁷

Ashkalitë tjerë që u arrestuan atë natë, u ballafaquan me rrahje dhe keqtrajtim të ngjajshëm. Në krahasim me ashkalitë të cilët u dërguan në stacionin policor të SHPK-së, atë ditë asnjë shqiptarë nuk ishte arrestuar nga ana e SHPK-së, përkundër faktit se shqiptarët ishin ata që sulmonin dhe u vënin zjarrin shtëpive të ashkalive. Duket se në disa raste disa pjestarë të SHPK-së morrën pjesë aktive me turmën shqiptare. Përderisa po e dërgonin Xhemal Kelmandin në veturën e policisë turma tentoi ta sulmonte atë. Pjestarët e SHPK-së i urdhëruan ata që të ndaleshin duke e thënë “Ne e patëm një marrëveshje,” dhe turma u largua.¹⁰⁸ Një ashkali tjetër tregon se si, turma filloi të gjuante me gurë automjetin e SHPK-së, derisa po e evakuonin atë, me c’rast polici e ndoloi automjetin duke i thënë turmës” Ju e dini se nuk duhet ta gjuani policinë me gurë”, dhe turma u ndal- një vërejtje shumë bizare përderisa turma po i vënte zjarrin shtëpive.¹⁰⁹ Një grua, shtëpia e të cilës ishte përbri me atë të përfaqësuesit të ashkalive Abdush Cizmollit, i tha Human Rights Watch se si personalisht kishte dëgjuar policinë duke i thënë turmës “Tani të gjithë janë jashtë, vënjani zjarrin”.¹¹⁰

Së shpejti, pas arrestimit të ashkalive të cilët kinse kishin shtirë mbi turmën shqiptare, SHPK-ja u kthye që të bënte evakuimin e familjeve të mbetura. Me arritjen e SHPK-së turma shqiptare ndaloi djegjen e shtëpive dhe u tërhoq, duke lejuar SHPK-në të rrethojnë lagjen kryesore të ashkalive. SHPK-ja urdhëroi ashkalitë prej shtëpisë në shtëpi që të evakuohen menjëherë duke u thënë se nuk mund të garantojnë për sigurinë e tyre.”

¹⁰⁷ Intervista e HRW me Xhemal Kelmendi, Prill 14, 2004, Novo Sellë.

¹⁰⁸ Ibid.

¹⁰⁹ Intervista e HRW me Fedaim Kelmendi, Prill 16, 2004, Novo Sellë.

¹¹⁰ Intervista e HRW me Zaida Cizmollit, Prill 16, 2004, Novo Sellë.

Ne nuk mund të garantojmë për jetrat e juaja nëse nuk vini me ne”. Evakuimi ndodhi aq shpejtë, sa që nuk patën kohë të marrin as gjërat personale. Posa u bë evakuimi i ashkalive, tërë lagjës ishte vënë zjarri. Tridhjet e shtatë vjecarja Feride Myftari thotë: “Unë ende nuk isha larguar prej lagjës sonë, kur e pashë se si po I dilte flaka shtëpisë sime. U largova prej shtëpisë sime duarthatë.”¹¹¹

Ashkalitë të cilët u evakuan, së pari u dërguan në institutin për trajnimin e policisë së SHPK-së, e pastaj në stacionin kryesor të SHPK-së. Në stacionin kryesor të SHPK-së, shumë ashkali u habitën kur panë diku rreth 100 pjestarë të SHPK-së, shumica prej të cilëve nuk ishin përgjegjur thirjeve për ndihmë nga komuniteti ashkali.

Kontribut drejt këtij shkatërimi masiv ishte edhe dështimi i KFOR-it dhe UNMIK-ut që ti përgjegjen kërkesës për ndihmë. Përgjegjja e një numri të vogël të pjestarëve të SHPK-së pati rol të rëndësishëm në shtyerjen prapa të turmës shqiptare, duke i dhënë kredibilitet mendimit të ashkalive se, një prezencë e fortë e KFOR-it dhe UNMIK-ut do të parandalonte shkatërimin e shtëpive të tyre. Përgjegjja e SHPK-së në Vushtri ishte thellësisht problematike, në vend se të përmbushin obligimet e tyre që të mbrojnë të gjithë banorët në baza jodiskriminuese, ata u fokusuan në denimin e ashkalive për shkak të tentimit të mbrojtjes së shtëpive të tyre. Tregimet se disa pjestarë të SHPK-së morrën pjesë aktive në dhunën e marsit meriton hulumtime të mëtutjeshme.

Fushë Kosovë

Fushë Kosova gjendet diku rreth tetë kilometra në jugperëndim të Prishtinës, popullata e të cilës para konfliktit të vitit 1999 ishte përbërë nga 25% serb, popullatë kjo numri i së cilës ra në mënyrë drastike pas luftës. Shumica e popullatës serbe u larguan prej Fushë Kosovës dhe fshatrave përreth si Uglare, Kuzmin, dhe Batuse, mirpo diku rreth 100 shtëpi vazhduan të jenë të banuara nga serbët. Për dallim prej qyteteve të tjera të Kosovës, ku serbët jetonin në lagje të lidhura ngusht njera me tjetrën, në Fushë Kosovë ishin të shpërndarë dhe jetonin pranë fqinjëve të tyre shqiptarë.

Fushë Kosova zë një vend i rëndësishëm në historinë serbe, ky ishte vendi i betejës historike të vitit 1389, mes serbëve dhe forcave otomane. Me 24 prill 1987, Slobodan Millosheviçi filloi karrierën e tij nacionaliste me një fjalim të zjarrtë të cilin e mbajti në Fushë Kosovë.¹¹² Edhe pse popullata serbe e Fushë Kosovës kishte ndryshuar, ajo vazhdoi që të jetë qendër e rëndësishme administrative për Beogradin: ishte njëra prej vendeve të rralla ku banorët kosovar mund të vazhdonin pasaportat jugosllave.

¹¹¹ Intervista e HRW me Ferida Myftari, Prill 16, 2004, Novo Sellë.

¹¹² Laura Silber dhe Alan Little, *Yugoslavia: Death of a Nation* (New York: Penguin Books, 1997) f.37-39.

Dhuna në Fushë Kosovë filloi në pasditën e hershme të 17 marsit. Sipas disa burimeve, ekstremistët shqiptarë filluan të vinin në Fushë Kosovë prej rajonit të afërt të Drenicës, i cili vendlindja dhe qendra e UCK-së dhe nacionalizmit shqiptarë në përgjithsi.¹¹³ Turma rritej shumë shpejt, dhe përfshinte edhe banorët shqiptarë të Fushë Kosovës, posaërisht ata të moshave mes 14-20 vjecar. Shumica e sërbeve të intrvistuar nga Human Rights Watch thanë se disa nga sulmuesit i njohën si fqinjë të tyre.

Turma e cila rritej në mënyrë shumë të shpejtë, dhe e cila deri në pasditën e hershme numronte mijëra persona, ishte mbledhur para spitalit sërb dhe afër shkollës Shën Sava, duke i vënë zjarrin dhe shkatëruar tërsisht strukturën.¹¹⁴ Pastaj ata u shpërndanë nëpër lagjet e afërta, duke u vënë zjarrin shtëpive sërbe.

Asnjë prej personave të intervistuar nga HRW, sërb apo pjestarë shqiptarë të SHPK-së, nuk kishin parë kurfarë prezence të trupave të KFOR-it gjatë dhunës në Fushë Kosovë, trupat e KFOR-it ose ishin pozicionuar diku tjetër ose thjesht dështuan të përgjigjen. Shumica e pjestarëve të UNMIK-ut tashmë ishin pozicionuar në Cagllavicë.¹¹⁵ Në të vërtetë, mbrojtja e Fushë Kosovës, e cila kishte diku rreth 100 shtëpi sërbe të shpërndara rreth qytetit, ishte lënë në duart e disa dhjetra pjestarëve të SHPK-së, të asistuar nga një numër i vogël i policëve të UNMIK-ut.¹¹⁶ Shërbimit Policor të Kosovës i mungonin, gasi lotsjellës, plumba gome, mburojat, dhe shumë gjëra tjera elementare të cilat do tu ndihmonin që të merreshin me dhunën në mënyrë më efektive.¹¹⁷ Mungesa e prezencës së KFOR-it dhe mungesa e një prezence të mjaftueshme të UNMIK-ut la SHPK-në me mundësi shumë të kufizuara.

Performanca e SHPK-së dallonte shumë në Fushë Kosovë. Një numër i vogël i pjestarëve të SHPK-së vepruan në mënyrë profesionale dhe me guxim, duke u munduar të ndalin turmën e cila sulmonte shtëpitë sërbe, dhe duke i evakuuar ata kur situata e sigurisë vazhdoi të keqsohet. Disa prej tyre vepruan në mënyrë të palodhshme që të evakujnë dhe mbrojnë banorët sërbe. Mirpo disa policë të tjerë të SHPK-së qëndruan në mënyrë pasive dhe refuzuan që të intervenojnë gjatë dhunës. Në disa raste policët e SHPK-së janë akuzuar se kanë marrë pjesë aktive në dhunë.

¹¹³ Intervista e HRW me Dusan Arsic, Prill 10, 2004, Gracanicë.

¹¹⁴ Intervista e HRW me Dejan Jovanovic, Prill 16, 2004, Fushë Kosovë.

¹¹⁵ Në Fushë Kosovë ka vetëm 55 policë vendor duke përfshirë edhe sërbe. Mirpo vetëm disa u raportuan për detyrë. Të tjerët ishin në trajnim apo thjesht nuk u lajmëruan.

¹¹⁶ Intervista e HRW me zyrtarë të SHPK-së, Prill 16, 2004, Fushë Kosovë.

¹¹⁷ Intervista e HRW me zyrtarë të SHPK-së, Prill 16, 2004, Fushë Kosovë.

Edhe ata pjestarë të cilët u munduan të vepronë në mënyrë profesionale, ishin të pakët, kështu që nuk patën ndikim të madhë në turmën. Tridhjet e dy vjecari Dejan Jovanovic, i cili punonte në një radio stacion multi-etnik, përshkruan se si turma shqiptare e cila përafërsisht numronte 5,000 deri në 6,000 persona, ia vu zjarrin shkollës Shën Sava dhe klinikës së afërt. Turma filloi të plackiste dhe ti vinte zjarrin shtëpive serbe. Fillimisht erdhën tri automjete të përbëra nga policia e UNMIK-ut dhe SHPK-së të cilët u munduan që të merren vesh me turmën. Turma u përgjegj duke sulmuar automjetet e policisë, dhe vazhdoi të plackiste dhe tu vinte zjarrin shtëpive. Jovanovic dhe gjyshja e tij së shpejti u ballafaquan me një grup protestuesish i cili përafërsisht numronte 50 deri 70 persona, të cilët u vënë zjarrin shtëpisë së tyre:

Me të hyrë në kopsht, ata së pari thyen të gjitha dritaret në shtëpinë e parë dhe ia vënë zjarrin. Pastaj erdhën tek shtëpia e dytë ku ishim edhe ne. Ata më panë mua dhe gjyshen time dhe vrapuan drejt nesh me shkopinjin druri dhe thika. Filluan të na thërisnin që të dilnim jashtë, mirpo unë e bllokova dërrën me një stufë. Ata hynë në shtëpi, mirpo unë i ndalova ata që të hyjnë në dhomë. Unë pash fytyrat e tyre prej dritares shumë prej tyre i njihja si fqinjë nga blloku i banesave që gjendeshin prapa shtëpisë.¹¹⁸

Dy pjestarë të SHPK-së arritën në momentin kur protestuesit po e ndiznin njëren shtëpi. Pjestarët e SHPK-së u munduan që ti ndalonin ata, “por pa sukses”, shpjegon Jovanovic “policët mundoheshin të nxirnin disa prej tyre jashtë, në të njëjtën kohe të tjerët hynin brenda”. Më në fund protestuesit vazhduan tek shtëpitë tjera, dhe pjestarët e SHPK-së më ndihmuan ta fiki zjarrin. Përderisa Jovanovic dhe policët e SHPK-së mundoheshin ta fiknin zjarrin, një numër i protestuesve u kthye dhe filluan ta rrahin atë, protestuesit thjesht vrapuan rreth policëve, edhe pse ata u kërcnoheshin me armë zjarri. Jovanovic po se si protestuesit tjerë po afroheshin me shufra dhe armë të tjera, kështu që u detyrua të ikte brenda në shtëpi së bashku me gjyshen etij. Pjestarët e SHPK-së me në fund arritën që të evakujnë Jovanovicin dhe gjyshen etij, duke lënë pas shtëpinë e cila po digej.¹¹⁹

Dyzet e shtatë vjecarja Nevena Rikalo, punëtore në komunën multi-etnike të Fushë Kosovës, përshkruan një ngjarje të ngjajshme ku SHPK-ja ishte kapluar nga turma. Me datën 17 mars rreth orës 16:30, një grup prej 10 të rinjëve të moshës katërmbëdhjetë deri shtatëmbëdhjetë vjecar, sulmuan shtëpinë e saj dhe filluan të rrahin nënën e saj shtatëdhjetë vjecare me shufra druri. Dy pjestarë të SHPK-së arritën dhe i ndoqën të rinjët shqiptarë, dhe arritën të arestojnë dy prej tyre. Mirpo pas arrestimit të dy të rinjëve,

¹¹⁸ Intervista e HRW me Dejan Jovanovic, Prill 16, 2004, Fushë Kosovë.

¹¹⁹ Ibid.

automjeti I SHPK-së u sulmua nga protestuesit dhe ata u detyruan ti lëshojnë personat e arrestuar. Në ndërkohe protestuesit tjerë kishin kaluar rrethojën e shtëpisë, dhe kishin filluar ti vënë zjarrin shtëpisë nga kulmi. Pjestarët e SHPK-së I thanë familjes se I kishin vetëm pesë minuta që ti evakuonin ata, familja u detyrua që të largohet vetëm me teshat që I kishin në trup dhe asgjë tjetër. Pasi që arritën në stacionin e policisë Nevenka ndihmoi pjestarët e SHPK-së përgjatë tërë natës, duke biseduar me sërbbët të cilët ishin nën sulm dhe duke ndihmuar SHPK-së për ti gjetur shtëpitë e tyre. Ajo gjatë kësaj kohe pa vetëm tre pjestarë të policisë së UNMIK-ut, dhe spjegoi se gati të gjitha evakuimet u kryen nga ana e një numri të vogël të SHPK-së.¹²⁰

Në disa raste pjestarët e SHPK-së bënë shumë pak që të mbrojnë sërbbët të cilët ishin nën sulm. Pesëdhjetë e tre vjecari Zivorad Tonic, rreth orës 17:00 u largua nga stacioni I policisë, dhe shkoi që të kontrolloj shtëpinë e tij me c'rast u ballafacua me turmën e përafërsisht 200 shqiptarëve të armatosur të cilët e rrahën atë në mënyrë të ashpër me shufra metali dhe druri. Disa pjestarë të SHPK-së të cilët gjendeshin në automjetet e tyre vetëm disa metra larg nuk bënë asgjë që të parandalojnë rrahjen. Duke mos pasur asnjë mundësi tjetër, Tonic u dhesht të vrapojë prej turmës, dhe në mënyrë që të parandajoj rrahjet hyri në njërin e automjeteve të SHPK-së, pa asnjë ndihmë prej tyre. Kur më në fund pjestarët e SHPK-së vendosën të largoheshin prej vendit të ngjarjes, Tonic ishte në gjendje aq të keqe sa që ata menduan se kishte vdekur.¹²¹ Në të njëjtën kohë në Fushë Kosovë u rrah deri në vdekje sërbi gjashtëdhjetë e dy vjecar Zlatibor Trajkovic. Tridhjetë e dy vjecarja Ruzica Stevanovic, nënë e tre fëmijëve e cila jetonte me vjehrrën e saj invalide pati një përvojë të ngajshme me pjestarët e SHPK-së, të cilët ishin prezentë në shtëpinë e saj përderisa po sulmohej.

Turma e shqiptarëve etnik ia vuri zjarrin shtëpisë, me c'rast ajo u detyrua ti shtyej dy fëmijët e saj nga dritarja e banjos në mënyrë që të iknin. Vjehrra e saj 69 vjecare ishte ngujuar brenda shtëpisë që po digjej. Përderisa shtëpia e saj dhe shtëpitë fqinje digjeshin, një grup I pjestarëve të SHPK-së arriti, me c'rast ata qëndruan pasivisht dhe refuzuan ti ndihmonin asaj:

Me të arritur veturat e SHPK-së, turma u ndal së shkatëruari dhe filloi të shpërndahej. Pjestarët e SHPK-së hyrën brenda turmës duke u përshëndetur me ta dhe duke I vënë duart mbi supet e tyre. Për arsye se gjërat u qetsuan pak, ne mblodhëm forcën dhe dolëm të shohim se cka kishte ndodhur me vjehrrën time. Ne thyem njërin prej dritareve dhe pamë se brenda dhoma ishte mbushur plot tym dhe se dera po digjej. Ne

¹²⁰ Intervista e HRW me Nevenka Rikalo, Uglare, Prill 17, 2004.

¹²¹ Intervista e HRW me Zivorad Tonic, Prill 10, 2004.

disi arritëm ta nxjerim jashtë vjehrrën time-e cila ende ishte e vetëdijshme.

[Ne filluam ta fikim zjarrin] Në ndërkohë disa pjestarë të SHPK-së ishin ulur me disa civilë shqiptarë. Unë disa herë kërkova ndihmë prej tyre, mirpo ata refuzuan të përgjigjen thirjeve të mia për ndihmë. Ata as që hynë ndonjëherë në oborin tonë. Ata erdhën në pesë automjete, dy ose tre pjestarë në secilin automjet. Disa prej tyre mundoheshin të shpërndanin turmën, mirpo pesë apo gjashtë prej tyre, ishin ulur afër shtëpisë tonë, flisnin shqip dhe nuk na kushtonin fare vëmendjen.¹²²

Pasi Stevanovic fiku zjarrin në shtëpinë e saj (shtëpinë e vjehrës së saj tanimë tërsisht e kishte kapluar zjarri), dy pjestarë të SHPK-së u afruan dhe I thanë që tani është koha që të evakuoehen. Ajo u largua vetëm me një qantë me gjësende. Pasi që ajo u largua, shtëpisë së saj prapë iu vu zjarri, dhe u shkatërua tërsisht.

Në Fushë Kosovë është së paku një rast ku pjestarët e SHPK-së janë akuzuar për vënjen e zjarrit. Dushan Arsic ishte pronari i njëres prej shtëpive më të mëdha në Fushë Kosovë, disa dhoma prej të cilës kishte lëshuar me qera për disa pjestarë të policisë së UNMIK-ut. Rreth orës 17:45 kur shumicën e shtëpive në Fushë Kosovë tashmë kishte kapluar zjarri, dy pjestarë të SHPK-së arritën tek shtëpia e Dushan Arsicit dhe i thanë duhet ta evakuoenin atë menjëherë sepse një turmë e madhe e shqiptarëve po afrohej. SHPK-ja mori katër të afërm të Arsicit me vehte dhe thanë se do të ktheheshin për te dhe gruan e tij. Arsic dhe gruaja e tij hynë në automjetin e tyre dhe u nisën tek shtëpia e një të afërmi, kur panë se pjestarët e SHPK-së u kthyen tek shtëpia e tyre, duke menduar me siguri ti evakuoenin ata. Ata panë kur pjestarët e SHPK-së hynë brenda shtëpisë së tyre dhe filluan ti kërkonin ata, vetëm pesë minuta më vonë shtëpia kishte filluar të digjej. Përderisa pjestarët e SHPK-së ishin të vetmit persona brenda shtëpisë, Arsic është i bindur se ata i vënë zjarrin shtëpisë së tij.¹²³

Shkatërimi i komunitetit serb në Fushë Kosovë kishte përfunduar: cdo shtëpi dhe institucion serb në qytet dikur i njohur për gjallërinë e komunitetit serb, tani ishte shkatëruar. Sipas shënimeve të SHPK-së, mes ndërtesave të shkatëruara ishin, ndërtesa e postës kryesore- njëra prej të rrallave multietnike që funksiononin në Kosovë, e urrejtur nga shqiptarët meqë ishte njëri ndër vendet për ripërtirjen e pasaportave jugosllave, shkolla serbe Shën Sava, spitali serb dhe së paku 100 shtëpi serbe.

¹²² Intervista e HRW me Ruzica Stevanovic, Prill 10, 2004, Gracanice.

¹²³ Ibid.

Rrëmuja në Fushë Kosovë u qetsua së shpejti. Në mëngjesin e 18 marsit, në Fushë Kosovë arriti batalioni i parë i rojave Grenadiere njësi kjo me një përvojë të gjërë në kontrollimin e dhunës, të cilët ishin mobilizuar nga baza e tyre në Britani të Madhe, dhe të cilët po patrollonin rrugët e Fushë Kosovës në mbrëmjen e 18 marsit. Komandanti i njësisë major Caraw Hatherley, i spjegoi HRW se ishte i bindur se ushtarët etij do të kishin kontrolluar turmën po të kishin arritur me kohë. Problemi, spjegoi ai është se pak trupa të KFOR-it kanë eksperiencë në kontrollimin e dhunës dhe mjete adekuate: “Për një ushtarë të zakonshëm të KFOR-it nuk ka asgjë në mes të qëndruarit pa u ballafaquar dhe gjuajtjes me armë.”¹²⁴

Obiliq

Qyteti i Obiliqit gjendet disa kilometra në veri-perendim të Prishtinës, pas konfliktit të vitit 1999 këtu vazhduan të jetonin disa qindra sërbe dhe romë, edhe pse numri i popullatës rome dhe sërbe kishte rënë në mënyrë dramatike prej periudhës së pas luftës.¹²⁵ Sërbyt e mbetur jetonin në disa lagje rreth Obiliqit, përfshirë aty lagjen Todorovic, vendbanimin rruga Cerska, lagjen Rudnika Kolonija si dhe apartamentet e YU Programit të cilat strehonin sërbyt e zhvendosur nga fshatrat e tjera.

Me datën 17 mars, prej prës 13:00 e deri në orën 16:00 në qendër të Obiliqit ndodhi një demonstratë, në të cilën morren pjesë qindra shqiptarë, shumica prej të cilëve të moshës 10 e deri 18 vjeçar, të cilët brohoritnin parulla dhe gjuanin me gurë shtëpitë sërbe. Pjestarët e SHPK-së ishin prezentë gjatë demonstratës, mirpo ata nuk u përzien demonstruesve, por përkujdeseshin që protestuesit mos të dilnin jashtë rrugës kryesore. Protestuesit dëgjuan disa fjalime para ndërtesës së komunës, dhe pastaj gjuajtën me gurë një kontigjent të KFOR-it norvegjez i cili rastësisht po kalonte nëpër qytetin e Obiliqit në rrugë për në Prishtinë. Turma po ashtu gjuajti me gurë edhe apartamentet e YU Programit të cilat strehonin sërbyt e zhvendosur prej vendeve të tjera dhe gjendeshin përballe me ndërtesën e përbashkët të stacionit policor të UNMIK-ut dhe SHPK-së. Përsëri SHPK-ja nuk tentoi të shpërndaj turmen dhe ta ndal dhunën. Rreth orës 16:00 turma u shpërndaj duke shkaktuar dëme të vogla shtëpive sërbe.¹²⁶

¹²⁴ Intervista e HRW me Major Carew Hatherley, Prill 16, 2004, Fushë Kosovë

¹²⁵ Sipas shënimeve të UNHCR-së nga viti 1998, Obiliqi kishte popullatë prej 11,000 banorëve, prej të cilës 41 për qind ishin shqiptarë dhe 27 serb, të tjerat ishin minoritetet tjera.

<http://www.osce.org/kosovo/documents/reports/hr/part1/pocont.htm>

¹²⁶ Intervista e HRW me Olgica Subotic, Prill 17, 2004, Gracanice.

Mëngjesin e ardhshëm, me 18 mars sërë shikuan se si zakonisht, fëmijët shqiptarë vinin në shkollë rreth orës 8:00. Mirpo, më pak se një orë më vonë, të gjithë fëmijët u larguan prej shkollës së bashku me mësuesit e tyre, dhe filluan të sulmojnë dhe ti vënë zjarrin kishës ortodokse sërë. Olgica Subotic e cila jetonte në katin e pestë të apartamenteve të YU Programit prej të cilave shihet qartazi se cka ndodhi:

Fëmijët e shkollës morën pjesë së bashku me mësuesit e tyre. Unë i pashë fëmijët duke shkuar në shkollë, por pas gjysmë ore ata dolën jashtë së bashku me mësuesit e tyre. Unë i njoha mësuesit, po të më tregonit fotografi unë do të mund ti indentifikoja ata. Shtatë apo tetë mësues organizonin turmën.¹²⁷

Dëshmitari i dytë dha përshkrim të ngjajshëm: “Të gjithë fëmijët shqiptarë shikuan në shkollë rreth orës 8:00, rreth orës 8:15 minuta ata dolën jashtë së bashku me mësuesit e tyre, sikur po bënë ndonjë plan. Pastaj kjo turmë e njerëzve filloi ti vënte zjarrin kishës tonë, së bashku me mësuesit. Unë i njoh mësuesit dhe i pashë aty.”¹²⁸ Poashtu turmën e udhëhiqnin tre ish pjestarë të UCK-së.¹²⁹

Turma së pari u fokusua në djegjen e kishës, mirpo kishte vështirsi pasi që është e ndërtaur nga cimentoja. Turma pastaj dogji shtëpinë e kujdestarit të kishës dhe ndërtesën Qendrës Koordinuese për Kosovë të sponsoruar nga Beogradi, para se të kalonte në lagjen e famijës së gjerë Todorovic. Sreten Todorovic, banor i lagjes Todorovic, pa se si turma filloi tu vinte zjarrin disa shtëpive:

Familja ime së bashku me njerëzit e gjashtë shtëpive tjera u mblodhëm në shtëpinë e fqit tonë. Unë shikoja prej 10 metrave largësi, përderisa po i vinin zjarin shtëpisë sime. Dhe ja si e bënë: dy djelmasha po i ndihmonin të tretit të hipte mbi kulm. Djaloshi mbi kulm i hiqte disa tjegulla dhe gjuajti një koktej mollotov [bombë gasoline] brenda shtëpisë.¹³⁰

Pas vënjes së zjarrit në disa shtëpi të lagjës Todorovic, turma prapë u kthye te kisha ortodokse duke u përpjekur që prapë ti vënë zjarrin duke sjellur lëndë të ndryshme

¹²⁷ Ibid.

¹²⁸ Tre udhëheqësit e UCK-së janë indentifikuar me emra nga disa banorë sërë të Obilic, të cilët personalisht panë se si ata e udhëhiqnin turmën. Emrat e liderëve të UCK-së dhe banorëve të cilët i indentifikuan gjenden në dokumentacionin e HRW.

¹²⁹ Intervista e HRW me Stojan Todorovic, Prill 9, 2004, Mitrovicë.

¹³⁰ Intervista e HRW me Sreten Todorovic, Prill 9, 2004, Mitrovicë.

djegëse brenda kishës. Pastaj ata sulmuan apartamentet e YU Programit, dhe vazhduan të djegin shtëpi në lagjet tjera serbe të Obilic, përfshirë aty lagjen Rruga Cerska dhe Rudnicka Kolonija.

Të gjithë banorët serbë të Obilicit të intervistuar nga Human Rights Watch ishin unanimë në deklaratat e tyre se pjestarët e SHPK-së në Obilic nuk ndërmorën hapa për parandalimin e sulmeve ndaj serbëve. Denka Savic ish pjestare e SHPK-së thotë: “Unë i njoh pjestarët e SHPK-së të cilët po qëndronin aty. Ata vetëm po hecnin prapa protestuesve dhe nuk bënë asgjë që ti parandalonin ata. Por as nuk i ndihmuan ata në mënyrë aktive.”¹³¹

Banorët tjerë thanë se kanë parë personalisht pjestarët e SHPK-së duke marrë pjesë aktive në dhunë. Sipas njërit prej tyre:” Policët vetëm qëndronin dhe nuk bënë asgjë. Më vonë policët morën pjesë aktive në dhunë. Unë pashë policët duke sjellur goma për t’ia vënë zjarrin kishës dhe më vonë duke ndihmuar në shkatërimin e lagjes Todorovic. Unë pashë me sytë e mi pjestarët e SHPK-së në mes të turmës, cdo gjë që gjenin ata gjuanin brenda kishës dhe ia vënin zjarrin.¹³² Një dëshmitar tjetër thotë se të ketë parë një polic të SHPK-së duke gjuajtur një koktej molotov brenda kishës.¹³³

Sipas dijenisë të HRW, pjestarët e SHPK-së nuk arrestuan asnjërin prej protestuesve. Mirpo kur serbi shtatëdhjetë e katër vjecar Stojan Arsic gjuajti një mjet eksplozues në mënyrë që të shpërndajë turmën e shqiptarëve të cilët po mundoheshin ti vënin zjarrin shtëpisë së tij, SHPK-ja arriti brenda minutave që të arrestoj serbin e moshuar.¹³⁴ Në Obilic gjenden përafërsisht dhjetë pjestarë serbë të SHPK-së, mirpo ata nuk morën pjesë në përgjegjjen kundër dhunës: komandanti serb i SHPK-së për Obilic gjendej në Shtetet e Bashkuara për trajnim, dhe pjestarët serb të SHPK-së qëndruan brenda në stacion duke u friguar për sigurinë e tyre. Disa dëshmitarë gjatë dhunës panë pjestarët e KFOR-it dhe UNMIK-ut në qendër të qytetit. Trupat e KFOR-it poashtu u pozicionuan që të mbrojnë apartamentet e YU Programit nga sulmet e protestuesve. Sidocoftë ky numër i vogël i pjestarëve të KFOR-it dhe UNMIK-ut nuk ndërmori asnjë hap që të parandaloj vetë dhunën, ata e kufizuan vehten në evakuimin e serbëve të rrethuar. Sipas Stojan Todorovicit: “Në asnjë moment gjatë dhunës KFOR-i, UNMIK-u apo SHPK-ja nuk përdorën altoparlanta në mënyrë qëti drejtoheshin turmës, poashtu nuk përdorën as gas lotsjellës apo plumba gome. Nuk pati asnjë tentim që të ndalohej dhuna”.¹³⁵

¹³¹ Intervista e HRW me Denka Savic, Prill 9, 2004 Mitrovicë.

¹³² Intervista e HRW me Olgica Subotic, Prill 9, 2004, Mitrovicë

¹³³ Intervista e HRW me sreten Todorovic, Prill 9, 2004, Mitrovicë.

¹³⁴ Ibid.

¹³⁵ Intervista e HRW me Stojan Todorovic, Prill 9, 2004, Mitrovicë.

Përfundimisht, banorët serb dhe romë të Obiliqit u evakuan nga shtëpitë e tyre nga një forcë e kombinuar e policisë amerikane të UNMIK-ut, KFOR-it irlandez dhe disa pjestarëve të SHPK-së. Në kohën kur serbët u larguan prej shtëpive të tyre, shumica ende ishin të paprekura. Gjatë ditëve të ardhshme, shqiptarëve u është dhënë drita e gjelbër që të vazhdojnë djegjen e shtëpive, duke shkatëruar diku rreth nëntëdhjetë shtëpi dhe katërdhjetë apartamente të cilat u takonin serbëve, dhe duke plackitur shtëpitë e romëve të cilë ishin detyruar të iknin.

Bellopoje

Bellopoja ishte një projekt pilot në rikrijimin e një komuniteti multi-etnik në Kosovë dhe duke njohur të drejtat e serbëve që të kthehen në shtëpitë dhe fshatrat e tyre, shumica prej të cilave kanë qenë të banuara edhe prej gjyshërve të tyre me gjenerata të tëra. Bellopoja është fshat serb në jug të Pejës, në pjesën perendimore të Kosovës. Para luftës së vitit 1999 në këtë fshat jetonin diku rreth treqind familje, mirpo të gjithë u zhvendosën dhe shkuan në Serbi dhe Mal të Zi pas përfundimit të luftës, pasi që ishin vrarë disa banorë të fshatit. Pas negociatave të shumta me KFOR-in, UNMIK-un dhe qeverinë e përkohshme të Kosovës, në korrik të vitit 2003 u arrit marrëveshja se do të rindërtohen njëzet e pesë shtëpi në fshat, dhe se do të kthehen tridhjet e katër serbë. Fshati konsiderohej si i sigurtë për kthime për shkak të bazës kryesore italiane të KFOR-it, Villagio Italia, ecila gjendet vetëm një kilometër larg fshatit.

Me 17 mars, Bellopoja priti disa përfaqësues të ish banorëve serb të fshatit të cilët poashtu po konsideronin të ktheheshin në provincë dhe po u tregonin atyre përreth. “Pasi që përfundua mbledhjen, ne filluam të ecnim rreth fshatit që ti shikonim shtëpitë e reja dhe të shihnim se ku do të mund të ndërtonim të tjerat,” thotë Momcilo Savic.¹³⁶ Rreth orës 14:30 një grup i pjestarëve të SHPK-së vrapoi drejt grupit të banorëve dhe vizitorëve dhe i këshilloi se një grup i madhë i shqiptarëve po vinte drejt Bellopojës. Zyrtarët lutën serbët që të strehoheshin në kishën ortodokse.

Turma e shqiptarëve e cila ishte mbledhur në qendër të Pejës, rritej prej disa qindrave në mijëra protestues, përderisa udhëheqësit po përdornin megafonë për të lutur të tjerët që tu bashkangjiten. Turma para se të marshonte drejt Bellopojës, së pari u drejtua te ndërtesa e UNMIK-ut dhe ndërtesat tjera komunale.¹³⁷ Momcilo Savic dhe banorët tjerë shikuan turmën se si po afrohej: “Ne pamë një grup të madhë të njerëzve, ndoshta diku

¹³⁶ Intervista e HRW me Momcilo Savic, Prill 11, 2004, Manastiri i Decanit.

¹³⁷ ICG, Rrëmuja në Kosovë, f.47.

rreth 5.000 persona. Ata po brohorisnin “UCK, UCK,” dhe po na fyenin në gjuhën shqipe.”¹³⁸

Edhe pse baza kryesore e KFOR-it italian gjendej vetëm një kilometër larg, më pak se 100 ushtarë të KFOR-it italian iu përgjegjën dhunës në Bellopojë. Trupat italiane të KFOR-it refuzuan ti afroreshin kishës ku ishin strehuar sërbët, duke i shtyrë ata të ecnin për afërsisht 150 metra nëpër turmën armiqsuar para se ti evakuonin.¹³⁹ Një grup i dhjetë apo pesëmbëdhjetë policëve të UNMIK-ut, shumica prej tyre amerikanë, u munduan të formojnë një kordon, në mënyrë që të ti mbrojnë sërbët të cilët po kalonin nëpër turmën e armiqsuar.

Trupat e KFOR-it dhe UNMIK-ut ishin të rrethuara nga protestuesit shqiptarë: “KFOR-i kishte mburoja dhe po shtyenin prapa njerzit, mirpo turma e njerëzve sillej sikurse të mos ekzistonin ata.”¹⁴⁰ Sipas disa dëshmitarve sërb, në vend të ngjarjes ishin diku rreth pesëdhjetë apo njëqind pjestarë shqiptarë të SHPK-së, mirpo ata refuzonin të kryenin detyrat e tyre: “Aty ishin poashtu edhe pesëdhjetë pjestarë të SHPK-së mirpo ata kishin kryqzuar duart e tyre dhe vetëm po shikonin.”¹⁴¹ Një dëshmitar tjetër thotë: “Gati njëqind pjestarë të SHPK-së po qëndronin me duar të lidhura. Aty kishte automjete të SHPK-së, të cilat ata i ndëruan vendin, në mënyrë që ti lejonin protestuesit të kalojnë”.¹⁴²

Mungesa adekuate e personelit të sigurimit dhe refuzimi i KFOR-it italian ti afrohen kishës ku ishin strehuar sërbët, në momentin kur ata duhet të evakuoreshin, gati rezultoi në një tragjedi. Sërbët të cilët iknin, u sulmuan nga turma shqiptare, dhe disa prej tyre u therën dhe u lënduan. E vetmja gjë që e ndaloi sulmin ishte, qëllimi fatal i një sulmuesi shqiptarë nga një pjestare amerikane e UNMIK-ut:

Pjestarët amerikanë të [UNMIK-ut] e bënë një kordon prej dy vijash, neve na është dashur të vrapojmë nga kisha e deri te automjetet, largësi kjo diku rreth 100 metra. Turma e për afërsisht një mijë shqiptarëve, mundahej të na bllokonte rrugën. Aty ishte një vrasës I cili therri me thikë një plak tri herë afër zemrës. Gurët po fluturonin prej gjitha anëve dhe na qëllonin. Kur vrasësi nuk u kënaq me lëndimin e një personi, ai tentoi të therë një djalë. Policja nxori armën e saj dhe i tha “stop” tri herë në gjuhën angleze. Vrasësi vazhdoi të afrohej. Policja amerikane

¹³⁸ Intervista e HRW me Momcilo Savic, Prill 11, 2004, Manastiri i Decanit.

¹³⁹ ICG, Rrëmuja në Kosovë, f.47.

¹⁴⁰ Intervista e HRW me Raiko Savic, Prill 11, 2004, Manastiri Decan.

¹⁴¹ Intervista e HRW me Momcilo Savic, Prill 11, 2004, Manastiri Decan.

¹⁴² Intervista e HRW me Rajko Savic, Prill 11, 2004, Manastiri Decan.

shtiu në ajër dhe pastaj e qëlloi atë, dhe ai ra përtoke (i vdekur). Vetëm një grupë njerzish arriti të hyjë në kamionë dhe të shkojë në baze. e të tjerëve na është dashur të mbyllim vehtë brenda në kishë.

Ata po gjuanin kokteje molotov brenda kishës, ne kishim shumë fat që dyshemetë nuk ishin prej druri, përndryshe do të digjeshim. Pjestarët amerikanë të [UNMIK-ut] panë se cka po ndodhte dhe erdhën me mburojat e tyre. Ne i hapëm dyert dhe ata larguan koktejet të cilat po digjeshin. Jashtë ishte një automjet i blinduar i cili na priste. Përderisa vraponim drejt automjetit, të gjithë u qëlluam me gure dhe u lënduam.¹⁴³

Sërbët u evakuan në bazën e afërt të KFOR-it Villagio Italia. Prej tridhjet e katër evakuimeve, njëmbëdhjetë sërbeve u është nevojitur ndihna e parë për shkak të lëndimeve të mara. Tre sërbe për shkak të lëndimeve serioze u dërguan në spitalin e Prizrenit. Të gjitha shtëpitë e rekonstruara rishtazi në Bellojë u shkatëruan tërësisht.

Ditën e ardhshme, me 18 mars, kryetari i komunës së Pejës (LDK), udhëhoqi një turmë shqiptarësh nga Peja në Bellojë, ku ai dhe zyrtarët tjerë kosovarë vënë lule në vendin ku ishte vrarë sulmuesi me thikë.¹⁴⁴

Gjakovë

Qyteti i Gjakovës gjendet në jug të Kosovës dhe afër kufirit me Shqipërinë, dhe në të cilin para vitit 1999 jetonin rreth tremijë sërbe. Deri në mars të vitit 2004 popullata sërbe e Gjakovës ra në pesë gra të moshuara. Ato jetonin rreth kishës ortodokse sërbe në Gjakovë, nën përkujdesjen konstante të trupave italiane të KFOR-it. Se sa e vështirë ishte jeta e tyre, për HRW, spjegon 75 vjecarja Nada Isailovic:

Cdo ditë unë shkoja në kishë nën përcjelljen e KFOR-it italian. Shqiptarët bënë cdo gjë që të na shkatëronin, ata na gjuanin me vezë dhe domate. Ata nuk donin të shihnin person sërb, apo shtëpi sërbe në [Gjakovë]. Ushtarët italianë jetuan në shtëpinë time pesë vite me rradhë. Ne nuk mund të blenim ushqim prej shqiptarëve sepse ata nuk na shitnin. Listën e gjërave që na nevojiteshin ne u ipnim trupave italiane dhe ata i blenin gjërat për ne.¹⁴⁵

¹⁴³ Intervista e HRW me Momcilo Savic, Prill 11, 2004, Manastiri Decan.

¹⁴⁴ ICG, Rrëmuja në Kosovë, f.51.

¹⁴⁵ Intervista e HRW me Nada Isailovic, Prill 12, 2004, Manastiri Decan.

Si edhe në shumë qytete tjera të Kosovës, edhe në Gjakovë me datë 16 mars u organizuan protesta në përkrahje të UCK-së. Protesta në Gjakovë pati shumë pjesmarrës, pjesërisht për shkak se shumë shqiptarë ende mbesin të pagjetur prej konfliktit të vitit 1999, dhe pjesërisht për shkak se shumë shqiptarë u vranë në Gjakovë gjatë vitit 1999.¹⁴⁶

Në mbrëmjen e 17 marsit, rreth orës 18:00 një grup i madhë i shqiptarëve iu afrua komunitetit të vogël serb në Gjakovë- më saktësisht një shtëpi e vetme serbe dhe kisha ortodokse serbe e cila ishte e mbrojtur nga KFOR-i italian. Trupat italiane të KFOR-it menjëherë evakuan gratë e moshuara nga shtëpia dhe i vendosën në kishë, të cilën u munduan ta mbrojnë nga turma e disa mijra sulmuesve. Sipas dy grave serbe të intervistuar nga Human Rights Watch, tridhjetë deri në katërdhjetë ushtarë italianë kishin urdhëra që të mos përdornin armë mbi turmën, dhe nuk kishin mjete për kontrollimin e dhunës si plumba gome apo gas lotsjellës.¹⁴⁷ Ushtarët italianë të KFOR-it u dhesht të tërhiqen brenda kishës pasi që u sulmuan me gurë nga protestuesit, me ç'rast gratë serbe ndihmuan disa ushtarëve të cilët ishin lënduar nga gurët. Rreth orës 20:00 ushtarët evakuan gratë serbe në bazën e tyre jashtë Gjakovës. Ushtarët italianë të KFOR-it u munduan ta mbrojnë kishën, por së shpejti u detyruan ti braktisin pozicionet e tyre.

Pasi që u bë evakuimi i banoreve serbe, dhe pasi që trupat italiane u tërhoqën nga pozitat e tyre, turma e shqiptarëve shkatëroi krejtësisht shtëpitë dhe kishën serbe në Gjakovë. Kur Human Rights Watch vizitoi vendin e ngjarjes një muaj më pas, cdo gjë ishte pastruar nga vendi i ngjarjes, duke lënë vetëm një hapsirë të zbrazët dhe duke shlyer shenjat e fundit të prezencës serbe në Gjakovë. Pas dhunës së marsit 2004, asnjë serb nuk kishte mbetur të jetonte në Gjakovë.

Prizren

Si edhe në qytetet dhe qytezat tjera, edhe në Prizren u zhvilluan protesta me datën 16 mars nga përkrahësit e UCK-së, posaqërisht se disa prej personave të arrestuar në shkurt të vitit 2004 ishin ish pjesëtarë të UCK-së me bazë në Prizren.

Dhuna në Prizren shpërtheu me datën 17 mars, rreth orës 15:00 apo 16:00. Sipas një dëshmitari serb, dy autobusë arritën në Prizren dhe u ndalën në qendër pranë hotelit.

¹⁴⁶ Hulumtimi i HRW dokumentoi përafërsisht 200 vrasje vetëm në qytetin e Gjakovës nga policia serbe dhe forcat paramilitare, si dhe ushtarët jugosllav. Në fund të konfliktit të vitit 1999 nga Gjakova u dokumentuan 1,200 të zhdukur, deri më tani numri më i lartë në Kosovë. Shiko Nën Urdhëra, kapitulli 6.

¹⁴⁷ Intervista e HRW me Nada Isailovic, Prill 12, 2004, Manastiri Decan; intervista e HRW me Poleksija Kastratovic, Prill 12, 2004, Manastiri Decan.

Shqiptarët dolën nga autobusët me plakata dhe flamuj dhe filluan të brohorisnin parulla në shqip.¹⁴⁸ Turma u mbledh shumë shpejt. Sipas dëshmitarëve, turma në fillim ishte pak konfuze duke mos ditur se nga t'ia mbanin së pari, fillimisht sulmuan ndërtesën e UNMIK-ut dhe u vënë zjarrin disa automjeteve të UNMIK-ut.¹⁴⁹ Mirpo ata së shpejti ndëruan drejtimin, duke kaluar lumin dhe duke u drejtuar komunitetin serb.

Trupat gjermane të KFOR-it sikur u zhdukën gjatë sulmit mbi komunitetin serb në Prizren, shumica prej të cilëve jetonin në ndërtesën fetare dhe historike dhe shtëpitë tjera përreth. Asnjë prej serbëve të intervistuar nga HRW nuk kishte parë një ushtar të vetëm të KFOR-it gjerman në zonën përreth, gjatë kohës së sulmit. Sipas Ljubisha Pleskonjic, serb ky i cili jetonte në ndërtesën historike dhe fetare së bashku me gruan e tij dhe dy fëmijët tha: “gjatë tërë kohës askush nuk erdhi, prej KFOR-it, UNMIK-ut, apo SHPK-së. Zakonisht ne shihnim me mijëra prej tyre duke vozitur gjatë ditës nëpër rrugë. Pasi që ndërtesat serbe filluan të digjeshin, erdhi një grup i UNMIK –ut dhe SHPK –së, por turma ishte aq e fortë sa që ata ikën.”¹⁵⁰

Në vakumin e sigurisë të krijuar nga dështimi i trupave gjermane të KFOR-it, shumica e serbëve në Prizren u lanë në mëshirën e turmës. Ljubisha Pleskonjic së bashku me gruan e tij e cila ishte shtatëzënë dhe dy fëmijët e tyre, e gjetën vehten të ngjuar në banesën e tyre brenda ndërtesës fetare serbe të cilën e kishte kapluar flaka:

Ata erdhën tek dera jonë dhe provuan ta thenin. Unë e vendosa një ulëse prapa derës dhe shtyeja prapa. Pastaj ata tentuan ta thenin derën me sopatë. Mirpo kur panë se nuk mund ta thenin atë, ata derdhën benzinë dhe ia vënë zjarrin. Së shpejti cdo gjë po digjej.

Në banjo ishte një dritare e vogël, 30 cm me 30 cm. unë arrita ta shtyej gruan dhe fëmijët jashtë dritares dhe mbi kulm, mirpo unë nuk arrita të dal [për shkak të madhsisë sime]. Unë putha gruan dhe fëmijët lamtumirë- mendova se do të vdisja.

U ktheva në kuzhinë e cila po digjej. Unë gjuajta frigoriferin në mur , theva murin, dhe dola jashtë në këtë mënyrë. Gjeta familjen time. Turma filloi të sulmonte [një grup të UNMIK-ut dhe SHPK-së të cilët kishin arritur] dhe policia iku në panik dhe neve na la pas.

¹⁴⁸ Intervista e HRW me Ljubisa Pleskonjic, Prill 12, 2004, Prizren

¹⁴⁹ ICG, Rrëmuja në Kosovë, f.47.

¹⁵⁰ Intervista e HRW me Ljubisa Pleskonjic, Prill 12, 2004, Prizren.

Aty ishte një dyqan i vogël me kofa bërllogu, dhe ne u fshehëm aty deri në orën 5:00 të mëngjesit, pa këpucë apo ndonjë gjë tjetër. Më është dashur ti mbaja fëmijët e qetë sepse qanin pandërprerë. Në ora 5:00 të mëngjesit dola jashtë në rrugë dhe pashë një automjet të SHPK-së. Unë u drejtova atyre në shqip, dhe ata na dërguan në bazën gjermane të KFOR-it.¹⁵¹

Disa sërbe të moshuar ishin rrahur nga turma brenda ndërtesës fetare. Gjashtëdhjetë e një vjecari Dragan Nedelkovic vdiç brenda ndërtesës e cila po digjej, përderisa banorët tjerë thonë se kanë dëgjuar se si e kishin rrahur atë gjatë sulmit.

Përgjegjja e trupave gjermane të KFOR-it në Prizren paraqet një prej dështimeve më fundamentale të sigurisë gjatë protestave të marsit 2004. Edhe pse njëra prej bazave më të mëdha të KFOR-it gjerman gjendet në periferi të Prizrenit, komandantët e trupave gjermane refuzuan që ti mobilizojnë trupat e tyre në mënyre efektive gjatë dhunës së marsit, duke injoruar thirrjet e njëpasnjëshme për ndihmë prej kolegëve gjerman nga policia e UNMIK-ut.¹⁵² Komandantët e policisë së UNMIK-ut në Prizren janë të bindur se, një përgjegjje e fortë e KFOR-it do të parandalonte djegjen e tërsishme të pesëdhjetë e gjashtë shtëpive sërbe dhe pesë kishave ortodokse sërbe me rëndsi historike, dhe poashtu terrorin me të cilin u ballafaqua popullata sërbe e braktisur nga bashkësia ndërkombëtare.

Një zyrtarë i UNMIK-ut i cili dëshiroi të mbetet anonim i tregoi HRW se komandantët e policisë së UNMIK-ut në Prizren vazhdimisht kërkuan pozicionimin e trupave gjermane të KFOR-it në Prizren gjatë kohës së dhunës. Ai besonte se po nëse do të dilte një tank i vetëm në fillim të protestës, “demonstuesit do të ishin larguar”. Sipas një zyrtari të UNMIK-ut, rreth katër qind trupa gjermane të KFOR-it ishin pregaditur që ti përgjegjen dhunës, mirpo urdhëri për pozicionimin e tyre nuk erdhi fare. Për dështimin e trupave gjermane të KFOR-it ai fajsoi “komandantët të cilët nuk dëshirojnë të bëjnë gabime të cilat do të mund të përfundonin karrierat e tyre”.¹⁵³

Dështimi i trupave gjermane të KFOR-it që ti përgjigjen dhunës në Prizren, la situatën e sigurisë në duart e diku rreth 350 pjestarëve të SHPK-së të cilët ishin të pajisur shumë

¹⁵¹ Intervista e HRW me Ljubisa Pleskonjic, Prill 12, 2004 Prizren

¹⁵² Intervista e HRW me zyrtarë të UNMIK-ut, Prill 12, 2004, Prizren; Renate Flottau et al, “Deutsche Soldaten: Die Hasen Vom Amselfeld,” Der Spiegel (Germany), May 3, 2004.

¹⁵³ Intervista e HRW me zyrtarë të UNMIK-ut, Prill 12, 2004, Prizren.

dobët, dhe shumica prej tyre me vetëm disa vite eksperiencë dhe disa dhjetra pjestarë të UNMIK-ut. Njësia speciale argjentiniane e policisë së UNMIK-ut me bazë në Prizren, atë kohe ishte thirur që ti përgjegjej dhunës në vendet tjera të Kosovës.¹⁵⁴ Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-së thjesht nuk kishin mjete që të mereshin me dhunën: “Ne nuk kemi mjete të mjaftueshme. Nuk kemi gas lotsjellës, plumba gome tela gjembor, apo topa uji. Ne thjesht nuk ishim të pregaditur për këtë”, tha një komandant i policisë së UNMIK-ut për HRW.¹⁵⁵

Edhe pse nuk ishin të pregaditur për këtë dhunë masive, shumë prej pjestarëve të SHPK-së dhe UNMIK –ut kryen detyrat e tyre në mënyrë profesionale. Tetëdhjetë vjecari Milosh Gligorijevic, i cili jetonte në shtëpinë e tij në Prizren me gruan e tij shtatëdhjetë vjecare, motrën e tij gjashtëdhjetë e nëntë vjecare dhe vajzën shpjegon se si pjestarët e SHPK-së vizituan familjen e tij katër here gjatë protestave në Prizren, duke i lutur ata që të rrijnë brenda shtëpisë. Gjatë vizitës së tyre të katërt, rreth orës 17:00 të njejtët policë erdhën përsëri dhe thanë: “Axhë behuni gati se duhet të largoheni brenda disa minutash,” dhe e morrën familjën në automjetin e tyre. “Gjatë tërë kohës ishte grupi i njejtë i SHPK-së. UNMIK-u dhe KFOR-i nuk erdhën asnjëherë” thotë Gligorijevic.¹⁵⁶

Shtatëdhjetë e pesë vjecari Milosh Necic, jetonte vetëm në një shtëpi të izoluar serbe, dhe kishte përvojë të ngajshme lidhur me trimërinë e SHPK-së. Përderisa turma shqiptare mendohej ta thente derën e tij, një grup i katër apo pesë policëve të SHPK-së u ngjiten mbi murin e tij dhe i thanë se duhet ta evakuonin atë. Në pamundësi që të dalin nga dera për shkak të turmës së madhe, pjestarët e SHPK-së ngitën Necic-in mbi kulmet e dy shtëpive shqiptare, duke përdorur mburojat e tyre që ta mbronin atë nga turma e cila gjuante me gurë. Pjestarët e SHPK-së u detyruan të thirin një taksì, në mënyrë që të kthehen në stacionin e policisë, sepse turpa sulmonte edhe automjetet e SHPK-së.¹⁵⁷ Asnjë nga serbët në Prizren nuk akuzoi SHPK-në për pjesëmarrje në dhunë, mirpo pati raste që disa pjestarë të SHPK-së nuk u lajmëruan në detyrë gjatë këtyre ngjarjeve.¹⁵⁸

Përpos shkatërrimit të shtëpive serbe në qendër të Prizrenit, shqiptarët po ashtu sulmuan edhe manastirin e Shën Arkangjelëve, i cili daton nga shekulli i katërmëdhjetë, dhe i cili gjendej në grykën e lumit Lumbardhi, disa kilometra jashtë Prizrenit. Ishte manastiri i vetëm ortodoks serb i cili mbijetoi në sektorin gjerman. E vetmja rrugë që të arrihej tek manastiri ishte rruga e ngushtë nëpër grykë; dhe si e tillë duhet të ishte lehtë të mbrohej.

¹⁵⁴ Ibid.

¹⁵⁵ Ibid.

¹⁵⁶ Intervista e HRW me Milosh Gligorijevic, Prill 12, 2004, Prizren.

¹⁵⁷ Intervista e HRW me Milos Necic, Prill 12, 2004, Prizren.

¹⁵⁸ Intervista e HRW me një zyrtarë të UNMIK-ut Prill 12, 2004, Prizren.

Kur rreth orës 20:45 min një grup i përafërsisht 200 shqiptarëve arriti tek manastiri, aty gjendeshin vetëm 15 ushtarë të KFOR-it gjerman të cilët mbronin manastirin antik. Sipas priftërinjëve serb, trupat gjermane thjesht qëndruan në urë duke mos tentuar që ti ndalonin ata.¹⁵⁹ Turma u afrua ngadalë, duke ecur nëpër lumë përreth ushtarëve të cilët gjendeshin mbi urë dhe filluan të gjuanin manastirin me koktej molotov. “Gjermanët nuk përdorën shufra gome, gas lotsjellës e as nuk shtien në ajër”, thanë priftërinjtë.¹⁶⁰ Posa turma shqiptare filloi të sulmonte manastirin, paqëruajtësit gjermanë urdhëruan priftrinjtë që të hynin brenda automjeteve të blinduara të KFOR-it dhe u larguan, duke lënë manastirin që të digjet nga ana e turmës shqiptare.¹⁶¹

Protestuesit në Prizren shkatëruan gati cdo monument të rëndësishëm historik serb, duke përfshirë edhe një numër të kishave të cilat datonin nga shekulli i katërmëdhjetë. Mes strukturave ortodokse serbe të shkatëruara apo të dëmtuara rëndë ishin edhe: shkolla moderne e Shën Cirilit dhe Metodisë, katedralja e Shën Gjorgjit nga shek 19 dhe peshkopia e cila gjendej përbri, kisha e shpëtimtarit të shenjtë e cila datonte nga shek i 14, poashtu nga shek i 14 kisha e Shën Nikollasit, kisha e Virgjëreshës së shenjtë Ljeviska shek 14, dhe manastiri i lartpërmendur i Shën Arkangjelëve. Kishat antike në Prizren përmbanin disa prej freskave më të rëndësishme në Kosovë, dhe humbja e tyre është shumë e rëndësishme për kishën ortodokse serbe.¹⁶²

PERGJEGJJA E UDHEHEQSISE KOSOVARE NDAJ DHUNES

Dhuna e marsit 2004 fillimisht gjeti të befashuar udheheqjen politike kosovare, dhe shumë pak politikanë kosovarë kuptuan se sa të ashpra ishin sulmet ndaj komuniteteve minoritare. Në periudhën fillestare, shumë politikanë shqiptarë u lëkundën ndërmjet përpjekjeve për përfitim politik nga dhuna dhe thirjes për qetsim. Të zënë nga frustrimi i vet politik- mungesa e përparimit në zgjidhjen e statusit final të Kosovës, lufta kundër “strukturave paralele serbe,” si dhe kërkesa e tyre për më shumë kompetenca- shumë politikanë fillimisht bënë deklaratat që mund të kenë ndihmuar legjitimimin e dhunës në sytë e shumë shqiptarëve.

¹⁵⁹ Intervista e HRW me vëlla Bojan Dejanovic, Prill 12, 2004 Manastiri Decan.

¹⁶⁰ Ibid.

¹⁶¹ Ibid.

¹⁶² Për përshkrim të kishave të shkatëruara të prizrenit, shiko Instituti për mbrojtjen e monumenteve kulturore të republikës së serbisë .Trashigimia kulturore e Kosovës dhe Metohisë (Beograd 2002) pp109-129.

Në ditën e parë të dhunës Kuvendi; suspendoi punën e tij. Kuvendi i Kosovës nuk ndërmoi ndonjë veprim për të ndalë dhunën, por se bëri një kumtesë me të cilën fajsoi bashkësinë ndërkombëtare dhe serbët: “Asambleja e Kosovës shprehi paknaqsitë lidhur me mungesën e përgjegjesisë së UNMIK-ut që të garantojnë sigurinë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Toleranca ndaj strukturave paralele serbe dhe grupeve kriminele të cilat vrasin qytetarët e Kosovës është strategji e gabueshme dhe do ta destabilizoj Kosovën.”¹⁶³ Kryetari i Parlamentit, Nexhat Daci, “duke folur në emër të parlamentit” deklaroi se ata shqiptarë që vdiqën dhe u lënduan nga luftimet e 17 marsit, kishin dhënë jetën duke luftuar për demokraci dhe liri.¹⁶⁴

Udhëheqsi i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK)-ish komandanti I UCK-së Hashim Thaqi, ndodhej në SHBA në kohën kur ndodhën sulmet- me c’rast bëri një deklaratë të fuqishme anti- serbe:

Sërbët po keqpërdorin vullnetin e mirë të shqiptarëve për të krijuar një shoqëri të barabartë për të gjithë. Ata nuk kanë dëshirë të integrohen në shoqërinë kosovare. Dëshmi e tërë kësaj janë ngjarjet e ditës së kaluar (fundosja e fëmijëve) dhe ngjarjet e ditës së sotme (dhuna në Mitrovicë). Vullneti i serbëve gjatë pesë viteve të fundit ishte vetëm për dhunë kundër shqiptarëve. Kjo nuk mund të tolerohet më.¹⁶⁵

Shumica e deklaratave të udhëheqsisë shqiptare refuzuan të denonin dhunën apo të flisnin për faktin se serbët ishin shënjestër primare. Reagim veqanërisht i dobët ishte reagimi i kryetarit të Kosovës Ibrahim Rugova. Rugova vazhdimisht dështoi të denojë sulmet kundër serbëve dhe minoriteteve të tjera, duke kufizuar vehten në deklarata pasive dhe formale të shqetsimit në vend se të marrë rol aktiv në ndaljen e dhunës. Si shembull jep deklaratën e Rugovës me 18 mars ku ai shpreh keqardhjen e thellë për plagosjen e policëve të UNMIK-ut dhe të ushtarëve të KFOR-it por nuk përmend edhe viktimat serbe.¹⁶⁶ Gjatë një deklaratë tjetër të bërë me 19 mars ku Rugova dënon dhunën kundër pranisë ndërkombëtare, por dështon të përmend edhe dhunën kundër serbëve.¹⁶⁷

¹⁶³ Koha Ditore, “Antarët e parlamentit ndalin punën; Akuzojnë ndërkombëtarët për dhunë,” reprodukuar në monitoringun e mediave: mediat lokale, Mars 18, 2004.

¹⁶⁴ Tri partitë kryesore të Kosovës thonë pavorsia është e vetmja mënyrë për të dalë nga kriza,” BBC Monitoring European, Mars 18, 2004.

¹⁶⁵ Përkthimi i PDK i siguruar për HRW nga një burim ndërkombëtar

¹⁶⁶ Kryetari thirë për përfundim të dhunës, thotë protestat dëmtojnë Kosovën,” BBC Monitoring European, Mars 18, 2004.

¹⁶⁷ Pas takimit me Kryeministrin Rexhepi dhe Kryeparlamentarin Daci, me 19 mars Rugova deklaroi: “Ne po përsërisim se dhuna kundër prezencës ndërkombëtare, civile dhe ushtarake, është plotsisht e papranueshme dhe është në kundërshtim me interesat vitale të Kosovës. Me këtë rast unë edhe një herë po them se shkatërimi i monumenteve kulturore dhe religjioze, pronës publike dhe shtëpive, është i papranueshëm për njerëzit e Kosovës.

Me 18 mars u lëshua një deklaratë e përbashkët në emër të kreut të UNMIK-ut Hari Holkerit, Admiralit të NATO-s Gregory Johnson dhe përfaqësuesve të Kuintit,¹⁶⁸ Kryetarit të Kosovës Ibrahim Rugova, Kryeministrit të Kosovës Rexhepit, Kryetarit të Parlamentit Nexhat Dacit, Kryetari I Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës Ramush Haradinaj,¹⁶⁹ dhe komandantit të KFOR-it Gjeneral Kammerhoff. Deklarata e cila nuk referonte sulmeve kundër sërbeve thotë:

Nuk ka arsyetim për dhunën dhe ajo duhet të ndalet menjëherë. Ata të cilët merren me dhunën janë duke tradhtuar të gjithë njerëzit e Kosovës. Progresi i viteve të fundit është rrezikuar bashkë me prospektet e tij për një të ardhme më të mirë. Ne liderët e Kosovës jemi unikë në denoncimin e atyre që përdorin dhunën. Tani është koha për qetësi.¹⁷⁰

Edhe kjo deklaratë ishte shumë e fortë për disa nga politikanët Kosovarë: Jakup Krasniqi, ministër i shërbimeve publike dhe përfaqësues i PDK-së në mungesë të Hashim Thaqit, refuzon të nënshkruan dhe del nga mbledhja. Sipas disa raporteve Krasniqi ka dalë nga mbledhja sepse “shqiptarët kanë bashkpunuar tepër gjatë me UNMIK-un dhe ai ka zgjedhur të qëndrojë me popullin.”¹⁷¹

Liderët kosovarë ndryshuan qëndrimin e tyre vetëm kur filluan të kuptojnë dëmin që i është shkaktuar imazhit të Kosovës ndërkombtarisht- Disa liderë shqiptarë dhanë deklaratat më të forta me anë të cilave denonin dhunën, mirpo ende përmbanin vehtën prej dënimit direkt të sulmeve mbi sërbe. Hashim Thaci ndërpreu vizitën e tij në SHBA, dhe bëri një deklaratë më të fuqishme kundër dhunës në televizion me c’rast tha:

Kosova, NATO, dhe Perendimi nuk kanë luftuar për një Kosovë vetëm për shqiptarët apo një Kosovë të dhunshme. Dhuna nuk është mënyra me të cilën duhet zgjedhur problemet dhuna vetëm krijon probleme. Ne nuk guxojmë të harrojmë se Kosova sot ka lirinë e saj duke falemderuar sakrificës së popullit të saj dhe botës perendimore.¹⁷²

¹⁶⁸ Kuinti është i përbërë nga antaret e Kontakt Grupit pa Rusinë, p.sh. SHBA, B.e Madhe, Franca, Gjermania, dhe Italia.

¹⁶⁹ Haradinaj është ish komandant i UCK-së.

¹⁷⁰ UN, KFOR dhe Liderët e Kosovës japin deklaratë të përbashkët duke thirrur për përfundim të menjëhershëm të dhunës,” BBC Monitoring Newsfile, Mars 18, 2004.

¹⁷¹ ICG, Rrëmuja në Kosovë, f, 25.

¹⁷² Zeri, Thaqi thëret qytetarët që të ndalin protestat dhe të mos harrojnë ndihmën e NATO-s,” riprodhuar në UNMIK media monitoring, mediat lokale, Mars 19, 2004.

Me 20 mars, Thaci u bë lideri i parë shqiptarë që denoi sulmet kundër sërbeve me deklaratën se “ata që djegin shtëpi sërbe dhe kisha ortodokse nuk janë asgjë më shumë se kriminelë, që nuk mund të tolerohen. Kosova nuk u takon vetëm shqiptarëve.”¹⁷³

Përgjegjja e dobët e institucioneve të përkohshme të Kosovës dhe të lidërshiptit politik nxiti një qortim të ashpër nga bashkësia ndërkombëtare. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer gjatë vizitës së tij me 22 prill tha se nuk ka parë “ndonjë progres” që nga vizita e tij e pas dhunës së marsit. De Hoop Scheffer ashpër kritikoi lidërshiptin kosovar, duke thënë se “ka pritur më shumë përgjegjësi, në rindërtim, një gjuhë më të fortë dhe më shumë ambicie.”¹⁷⁴ Sekretari i përgjithshëm i OKB-së gjeneral Kofi Annan poashtu kritikoi përgjegjëjen ambivalente të lidërshiptit shqiptarë, duke thënë në raportin e tij për Këshillin e Sigurimit të OKB-së duke thënë se “të pavendosur që të dënojnë dhunën në përgjithësi dhe poashtu më vonë dhunën kundër komunitetit sërbe. [Lidërët e Kosovës] dështuan që fillimisht të kuptojnë seriozitetin e situatës dhe tentuan ta ndërlidhin me objektivat e tyre politike.”¹⁷⁵ Bashkësia Evropiane, përderisa mendohej të largohej fajsimit të drejtpërdrejt të lidërshiptit kosovar për dhunën e marsit, thiri “të gjithë liderët, e posaqërisht lidërshiptin kosovar, që të marrë përgjegjësi për situatën dhe të siguroj se këto akte të kërcënimeve dhe dhunës nuk përsëriten më,” duke u thënë liderëve kosovarë “se në pyetje është kredibiliteti i tyre.”¹⁷⁶

Përderisa bashkësia ndërkombëtare denoi ashpër rolin e lidërshiptit shqiptarë gjatë krizës, megjithatë disa politikanë shqiptarë kanë ndërmarrë veprime të fuqishme kundër dhunës. Përderisa thirret jo specifike të politikanëve shqiptarë për të vënë fund dhunës ishin injoruar, intervenimet direkte të lidërve shqiptarë duket se kanë pasur efekt pozitiv në disa raste. Me 18 mars, kryeministri Bajram Rexhepi personalisht shkoi tek përleshjet e ashpra në Cagllavicë, i shoqëruar nga disa liderë të tjerë shqiptarë, dhe brenda disa minutash bindi turmën që të shpërndahen, pasi që u premtoi që bllokada rrugore sërbe do të mënjanohet. Ngjajshëm edhe me 17 mars, Rexhepi shkoi personalisht në Mitrovicë duke tentuar që të qetsoj situatën, mirpo me më pak sukses. Me 18 mars, kryetari i komunës së Decanit Ibrahim Selmanaj dhe kryetari i degës lokale të Veteranëve të Luftës së UCK-së, Abdyl Mushkolaj, personalisht ndalën turmën e cila shkonte drejt manastirit

¹⁷³ Ish lideri shqiptar kritikon kriminelët të cilët u vënë zjarrin shtëpive sërbe në Kosovë,” Agence France Presse, Mars 20, 2004.

¹⁷⁴ Shaban Buza, NATO kritikon përgjegjëjen ndaj dhunës të liderëve Kosovarë, Reuters, Prill 22, 2004.

¹⁷⁵ Këshilli i sigurimit i kombeve të bashkuara,” Raporti i sekretarit të përgjithshëm të kombeve të bashkuara mbi administratën e përkohshme ,misioni në Kosovë” Mars 26 2004

¹⁷⁶ Këshilli i Ministrave i BE-së, “Përfundimet e 26 marsit, 2004, Mbledhja e Këshillit Evropian,” Mars 26 2004.

historik të Decanit, me qëllim që t'ia vënin zjarrin.¹⁷⁷ Efekti i këtyre akteve sporadike sjell pyetjen, se sa prej shkatërimit që ndodhi do të ishte parandaluar nëse lidershipi shqiptar do të kishte marrë një rol më proaktiv për ti dhënë fund dhunës, në vend se fillimisht ti arsyetojnë këto akte, siq bëjnë disa prej politikanëve.

Pas përfundimit të dhunës, shumë politikanë shqiptarë vazhduan përpjekjet për përfitim politik nga dhuna, në vend se të merret përgjegjësia në mënyrë që të parandalohen shpërthimet e tilla të dhunës kundër minoriteteve në të ardhmën. Për shembull, kryetari Rugova vazhdoi të kërkoj hapa të menjëhershëm drejt pavarësisë së Kosovës, duke argumentuar se vazhdimi i bllokimit të pavarësisë vetëm do t'ju japë më shumë terren ekstremistëve.¹⁷⁸

Përderisa zyrtarët e ndyshëm ndërkombëtarë ishin shumë të shpejtë të kritikojnë liderët politik kosovar për rolin e tyre gjatë trazirave të marsit, ata dështuan që të vërejnë dështimet e bashkësisë ndërkombëtare në mënyrë të ngajshme dhe kritike. Të gjithë veprimtarët e intervistuar nga Human Rights Watch, ndërkombëtarë dhe vendor, ishin unanim në mendimin e tyre se strukturat e KFOR-it dhe UNMIK-ut, në nivelin politik dhe atë të sigurisë, patën një kollaps gjatë situatës së dhunës. Ky raport demonstroi në mënyrë adekuate se KFOR-i dhe UNMIK-u nuk ishin në gjendje të ofrojnë siguri në mënyrë efektive për komunitetet jo shqiptare në Kosovë. Një përfaqësues diplomatik tha për HRW, “KFOR-i dhe UNMIK-u nuk e kanë marrë situatën nën kontrollë. Në fund kur demonstruesit patën mjaft dhe vendosën të shkojnë në shtëpi.”¹⁷⁹ Asnjë përfaqësues i KFOR-it ose UNMIK-ut nuk ka pranuar haptazi dështimet e mëdha të organizatave të tyre gjatë krizës së marsit, ngritet pyetja a kanë marrë mësim të rëndësishme organizatat ndërkombëtare nga eksperiencia apo janë duke vazhduar “punën si zakonisht”.

SITUATA E PAS DHUNES, PER SERBET, ROMET DHE PAKICAT TJERA JO SHQIPTARE

Dhuna e marsit la 19 persona të vdekur, 954 të lënduar, 4,100 persona të zhvendosur, 550 shtëpi të shkatëruara, dhe 27 kisha dhe manastire të djegura. Si shtesë, 182 shtëpi dhe 2 kisha ortodokse ose manastire seriozisht u dëmtuan.¹⁸⁰ Një numër i madhë i të

¹⁷⁷ Intervista e HRW me atë Savën, Manastiri Decan, 11 prill, 2004. Më vonë Mushkolaj u arrestua nga policia e UNMIK-ut nën dyshime se qenë i involvuar në dhunën kundër UNMIK-ut në Decan me 17 mars.

¹⁷⁸ RFE/RL Newsline, “Presidenti Kosovës thëret trupat britanike që të qëndrojnë,” 5 prill 2004; UNMIK media monitoring, titujt e shtypit kosovar, Koha Ditore, “Rugova: Pa njohjen e pavarësisë, ekstremistët do të fitojnë fuqi,” Prill 6, 2004;

¹⁷⁹ Intervista e HRW me një burim diplomatik, Prill 18, 2004, Prishtinë.

¹⁸⁰ OSBE Departamenti i të drejtave të njeriut, Sfidat e të drejtave të njeriut lidhur me dhunën e marsit. f.6.

zhvendosurve sërb dhe minoriteteve tjera janë në moshë të shtyer dhe të varfër. Ata mbetën në Kosovë përkundër dhunës së mëhershme, sepse ishin shumë të vjetër apo të varfër që të largoheshin. Shumica e sërbeve dhe pakicave tjera joshqiptare spjeguan për HRW se i kishin humbur shtëpitë për të cilat u deshtën dekada të punës së vështirë dhe kursimit për ti ndërtuar.

Në kohën kur HRW po bënte misiomin hulumtimues në muajin prill, kishin mbetur më shumë se 2,000 persona të zhvendosur, të cilët në të shumtën e rasteve jetonin në kushte mizore. Shumica e familjeve nga fshati Frashër dhe Obilic jetonin në Mitrovicë dhe Zvecan në banesa të papërfunduara, po ngrohje, pa ujë dhe pa rrymë.¹⁸¹ Human Rights Watch poashtu gjeti sërb të zhvendosur të cilët jetonin në kontejnerë të metaltë të kamionëve në Gracanicë dhe në Uglare. Qindra persona të zhvendosur gjenden në ndërtesat e shkollave në Gracanicë dhe Mitrovicë, në kushte shumë të vështira dhe sanitarisht jo adekuate. Sërbët e zhvendosur nga Prizreni u vendosën në hallën sportive brenda bazës së KFOR-it gjerman, sërbeve të zhvendosur nga Bellopoja u vendosën në bazën e KFOR-it italian “Villagio Italia”, përderisa qindra ashkali të zhvendosur nga Vushtria janë duke jetuar në kushte shumë të vështira në tendat brenda kampit francez në bazën Novo Sellë. Vetëm disa familje gjenden në tenda individuale. Manastiret historike si ai i Gracanicës dhe i Decanit kanë ofruar strehim për sërbeve të zhvendosur.

Qeveria e përkohshme e Kosovës dhe institucionet e UNMIK-ut kanë koncentruar vëmendjen e tyre në rekonstruimin e shtëpive të shkatëruara, në mënyrë që të tejkalojnë këtë hap të madhë prapa për imazhin e Kosovës që u shkaktua nga dhuna etnike. Mirpo shumë pak vëmendje u kushtua dëshirave të vet sërbeve të zhvendosur dhe pakicave tjera jo shqiptare. Në ceremoninë në prill të vitit 2004 të mbajtur nga UNMIK-u dhe Qeveria e Përkohshme e Kosovës me rastin e rekonstruimit të apartamenteve të YU-Programit në Prishtinë, ata dështuan ti thërrasin banorët e zhvendosur, shumica prej të cilëve jetonin në Gracanicë, apo edhe ti informojnë se një ceremoni e tillë po ndodhte.¹⁸²

HRW erdhi në përfundim se mendimet dallonin shumë gjerë në mes të sërbeve dhe pakicave tjera jo shqiptare, lidhur me faktin se a dëshirojnë të kthehen në shtëpitë e tyre apo të largohen prej Kosovës. Ljubisha Pleskonjic, është elektro-inxhinier tridhjet e gjashtë vjeçar, i cili vullnetarisht u kthye në Kosovë (Prizren) në shtator të vitit 2003, i cili tani dëshiron të largohet prej Kosovës: “Unë e lash një punë shumë të mirë sepse dëshiroja të kthehesha në Kosovë, në vendlidje. Tani nuk dëshiroj që njerëzit të më paguajn për (banesën time). Unë dua katër bileta aeroplani në një drejtim: sa më larg prej

¹⁸¹ Një numër i vogël i të zhvendosurve gjeti vendbanime më të përshtatshme, në vendbanimin banesor i ndërtuar për profesorët sërbë nga universiteti i Prishtinës.

¹⁸² Intervista e HRW me Radojka Raskovic dhe Zivka Savic, Prill 12, 2004, Prizren.

këtu sa është e mundur”.¹⁸³ Tetëdhjet vjecari Mladen Gligorijevic, poashtu nga Prizreni, ishte po aq i vendosur për tu larguar: “Ne dëshirojmë dëmshpërblim për të gjitha gjërat që posedonim dhe dëshirojmë të largohemi prej Kosovës. Ne vetëm dëshirojmë të largohemi dhe të mos shohim kurrë shqiptarë me sy. Fqinjët tonë [shqiptarë] as që na ndihmuan. Nuk mund të jetohej më së bashku.”¹⁸⁴

Në anën tjetër, ka shumë sërbe të cilët dëshirojnë të mbesin. Milosh Necic poashtu nga Prizreni thotë: “Për mua mundësia për tu larguar nga Prizreni nuk egziston. Prizreni kishte pesë monumente të dedikuara parardhësve të mi, disa prej të afërmëve të mi janë varur këtu gjatë luftës së dytë botërore nga fashistët.”¹⁸⁵ Shumë prej sërbeve të zhvendosur janë të varfër që të fillojnë jetë të re jashtë Kosovës, dhe nuk kanë familjarë të cilët do të përkujdeseshin-arsye kjo ndër kryesoret pse mbetën në Kosovë duke marrë parasysh vështërsite e përditshme të jetës si jo shqiptarë në Kosovë. Shumica e atyre dëshironin të ktheheshin në shtëpitë e tyre insistuan për një siguri më të madhe. Sërbet e Bellopojës të cilët po pregaditeshin që të kthehen në shtëpitë e tyre të shkatëruara, thane:

Ne nuk kërkuam tela të gjembuar-ne erdhëm me kërkesën e qeverisë që të koegzistojmë me shqiptarët. Por tani që e pamë se shqiptarët nuk dëshirojnë të koegzistojnë me ne, ne kërkojmë tela të gjembuar. Ky është i vetmi raport I shëndosh mes nesh dhe fqinjëve tanë.

Është shumë me rëndësi për qeverinë e përkohshme dhe bashkësinë ndërkombëtare që të dëgjojnë dëshirat e komuniteteve të zhvendosura, dhe të mos imponojnë ndonjë zgjedhje- si p.sh. rindërtimi i shtëpive të tyre. Situata e sigurisë është qështje primare për të gjithë të zhvendosurit- për ata që dëshirojnë të rrijnë në Kosovë dhe për ata që dëshirojnë të largohen. Mbi të gjithat, personate zhvendosur duhet të lejohen të bëjnë zgjedhje të informuar, dhe duhet tu jipen mundësitë, duke përfshirë aty edhe rivendosjen jashtë Kosovës.

Shumë nga personat e prekur nga dhuna e marsit rishtazi janë kthyer në Kosovë, disa me ndihmën e UNHCR-së dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Fedaim Kelmendi refuzoi aplikacionin e tij për azil në Belgjikë në janar 2004 dhe u kthye në shtëpinë e tij në Vushtri, kjo ndodhi pasi që IOM bindi atë se situata ishte e sigurtë për kthim. IOM siguroi biletate aeroplanit për në Kosovë, dhe siguroi transportin deri në shtëpinë e tij në Vushtri. Ashkaliu Njazi Pllavci u kthye në shtëpinë etij Vushtri në Maj të

¹⁸³ Intervista e HRW me Ljubisa Pleskonjic Prill 13, 2004, Prizren.

¹⁸⁴ Intervista e HRW me Mladen Gligorijevic, Prill 13, 2004, Prizren.

¹⁸⁵ Intervistae HRW me Milos Necic, Prill 13, 2004, Prizren.

vitit 2003 me ndihmën e UNHCR-së, sepse ai nuk ishte më në gjendje ta mbaj familjën e tij në Sërbë. Sërbët e Bellopojës u kthyen pasi të kenë marrë garanca për sigurinë e tyre nga KFOR-i dhe UNMIK-u, poashtu edhe ndihmë në rindërtim.

Programet e rikthimit të implementuara nga IOM, UNMIK dhe UNHCR duhet të rikonsiderohen në mënyrë serioze duke marrë parasysh dhunën e marsit. Njerëzit nuk duhet të kthehen në një vend ku nuk mund të garantohet siguria e tyre, sepse kjo është në kundërshtim me principet fundamentale të kthimit vullnetar në siguri dhe krenari. UNHCR ka shprehur qartaz pozitën e tyre lidhur me ngjarjet e marsit 2004:

Pozita e UNHCR-së mbetet të jetë se pjestarët e grupeve minoritare posaqërisht sërbët, romët, ashkallitë, egjiptasit, si dhe boshnjakët dhe goranët duhet të vazhdojnë të kenë benefit nga mbrojtja ndërkombëtare në vendet e azilit. Lëvizjet e kthimit të shtyrë apo të dhunshëm, rezikojnë balancin etnik i cili është shumë delikat, dhe mund të nxisin rritje të potencialit për përleshje të reja ndër etnike. Sa u përket individve nga Kosova të cilët janë të brengosur dhe të cilët kanë aplikuar për një kthim vullnetar, është shumë me rëndësi që vendimet e këtyre refugjatëve të merren në dijeni të plotë për ngjarjet e fundit dhe për situatën e sigurisë në përgjithsi e posaqërisht për minoritetet.¹⁸⁶

UNHCR është kundër kthimeve jo vullnetare në Kosovë, dhe thotë se “ata individë [jashtë Kosovës] të cilët kanë aplikuar për kthim para ngjarjeve të marsit 2004 duhet tu ipet munësia e rishqyrtimit të aplikimit të tyre.”¹⁸⁷

Rreziku i vazhdueshëm për komunitetet minoritare erdhi në shprehje në orët e hershme të 5 qershorit, me c’rast nga një automjet u shtie mbi një grup sërbësh në Gracanicë, përkundër prezencës së pikave kontrolluese të KFOR-it në qytet.¹⁸⁸ Si rezultat i këtij sulmi vdiq gjashtëmbëdhjet vjecari Dimitrije Popovic. Edhe pse të njejtën ditë UN lajmëroi për arrestimin e dy shqiptarëve të dyshuar kjo ishte një eko e telasheve të 15 marsit, vrasjes së Jovica Ivic.¹⁸⁹

FALEMDERIMET

¹⁸⁶ UNHCR “Pozita e UNHCR mbi nevojat e mbrojtjes ndërkombëtare të individëve nga Kosova në dritën e ngjarjeve të fundit ndër-etnike.” Mars 30, 2004.

¹⁸⁷ Ibid.

¹⁸⁸ Shaban Buza, “Djaloshi sërb vrahet, tensionet në Kosovë rriten,” Reuters, Qershor 5, 2004.

¹⁸⁹ Deklarata për shtyp e UNMIK-ut, “Deklarata e SRSG mbi vrasjen në Gracanicë [sic],” (UNMIK/ PR/1194), Qershor 9, 2004.

Ky raport është hulumtuar dhe shkruar nga Peter Bouckaert, hulumtues senior i Human Rights Watch për raste emergjente, bazuar në hulumtim dy javor në Kosovë gjatë muajit prill 2004. Bogdan Ivanisevic, hulumtues për ish-Jugosllavi në divizionin Evropë dhe Azi qendrore, dha kontribut në hulumtimin e këtij raporti. Raporti u rishikua nga Benjamin Ward, James Ross, kshilltar i lartë ligjor, Widney Brown, zvendës drejtor i programit, Diane Goodman, drejtor i polosisë mbi refugjatët, dhe Veronika Sente Goldston. Manu Krishnan, bashkpuntor në divizionin e programit, Ana Sinelnikova dhe Victoria Elman bashkpuntore në divizionin Evropë dhe Azi Qendrore të cilat ofruan mbështetje të fortë logjistike gjatë hulumtimit të raportit dhe pas. Tatjana Schuetz ndihmoi me përkthimin nga burimet gjermane. Veronika Matushaj, foto editor, Andrea Holley dhe Fitzroy Hepkins menagjer i postës në divizionin e publikimeve i. cili dha kontributin e tij për këtë raport.

HRW falemnderon zrtarët e UNMIK-ut, KFOR-it, OSBE-s, PISG, dhe institucioneve të tjera të cilat kontribuan i këtij raporti me komentet dhe pikpamjet e tyre, dhe të cilët asistuan gjatë misionit hulumtues në Kosovë. Kritikkat tona për performancën e institucioneve të tyre gjatë dhunës së marsit 2004 janë me qëllim konstruktiv, dhe nuk vëjnë në dyshim përgjegjësinë e asnjë individi, ndërkombëtar apo vendor.

Human Rights Watch falemnderon Open Society Institute për përkrahjen e tyre.

